



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1090 / prot.

Tepelenë, më 20.08.2025

P/V E N D I M

Nr. ____, datë __. __. 2025

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE ME FOND 6% TË FONDIT TË
KUSHTËZUAR PËR MUAJIN KORRIK 2025**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 21 i Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike”, si dhe Vendimit Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2025”, dhe Vendimit Nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar me Vendimin Nr. 868, datë 29.12.2021; Në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë Nr. 3, datë 30.01.2025 “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor”, Këshilli Bashkiak Tepelenë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga sektori i ndihmës ekonomike në mbledhjen e datës . . . 2025,

VENDOSI:

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike 6% për muajin KORRIK 2025 11 familje me fond prej 47.580 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.

+	EMER ATËSI MBIEMËR	NR ANTARËVE NË FAMILJE	SHUMA
	BASHKIA E QYTETIT TEPELENË		
1	ROVENA ASTRIT RACO	4	10692
2	BUJAR VESEL METO	1	2178
3	ALMIRA ÇETI HAZBIA	1	2178
4	JETNOR ZYBER ÇUNAJ	1	2178
5	ELTON BARJAM ÇELA	2	3267

6	MELISA ADMIRIM DULAJ	2	5940
7	MARSELA MYZAFER ISUFI	2	3703
			30136
	NJËSIA ADM. QËNDËR		
1	ANDON VANGJEL SHUMELI	3	5227
2	SHPËTIM RAIF ALLKA	3	6336
			11563
	NJËSIA ADM. KURVELESH		
1	MARJETA ZAÇE VESHI	1	2178
	NJËSIA ADM. LOPËS		
1	KAMBER ÇUMAN ÇURAJ		3703
		SHUMA TOTALE	47580

2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike & Menaxhimit Financiar, Drejtoria Arsim Sportit Kujdesit Shoqëror (sektori I ndihmës ekonomike), Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë për ndjekjen e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE BASHKISË

JULINDA KARTERI



KRYETAR I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

SEKTORI I NE & P.A.K

RELACION

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE ME FOND 6% TË FONDIT TË
KUSHTËZUAR PËR MUAJIN KORRIK 2025**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 21 të ligjit nr 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.597, date 04.09.2019" Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike", nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2025", Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar me vendimin nr 868 datë 29.12.2021; Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr.3 datë 30.01.2025 "Për miratimin e kritereve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor" Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga sektori i ndihmës ekonomike në mbledhjen e datës ____ . 0 .2025

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	FAMILJE TE SKUALIFIKUARA	
		NR FAMILJEVE	FONDI FAKTIK LEKE
1	B. QYTETIT TEPELENË	2	10456
2	NJËSIA ADM. QËNDËR	3	14812
3	NJESIA ADM. KURVELESH	1	9367
4	NJESIA ADM. LOPËS	0	0
	TOTALI	6	34635

Konceptoi: Administratori Shoqëror: Armand Sala, Paola Demiri, Rovena Mullara, Festime Elezi

Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë

web: www.tepelena.gov.al

E-mail: info@tepelena.gov.al

	Korrik 2025	
EMERTIMI	Nr.fam qe paguhen nga fondi 6%	Fondi 6 % per familjet
NJESISA ADM.QENDER	2	
ANDON VANGJEL SHUMELI		11563
SHPETIM RAIT ALLKA		5227
		6336

ADMINISTRATOR SHOQEROR
ROVENA MULLARA

NJESIA ADMINISTRATIVE LOPES

FONDI 6 %

KORRIK 2025

NR	EMER	ATESI	MBIEMER	ID	SHUMA	ENERGJI	SHUMA TOTALE
1	KAMBER	ÇUMAN	ÇURAJ	G310151158	3703	-	3703
2							
3							
SHUMA GJITHSEJ							3703

ADMINISTRATOR SHOQEROR

FESTIME ELEZI



NJESIA ADMINISTRATIVE KURVELESH

FONDI 6% KORRIK 2025

NR	EMER MBIEMER			SHUMA GJITHSEJ	NR KARTE ID
1	MARJETA ZACE VESHI	2178		2178	H05407028E
2					
3					
		0		0	
		0		0	
	SHUMA TOTALE	2178		2178	

ADMINISTRATORI SHOQEROR

PAOLA DEMIRI



SISTEMI I PIKEZIMIT PER PROGRAMIN E FONDIT TE KUSHTEZUAR MBI PROGRAMIN E BLOK NDIHMES EKONOMIKE
DERI NE 6% OSE ME FONDE TE BUXHETIT VENDOR

FAMILJET E MUJIT KORRIK QE NUK KAM MAR PIKET E PA MJAFUESHME NGA SISTEMI I PIKEZIMIT 2025

NJESIA ADMINISTRATIVE LOPS

													0

NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER

1	ENKEL LUAN DENA	4	5	5	10	0	10	8	5	10	10	67	5881
2	REBANI BILBIL QYRDETI	2	5	5	10	0	10	6	5	10	10	63	3703
3	BAIR KADRI FATIA	3	5	5	10	0	10	6	5	10	10	59	5228
													14812

NJESIA ADMINISTRATIVE KURVELESH

1	AGIM IMER ZANA	6	5	5	10	0	10	12	5	10	10	73	9367
													9367

TE ARDHURAT

MBI 80C 5 PIKE
NEN 80C 10 PIKE

0

VLERESIMI SOCIAL EKONOMIK

PIKEZIMI

GJENDJA FAMILJARE

ME FEMIJE NEN 18 VJEC 10 PIKE

FAMIJE RURALE 5 PIKE

FAMILJE URBANE 5 PIKE

ME PASURI PALUAJTSHME 5 PIKE

ME FEMIJE MBI 18 VJEC 5 PIKE
IVE/DIVORCUAR/VECUAR 10 PIKE
PAK K/FAMILJAR 10 PIKE
PAK FAMILJAR 5 PIKE
cdo antar familje 2 pike

PA PASURI PALUAJTSHME 10 PIKE

ADMINISTRATOR SHOQEROR ARMAND SALA FESTIME ELEZI ROVENA MULLARA PAOLA DEMIRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

DREJTORIA E ARSIM KULTURËS DHE KUJDESI SOCIAL

SEKTORI I NE&P.A.K

Nr. 1490...prot.

Tepelenë, më 20.08.2025

Lenda : Materialet e NE per muajin KORRIK 2025

SEKRETARISE KESHILLIT BASHKIAK

TEPELENË

Po ju dergojme Listepagesat per kater Njesite Administrative te Bashkise Tepelene per fondin 6% te NE ,Listepagesen per fondet e Bashkise dhe Listen me aplikantet qe nuk kane marre piket e mjaftueshme nga sistemi i pikezimit per muajin KORRIK 2025 .

Faleminderit per bashkepunimin !





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1490 prot.

Tepelenë, më 20.08.2025

P/V E N D I M

Nr. __ , datë ____ . __ 2025

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BASHKISË PËR FAMILJET QE DO TE TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR MUAJIN KORRIK 2025

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 21 të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM nr. 597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB nr. 72, datë 27.11.2024, “Për miratimin e buxhetit për vitin 2025”, VKB nr. 3, datë 30.01.2025, “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok ndihmës ekonomike deri 6% ose me fondet e buxhetit vendor”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të trajtojë me ndihmë ekonomike 89 familje, me një fond prej 223.178 lekë. Bashkëlidhur tabela.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar, Drejtoria e Arsimit, Sporteve dhe Kujdesit Shoqëror, Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK, Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARE BASHKISË
JULINDA KARTERI**



**KRYETAR I KËSHILLIT
ARBEN GUMENI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
SEKTORI I NE & P.A.K
RELACION

**PËR DHENIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERDORIMIN E FONDIT TË
BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TE TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE
PËR MUAJIN KORRIK 2025**

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 21 të ligjit 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597, datë 04.09.2019, “Për percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të perfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” VKB nr.72 datë 27.11.2024 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2025”, VKB nr.3, datë.30.01.2025. “Për miratimin e kriterëve procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok ndihmës ekonomike deri 6% ose me fondet e buxhetit vendor”.

Spektori i ndihmës ekonomike nga verifikimet e kryera në terren në familjet në nevojë i propozon Këshillit të Bashkisë për sa vijon më poshtë :

Nga problematikat e hasura nga aplikantët për ndihmën ekonomike ne zyrat tona dhe nga verifikimet e kryera ne terren vërejmë, se sistemi i pikezimit nuk shpall fitues familje në nevojë vajzat nëna, gra krye familjare (të divorcuara) me një ose me shumë femije. Kryefamiljar ose familje në moshë mbi 50 vjec (që kanë problem me shëndetin dhe të paaft për punë). Kryefamiljar te penalizuar nga sistemi pikëzimit se një ose me shumë antar janë te larguar jasht shtetit. Kryefamiljar (të braktisur), familje në nevojë që penalizohen nga zyra e punës kur një anëtar del i paregjistruar.

Aplikantët të dorëzojnë pranë zyrës së ndihmës ekonomike këto dokumenta :

1. Kartë identiteti
2. Certifikat familjare
3. Vërtetim nga kadastra
4. Vërtetim nga zyra e punës

Propozojme si administrator shoqëror që këto familje të meren në kosidertat dhe të trajohen me ndihmë ekonomike nga ana e Bashkisë Tepelenë.

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike 89 familje me fond 223.178 lekë.
- Sipas tabelës bashkëlidhur.

Kryefamiljare 31 familje,

family
epto:

list - Armand Sula, Rovena Mullara, Paola Demiri, Festime Ele

BASHKIA TEPELENE

LISTE PAGESA E NDIHMES EKONOMIKE FONDE BASHKISE

KORRIK 2025

F BASHKISE

Nr	Emri e Mbiemri			SHUMA GJITHSEJ	Nr.kartes ID	firme
1	ARTUR MAMUT ALIAJ	2000		2000	H10711015Q	
2	SABRI NUHARREM CUNA	2000		2000	G20214013A	
3	NAFIJE VANGJEL MULLARA	2000		2000	G66005007N	
4	SIMJON SHKELQIM CUNA	3000		3000	J70915039E	
5	MIKEL NOVruz MECO	3000		3000	J20517033S	
6	MYZAFER LICO LICAJ	3000		3000	G60101027V	
7	KOSTANOVA AGIM BEJKO	2000		2000	J51244029V	
8	MECO MITAT HYSENAGARAJ	3000		3000	G2091017M	
9	RUDIN VANGJEL CUNAJ	3000		3000	H30304134G	
10	PETRIT DAJLAN KARAFILI	2000		2000	F70316166U	
11	KASTRIOT XHEVAT VARFA	3000		3000	G40626073B	
12	SHPRESA SHAQO KASA	5000		5000	F96025026G	
13	DRITA HASAN DERVISHI	3000		3000	G55222023O	
14	ALKETA SHEFIT KALEMI	2000		2000	H15520059K	
15	BAJAME ALI RUSMAILI	3000		3000	G85715166J	
16	SKENDER BANUSH BEGA	3000		3000	H00309096L	
17	BUJAR DILAVAR ABEDINI	3000		3000	H40508027V	
18	ILIR HAJDAR DEHARI	2000		2000	H60425022T	
19	GJYLO MYFYT MERJO	2000		2000	G40616138V	
20	AGIM TAFIL CELA	3000		3000	G20704130H	
21	MAJLINDA EQEREM BAKO	2000		2000	G75507027F	
22	QENDRIME VELEDIN RACO	2000		2000	F76210022S	
23	DONIKA LESKO CANA	2000		2000	G25615032K	
24	AGRON VELEDIN CAUSHI	3000		3000	G01002022C	
25	ALKETA ILIJAZ SHEHU	3000		3000	H05708145V	
26	MERZALINDA LULEZIM SULAJ	3000		3000	K55416013K	
27	MONIKA SAFET BETA	3000		3000	H65711015I	
28	MARINELA QENDRIM CUNA	3000		3000	J95314024P	
29	KALEM ABDULLA BEQA	3000		3000	G50425039L	
30	HYSEN XHELAL ISMAILI	3000		3000	G470101038L	
31	DITURI FEJZO ELMAZAJ	2000		2000	H75316057U	
32	ANULA KANAN MAMA	3000		3000	H15606025F	
33	BRULINDA MYRTEZAN KERI	3000		3000	I25419039N	
34	ORGEST BUJAR META	2000		2000	J71116016S	
	SHUMA	91000		91000		

ADMINISTRATORI SHOQEROR Armand Sala

LISTE PAGESA E NDIHMES EKONOMIKE

Korrik 2025

F BASHKISE

Nr	Emri Atesia Mbiemri		SHUMA GJITHSEJ	Nr.kartes ID	FIRME
1	KRISTINA ARQILE RAPI	3000	3000	I35916023F	
2	AGIM MUHAMET MUCOPATA	2000	2000	F60518021A	
3	FLAMUR BALIL GJYRDEDI	2000	2000	H31101015V	
4	ILIR FEJZO GERBI	2000	2000	H80321021N	
5	ILIR HYSNI BODECI	2000	2000	H10402044V	
6	BLERTA ISMET GJOKTHOMI	2000	2000	H15415047F	
7	TATJANE PAJTIM HOXHA	2000	2000	G55528227F	
8	PERPARIM QANI AHMETI	2000	2000	G01217116W	
9	DIAMANTA RAMIS BALLIA	2000	2000	H85903017P	
10	SADIK MUSTAFA VARFI	4000	4000	G01228146H	
11	BUJAR MUHAMET BRAHA	2000	2000	H40820026N	
12	NEXHMIJE HODO XHEBRA	2000	2000	G25221012O	
13	AHMET ISLAM BEQIRI	2000	2000	F90916013O	
14	VALDET LUTO SINORUKA	3000	3000	H20801038I	
15	PELLAGJI ILMU KUCA	2000	2000	F15204120Q	
16	FILE TAIP MUCA	2000	2000	G35124007O	
17	JULIANA ILIRJAN IMERA	3000	3000	J75724026W	
18	ARBEN BELUL GROSHI	2000	2000	H51031013Q	
19	DANILO EGZANT MURATA	2000	2000	J20924029O	
20	KLEOPARTA VIRION HAXHIA	2000	2000	J45105023U	
21	NOVRUS ASLLAN GJINUSHI	2000	2000	G50328028I	
22	VEZIKO SEIT BEJKO	2000	2000	I30920186B	
23	SABAJETE MUSA MALKA	2000	2000	G75821064T	
24	ZOTO IMER CANI	2000	2000	F51025081R	
25	FATJON HEKURAN REDHI	2000	2000	I40330207J	
26	JETNOR SAKO BRAHA	2000	2000	H60718028S	
27	TEFIK LUTFI HOXHA	2000	2000	G60504075V	
28	FATOS SULO HALILI	2000	2000	G80530116K	
29	HASKO BRAHO DURA	2000	2000	G70117103Q	
30	XHEVAT ZOTO LAZAJ	4000	4000	G10930069W	
31	KRENAR VESEL KABA	2000	2000	G80109013B	
32	ASQERI KAMBER ALA	2000	2000	G80311019T	
33	SOKRAT GUCE KASNECI	2000	2000	G60718020W	
34	PIRO LIPE XHIME	2000	2000	H00826020O	
35	ADRIATIK NESHET BEGA	2000	2000	H50725160W	
36	SHKELQIM SHERIF HAXHA	2000	2000	G31113008F	
37	BAIR KADRI FATIA	2000	2000	H80725023P	
38	YLLI LUTFI BECA	2000	2000	H20321027J	
39	SKENDER SHENASI KONDI	2000	2000	H50615044E	

40	ENGJELL HAJRO BECA	2000	2000	F70308099M	
41	FRUZELA HAXHI DERVISHI	5000	5000	I15912014H	
42	MENTOR GJOLEK KUÇI	2000	2000	H40918018P	
43	XHEVAIR BAKIR MUÇAJ	3000	3000	G30602025W	
44	MINA APOSTOL GJOKA	2000	2000	G11231013R	
45	STAVRI MYNYR GROSHI	3000	3000	J15912014H	
46	MARSIDA KOSTA ALEKSI	3000	3000	I75328026G	
47	HEROINA QAZIM ZENELI	3000	3000	H15206019S	
48	AFRIM VELEDIN BECA	2000	2000	H00719015J	
49	HEDO YMER GOXHA	2000	2000	F35702049L	
50	ALBAN SAMI MUCI	5000	5000	I10221029W	
51	MEGLI PERPARIM HAXHIA	2000	2000	I40605044A	
52	LEDJON ELMAS BECA	5000	5000	I91219020T	
	SHUMA	124000	124000		

ADMINISTRATOR SHOQEROR
ROVENA MULLARA



NJESIA ADMINISTRATIVE LOPES

LISTPAGESA E NDIHMES EKONOMIKE
FONDI I BASHKIS

KORRIK 2025

NR	EMRER	ATESIA	MBIEMER	ID	SHUMA	SHUMA GJITHSEJ	FIRME
1	TEKI	KASTERIOT	ELEZAJ	J00224032L	3000	3000	
2							
3							
SHUMA GJITHSEJ					3000		

ADMINISTRATOR SHOQEROR
FESTIME ELEZI



 NJESIA ADMINISTRATIVE KURVELESH

FONDI I BASHKISE KORRIK 2025

NR	EMER MBIEMER			SHUMA GJITHSEJ	NR KARTE ID
1	ALFRED ABEDIN LENA	3000		3000	H80511040V
2	BANUSH GUXH META	2178		2178	F90308126Q
3					
		0		0	
		0		0	
	SHUMA TOTALE	5178		5178	

ADMINISTRATORI SHOQEROR

PAOLA DEMIRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KESHILLI

PROJEKT VENDIM

Nr. Datë __.__. 2025

Nr. 142/pot

Dt. 20.08.2025

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË
BASHKISË TEPELENË 2026 - 2028"**

Këshilli i Bashkisë Tepelenë pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës __.__.2025.

V E N D O S I

1. Të miratojë Planin e Arsimit Parauniversitar 2026 – 2028 të Bashkisë Tepelenë, bashkëngjitur këtij dokumenti.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria Ekonomike e Finacës dhe Buxhetit .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARË NE DËTYRË E BASHKISË

Julinda Kartëri



KRYETARI

Arben Gumëni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KRYETARI

Nr. ____ Prot

Tepelenë, më ____ . ____ . 2025

RELACION
PËR
PROJEKT VENDIM

Nr. ____ Datë ____ . ____ . 2025

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË
BASHKISË TEPELENË 2026 - 2028"**

Të nderuar Këshilltarë !

Bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, propozojmë të miratohet nga Këshilli Bashkiak, "Plani i arsimit parauniversitar 2026 – 2028 të Bashkisë Tepelenë.


Plani i Arsimit Parauniversitar i Bashkisë Tepelenë 2026 – 2028 është hartuar si pjesë e angazhimeve ligjore dhe institucionale të bashkisë për garantimin e ofrimit të shërbimeve arsimore cilësore, të aksesueshme dhe të përputhshme me nevojat e komunitetit.

Plani është hartuar në zbatim të kuadrit ligjor dhe strategjik kombëtar dhe vendor, konkretisht:

- Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";

Hartimi i këtij plani është i diktuar nga nevoja për të:

- Siguruar akses të barabartë dhe kushte optimale mësimi për të gjithë fëmijët dhe nxënësit e arsimit parauniversitar, nga kopshti deri në arsimin e mesëm të përgjithshëm;
- Përmirësuar infrastrukturën arsimore, përfshirë rikonstrukcionin e institucioneve kryesore dhe eliminimin e problematikave ekzistuese;
- Rritur cilësinë e mësimdhënies përmes trajnimit të vazhdueshëm të stafit arsimor dhe mbështetës, dhe përdorimit të metodologjive bashkëkohore;
- Forcuar bashkëpunimin midis shkollës, familjes dhe komunitetit;



Në këtë plan, synojmë të kemi një sistem arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës, që garanton akses të barabartë, kushte optimale mësimi, mjedise të sigurt dhe mbështetje të plotë zhvillimore për çdo fëmijë e nxënës, duke forcuar kapacitetet njerëzore e infrastrukturore, promovuar metoda bashkëkohore dhe ndërtuar partneritete të qëndrueshme për zhvillimin arsimor, social e kulturor të brezave të rinj.

Duke marrë në konsideratë analizat e deritanishme mbi shpërndarjen gjeografike të institucioneve arsimore, kapacitetet e burimeve njerëzore, boshllëqet në infrastrukturë dhe nivelin e pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim, Bashkia Tepelenë angazhohet të ndjekë këto qëllime dhe objektiva strategjike:

Qëllimi (Q1). Të garantohet funksionimi i qëndrueshëm, cilësor dhe gjithëpërfshirës i institucioneve të arsimit parauniversitar (parashkollor, bazë dhe i mesëm i përgjithshëm) në territorin e bashkisë, duke siguruar kushte optimale për mësimdhënie, mirëqenie dhe zhvillim të fëmijëve dhe nxënësve.

- **Objektivi 1.1** Të sigurohet mbulimi i plotë me staf arsimor dhe staf të shërbimeve mbështetëse, si dhe ofrimi i infrastrukturës, kushteve higjieno-sanitare, sistemeve të ngrohjes dhe furnizimeve të nevojshme për të gjitha institucionet arsimore në kuadër të garantimit të cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimit: *15 Kopshte; 19 Shkolla; 1 Qendër kulturore; 1 Konvikt.*
- **Objektivi 1.2** Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Tepelenë të përfundojë rikonstruksionin e të paktën një shkolle 9-vjeçare dhe një institucioni parashkollor, si dhe të krijojë e funksionalizojë një regjister digjital të qendëruar për institucionet arsimore, me përditësim vjetor të të dhënave, për të përditësuar dhe monitoruar progresin e treguesve të performancës së shërbimit.

Qëllimi (Q2) Të garantohet ofrimi i një edukimi parashkollor cilësor dhe gjithëpërfshirës, i bazuar në standarde bashkëkohore të mësimdhënies dhe mbështetjes zhvillimore, përmes fuqizimit të kapaciteteve të stafit edukativ e mbështetës, përdorimit të metodologjive inovative dhe nxitjes së shkëmbimit të praktikave të mira, duke siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar.

- **Objektivi 2.1** Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Tepelenë, në bashkëpunim me MASR dhe partnerët lokalë e ndërkombëtarë, të zhvillojë dhe zbatojë një program të vazhdueshëm trajnimi për të gjithë edukatorët dhe stafin mbështetës të institucioneve parashkollore në territorin e saj, duke realizuar të paktën 4 module trajnimi praktike çdo vit, me synim që 100% e edukatorëve të aplikojnë metodologji bashkëkohore dhe mjete didaktike inovative në punën me fëmijët, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies dhe zhvillimin e fëmijëve.
- **Objektivi 2.2** Të sigurohet mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe nxënësit në institucionet arsimore përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, forcimit të strukturave pjesëmarrëse dhe këshilluese, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, si dhe mbështetjes së

BASHKIA TEPELENE

fëmijëve nga familjet në nevojë dhe atyre me rezultate të shkëlqyera, duke garantuar akses të barabartë, përfshirje aktive dhe zhvillim të plotë në procesin arsimor.

Qëllimi (Q3) Të zhvillohen dhe të institucionalizohen aktivitete të rregullta kulturore, sportive, mjedisore dhe ndërgjegjësuere në të gjitha institucionet arsimore, me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe mbështetjen e stafit pedagogjik, prindërve dhe komunitetit, me qëllim nxitjen e zhvillimit të përgjithshëm, forcimin e bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet dhe promovimin e vlerave të diversitetit, solidaritetit dhe përfshirjes sociale.


- **Objektivi 3.1** Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Tepelenë, në bashkëpunim me institucione dhe organizata partnere, organizon çdo vit të paktën 10 aktivitete kulturore, sportive, edukative dhe sensibilizuese në të gjitha njësitë administrative, me pjesëmarrjen e $\geq 80\%$ të fëmijëve/nxënësve (përfshi grupet vulnerabël) dhe përfshirjen e partnerëve institucionalë e komunitarë, për të nxitur zhvillimin gjithëpërfshirës, ruajtur trashëgiminë kulturore dhe forcuar lidhjen shkollë–komunitet.

Financimi i planit do të mbështetet në burime të kombinuara nga buxheti vendor, transfertat specifike dhe të pakushtëzuara nga qeveria qendrore, si dhe nga bashkëpunimi me partnerë zhvillimi, organizata dhe donatorë. Plani parashikon një buxhet total prej 11,94 milionë lekësh për investimet kapitale gjatë periudhës 2026–2028, si dhe fonde të dedikuara për shpenzime operative, paga dhe sigurime shoqërore për personelin arsimor, të mbuluara nga buxheti vendor, transfertat e pakushtëzuara dhe të kushtëzuara.

Plani përmban gjithashtu mekanizma të qartë të monitorimit, tregues matës të progresit dhe ndikimit, raportim vjetor, rishikim afatmesëm dhe pjesëmarrje të aktorëve lokalë dhe komunitetit në vlerësim.

Duke vlerësuar përmbajtjen e planit, qasjen strategjike dhe qartësinë e objektivave të tij, si dhe duke pasur parasysh domosdoshmërinë për të përballuar sfidat aktuale të arsimit në territorin e Bashkisë Tepelenë, mbështetur në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma “b”, nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma “k”, neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, paraqesim për shqyrtim dhe miratim projekt vendimin “Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026–2028 të bashkisë Tepelenë”, si dokumenti udhëheqës i veprimtarisë arsimore dhe planifikimit buxhetor të lidhur me sektorin e arsimit parauniversitar.

Konc: Drejtor : _Arta Shaha





KRYETARE NE DETYRE I BASHKISE

Julinda Kartëri







BASHKIA TEPELENE



PLANI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



Përmbajtja

1.	Hyrje dhe konteksti.....	6
	Konteksti administrativ	6
	Të dhëna demografike.....	6
	Struktura e popullsisë së re.....	7
	Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor.....	7
2.	Analiza e ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025.....	9
	Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të kopshteve	9
	Frekuentimi	9
	Shërbimi psiko-social në arsimin parashkollor	10
	Shërbimi i vakteve ushqimore në arsimin parashkollor	10
	Përfshirja e fëmijëve të komunitetit egjyptian	10
3.	Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit	11
	Frekuentimi sipas niveleve arsimore.....	12
	Frekuentimi në arsimin fillor.....	12
	Frekuentimi në arsimin 9-vjeçar.....	12
	Frekuentimi në arsimin e mesëm.....	13
4.	Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative	13
	Njësia Administrative: Tepelenë.....	13
	Shkollat:.....	13
	Kopshtet.....	13
	Njësia Administrative: Qendër Tepelenë	13
	Shkollat:.....	13
	Kopshtet.....	14
	Njësia Administrative: Kurvelesh	14
	Shkollat:.....	14
	Kopshtet.....	14
	Njësia Administrative: Lopës.....	14
	Shkollat:.....	15
	Kopshtet.....	15
	Qendra Kulturore e Fëmijëve “Nimete Progonati”	15
	Konvikti i nxënësve.....	15
	Mbështetja me transport për nxënësit.....	15
	Shërbimi i siguri në shkolla.....	16
5.	Burimet njerëzore në Arsimin Parauniversitar dhe shërbimet mbështetëse	16
6.	Vizioni	17
7.	Qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar	18

8. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar	19
Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor	19
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	19
9. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)	21
10. Plani i investimeve kapitale	37
Planifikimi i investimeve për arsimin bazë dhe atë të mesëm	37
Planifikimi i investimeve për arsimin parashkollor	37
Monitorimi dhe vlerësimi	38
Treguesit e performancës	38
Planifikimi i vlerësimit të progresit	38
Përfshirja e aktorëve të jashtëm	38
Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi	38
Monitorimi i realizimit të aktiviteteve	38
Vlerësimi i ndikimit në komunitet	39
11. Rishikimi dhe përshtatja e planit	39
Procesi i rishikimit	39
Përshtatja e masave dhe aktiviteteve	40
12. Raportimi dhe transparenca	40
13. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar	41

Parathënie

Plani i Arsimit Parauniversitar të Bashkisë Tepelenë për periudhën 2026–2028 është një dokument strategjik që përfaqëson angazhimin e bashkisë për të garantuar një sistem arsimor modern, cilësor dhe gjithëpërfshirës, ku çdo fëmijë dhe nxënës – nga kopshti deri në arsimin e mesëm të përgjithshëm – të ketë akses të barabartë në kushte optimale mësimi, mjedise të sigurta dhe mbështetje të plotë zhvillimore.

Ky plan mbështetet mbi dy shtylla kryesore:

- Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore, duke siguruar staf të kualifikuar dhe mjedise të përmirësuara për të gjitha institucionet arsimore;
- Nxitja e partneriteteve të qëndrueshme mes shkollës, familjes dhe komunitetit, për të forcuar lidhjen sociale dhe zhvillimin kulturor të brezave të rinj.

Në kuadër të këtij plani, janë përcaktuar objektiva strategjike që fokusohen në mbulimin e plotë me staf arsimor dhe mbështetës, rikonstruksionin e shkollave dhe kopshteve kryesore, zhvillimin e kapaciteteve profesionale të edukatorëve, mbështetjen gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe nxënësit, si dhe organizimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe sensibilizuese në të gjitha njësitë administrative.

Projektet prioritare për periudhën 2026–2028 përfshijnë rikonstruksionin e plotë të Shkollës 9-vjeçare “7 Marsi” dhe ndërhyrje kapitale në Kopshtin “Murat Koçi” për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, eliminimin e lagështirës dhe zëvendësimin e dritareve. Gjithashtu, parashikohet ngritja e një regjistri digjital të centralizuar për të gjitha institucionet arsimore, si bazë për planifikim dhe monitorim të vazhdueshëm.

Plani i investimeve kapitale, me një fond prej 11,94 milionë lekësh për periudhën 2026–2028, reflekton qartë orientimin e Bashkisë Tepelenë drejt përmirësimit të kushteve të të nxënës dhe krijimit të një mjedisi arsimor të sigurt, bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës.

Ky dokument është rezultat i bashkëpunimit të gjerë me institucionet arsimore, komunitetin lokal dhe partnerët zhvillimorë, dhe shërben si udhërrëfyes për veprimet konkrete që do të ndërmerren për të ndërtuar të ardhmen arsimore të Tepelenës.

Falënderime

Bashkia Tepelënë shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Tepelenës, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.

Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioritetëve të komunitetit.

Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Tepelenë.

1. Hyrje dhe konteksti

Konteksti administrativ

Bashkia Tepelenë është një njësi e rëndësishme e qeverisjes vendore në qarkun e Gjirokastrës, me një territor prej 431.24 km² dhe një popullsi prej 15,118 banorësh sipas të dhënave të Regjistrit Civil (densiteti rreth 15 banorë/km²). Kryeqendra e saj është qyteti i Tepelenës, i njohur për historinë, trashëgiminë kulturore dhe potencialin e madh për zhvillimin e turizmit kulturor e natyror.

Bashkia kufizohet:

- Në veri me bashkinë Memaliaj,
- Në lindje me bashkinë Këlcyrë,
- Në jug me bashkinë Gjirokastrë,
- Në perëndim me bashkitë Himarë dhe Selenicë.

Struktura administrative përbëhet nga 4 njësi administrative: Tepelenë, Qendër Tepelenë, Lopës dhe Kurvelesh, të cilat përfshijnë një qytet dhe 24 fshatra. Ky organizim përfaqëson një ndërthurje të zonave urbane dhe rurale, duke ndikuar në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare, si dhe në ofrimin e shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar.

Territori i bashkisë përfshin zona me diversitet gjeografik ku aktivitetet kryesore ekonomike përqendrohen në blegtori, shërbime të vogla tregtare dhe mbledhjen e bimëve medicinale. Pasuritë kulturore dhe natyrore si Kalaja e Ali Pashës, Kanioni i Bënçës, Ura e Beçishtit dhe Uji i Ftohtë përbëjnë baza të rëndësishme për zhvillimin e turizmit.

Ky profil gjeografik dhe ekonomik ndikon në sfidat e aksesueshmërisë dhe kërkon planifikim të kujdesshëm të shërbimeve arsimore në të gjithë territorin.

Të dhëna kryesore:


- **Qendra e bashkisë:** Qyteti i Tepelenës
- **Sipërfaqja:** 431.24 km²
- **Popullsia:** 15,118 banorë
- **Dendësia:** 15 banorë/km²
- **Njësitë administrative:** 4 Njësi – Tepelenë, Qendër Tepelenë, Lopës dhe Kurvelesh
- **Fshatra:** 24

Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit, Bashkia Tepelene numëron 15,118 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 6,479 meshkuj dhe 8,639 femra. Popullsia është e shpërndarë në 4 Njësi – Tepelenë, Qendër Tepelenë, Lopës dhe Kurvelesh

Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë dhe njësive administrative paraqitet si vijon:

- **Tepelenë:** 3,854 meshkuj – 3,855 femra
- **Qendër Tepelenë:** 2,104 meshkuj – 3,132 femra
- **Lopës:** 263 meshkuj – 254 femra
- **Kurvelesh:** 258 meshkuj – 241 femra



Kjo strukturë demografike reflekton një shpërndarje të përafërt mes gjinisë mashkullore dhe femërore në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Tepelenë, me një diferencë shumë të vogël në numër mes dy gjinive. Njësia administrative më e populluar është Tepelena, e ndjekur nga Qendër Tepelena, ndërsa Lopësi dhe Kurveleshi kanë popullsi dukshëm më të ulët. Kjo përbërje demografike ka ndikim të drejtpërdrejtë në planifikimin e shërbimeve publike dhe arsimore, sidomos për garantimin e aksesit dhe cilësisë së arsimit parauniversitar në të gjithë territorin e bashkisë.

Struktura e popullsisë së re

Të dhënat demografike për grupmoshat e reja në Bashkinë Tepelenë tregojnë një shpërndarje të tillë:

- **0–4 vjeç:** 210 banorë
- **5–9 vjeç:** 285 banorë
- **10–14 vjeç:** 349 banorë
- **15–19 vjeç:** 347 banorë

Kjo strukturë tregon se grupmosha më e madhe është ajo 10–14 vjeç me 349 banorë, e ndjekur nga grupmosha 15–19 vjeç me 347 banorë. Numri më i ulët i popullsisë është tek fëmijët 0–4 vjeç (210 banorë), duke sinjalizuar një tendencë të mundshme të uljes së lindjeve në vitet e fundit.

Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Tepelene në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe politik, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike për garantimin e të drejtës për arsim.

Bazën më të lartë ligjore e përbën Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ku në nenin 57, pika 1, sanksionohet e drejta për arsim për të gjithë qytetarët. Kjo e drejtë konkretizohet më tej përmes Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar me Ligjin nr. 48/2018, i cili përcakton strukturën dhe funksionimin e arsimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional. Ky ligj rregullon gjithashtu standardet e cilësisë, përfshirjes, vlerësimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” u njeh bashkive kompetenca të plota për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbështetëse në arsimin bazë dhe të mesëm, përmes sigurimit të infrastrukturës, përfshirjes sociale dhe koordinimit me institucionet qendrore. Këto funksione financohen dhe mbështeten në përputhje me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit financiar në nivel vendor. Po ashtu, Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, shërben si mjet për mobilizimin e të ardhurave që bashkia mund të përdorë për të mbështetur sektorin e arsimit.

Në nivel zbatimi, funksionimi i institucioneve arsimore rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore. Ndër më të rëndësishmet është Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020, që miraton rregulloren e përgjithshme për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, si dhe Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, që përcakton normat për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore për mësuesit. Po ashtu, udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI nr. 13, datë 10.07.2024, specifikon organizimin e vitit shkollor 2024–2025, ndërsa Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, përcakton ngritjen dhe funksionimin e bordeve të institucioneve arsimore, si mekanizma pjesëmarrjeje dhe monitorimi. Një dokument me rëndësi për cilësinë e arsimit parashkollor është edhe Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024, që miraton Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshteve.

Në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Bashkia Tepelene udhëhiqet gjithashtu nga Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, të cilët kërkojnë ndërhyrje të koordinuara për mbështetjen e fëmijëve në nevojë dhe parandalimin e përjashtimit social. Në këtë drejtim, udhëzime specifike si Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë, dhe Plani Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025, përbëjnë udhërrëfyes për politikat lokale në territorin e Bashkisë Tepelene.


Një fushë me rëndësi të veçantë është edhe ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte, i cili rregullohet me Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, si dhe me udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor, të hartuar për stafet e bashkive dhe të zyrave vendore arsimore. Gjithashtu, për të garantuar një ambient të sigurt dixhital për fëmijët, zbatohet Udhëzimi i përbashkët MAS-MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, i cili përcakton masa për mbrojtjen e tyre nga përmbajtjet e dëmshme në internet.

Nëpërmjet këtij kuadri të gjerë ligjor dhe politik, Bashkia Tepelene vepron si një aktor kyç në zbatimin e politikave arsimore dhe sociale, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve në territorin e saj. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me Zyrën Vendore Arsimore dhe institucionet e tjera publike, synohet ndërtimi i një sistemi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë.

2. Analiza e ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025

Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të kopshteve

Në Bashkinë Tepelenë shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Tepelenë funksionojnë **15 kopshte** të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.



Frekuentimi

Në bashkinë Tepelenë, sipas të dhënave më të fundit (census 2023), numri total i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç është 159, prej të cilët 85 janë djem dhe 74 janë vajza. Nga kjo popullsi, 87 fëmijë ndjekin institucionet parashkollore (kopshtin), konkretisht 46 djem dhe 41 vajza.

Kjo përfaqëson një përqindje të përgjithshme prej 54.72% të fëmijëve që janë të përfshirë në arsimimin parashkollor.

Të dhënat mbi përfshirjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor tregojnë se në total 54.72% e fëmijëve ndjekin kopshtin. Brenda këtij grupi, përqindja e përfshirjes ndryshon midis gjinive: 54.12% e djemve dhe 55.41% e vajzave janë të përfshirë në edukimin parashkollor. Ky ndryshim, tregon prirje që mund të ndikohen nga faktorë lokalë si infrastruktura, ndërgjegjësimi prindëror apo mundësitë ekonomike.

Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuar në:

- rritjen e ndërgjegjësimit komunitar dhe
- përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor,

me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 3–6 vjeç në territorin e Bashkisë Tepelenë.

Shërbimi psiko-social në arsimin parashkollor

Në institucionet parashkollore të Bashkisë Tepelenë, shërbimi psiko-social ofrohet në bashkëpunim të ngushtë me psikologët dhe punonjësit socialë të Zyrës Vendore të Arsimit (ZVA), të cilët janë të angazhuar kryesisht në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm. Për shkak të numrit relativisht të ulët të fëmijëve në kopshte, nuk është i dedikuar një psikolog i posaçëm për institucionet parashkollore.

Ky model organizimi synon të sigurojë mbështetje psiko-sociale për fëmijët e moshës së hershme nëpërmjet vizitave periodike dhe ndërhyrjeve të planifikuara nga stafi specialist, duke garantuar identifikimin dhe adresimin e hershëm të nevojave emocionale, sociale dhe zhvillimore të fëmijëve. Analiza e shërbimit në shkollat e arsimit bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025

Shërbimi i vakteve ushqimore në arsimin parashkollor

Në Bashkinë Tepelenë, shërbimi i vakteve ushqimore ofrohet vetëm në Kopshtin me drekë “Murat Koçiu”, i cili ndodhet në qendër të qytetit të Tepelenës. Ky institucion frekuentohet nga rreth 50 fëmijë, të cilët përfitojnë vaktet ushqimore gjatë qëndrimit në kopsht, sipas djetës së miratuar. Ofrimi i këtij shërbimi ka një rol të rëndësishëm jo vetëm në përmirësimin e ushqyerjes dhe shëndetit të fëmijëve, por edhe në lehtësimin e angazhimit të prindërve, sidomos atyre që punojnë me orar të plotë.

Përfshirja e fëmijëve të komunitetit egjiptian

Në Kopshtin “Murat Koçiu” në qytetin e Tepelenës ndjekin edukimin parashkollor gjithsej 11 fëmijë nga komuniteti egjiptian. Bashkia Tepelenë ka marrë masa të posaçme mbështetëse për këta fëmijë, duke garantuar ofrimin falas të vakteve ushqimore në rastet kur ata i përkasin familjeve me ndihmë ekonomike ose kanë vetëm një prind kujdestar.

Ky mekanizëm mbështetjeje synon të sigurojë përfshirjen e plotë të fëmijëve nga komunitetet vulnerabël në arsimin parashkollor, të përmirësojë ushqyerjen e tyre dhe të lehtësojë barrën ekonomike të familjeve, duke krijuar kushte të barabarta për zhvillimin dhe mirëqenien e tyre.


3. Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit

Në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë janë të shpërndara gjithsej 16 institucione arsimore të niveleve të ndryshme, të cilat mbulojnë të gjitha njësitë administrative.

Ky organizim krijon një rrjet të thjeshtë por funksional të arsimit parauniversitar, që shtrihet në të gjithë territorin dhe reflekton angazhimin institucional për të mbuluar sa më mirë nevojat arsimore të komunitetit në çdo njësi administrative.

RRJETI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE NË BASHKINË TEPELENË

Në territorin e Bashkisë Tepelenë janë të shpërndara gjithsej 16 institucione arsimore të niveleve të ndryshme.



Ky rrjet arsimor përfshin institucione të niveleve të ndryshme, të strukturuar sipas ciklit të edukimit që ofrojnë:

Shkolla fillore – 4 gjithsej

Në Bashkinë Tepelenë nuk ka institucione që ofrojnë vetëm ciklin fillor në mënyrë të pavarur; ky nivel është i integruar brenda strukturës së shkollave 9-vjeçare. Gjithsesi, në disa njësi administrative ekzistojnë shkolla me ciklin fillor të veçantë për fazat e para të arsimit:

- Njësia Qendër: 2 shkolla fillore
- Kurvelesh: 1 shkollë fillore
- Lopës: 1 shkollë fillore

Shkolla 9-vjeçare – 14 gjithsej

Ky nivel përfshin si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, duke ofruar një arsim bazë të plotë. Shkollat 9-vjeçare janë të shpërndara në mënyrë që të mbulojnë të gjitha njësitë administrative dhe kanë rol kyç në zhvillimin akademik, shoqëror dhe kulturor të nxënësve, si dhe në përgatitjen e tyre për arsimin e mesëm. Shpërndarja është si vijon:

- Tepelenë: 2 shkolla 9-vjeçare (“7 Marsi”, “Avni Rustemi”)
- Njësia Qendër: 8 shkolla 9-vjeçare
- Kurvelesh: 2 shkolla 9-vjeçare
- Lopës: 2 shkolla 9-vjeçare

Shkolla të mesme – 1 gjithsej

Në territorin e Bashkisë Tepelenë funksionon një gjimnaz i vendosur në qendër të Tepelenës, i cili ofron arsimin e mesëm të përgjithshëm. Ky institucion pajis nxënësit me njohuri të nevojshme për vazhdimin e studimeve universitare, si dhe aftësi praktike për tregun e punës. Vendosja e tij në zonë qendrore u mundëson nxënësve nga të gjitha njësitë administrative të kenë akses në këtë nivel arsimor.

Frekuentimi sipas niveleve arsimore

Frekuentimi në arsimin fillor

Gjinia	Numri i Nxënësve në arsimin fillor	Përqindja (%)
Djem	157	56.07
Vajza	123	43.93

Në arsimin fillor, sipas të dhënave të fundit të Censurit, janë të regjistruar gjithsej 280 nxënës, nga të cilët 157 janë djem (56.07%) dhe 123 vajza (43.93%). Kjo ndarje tregon një përqindje më të lartë të djemve në raport me vajzat në këtë nivel arsimor. Përfshirja ndryshon nga njësi në njësi, e ndikuar nga faktorë lokalë si infrastruktura, distanca nga shkolla, gjendja

ekonomike e familjeve dhe mundësitë që ofron komuniteti. Për të siguruar pjesëmarrje të barabartë, nevojitet vijimi i politikave dhe mbështetjes institucionale për kushte optimale të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Frekuentimi në arsimin 9-vjeçar

Gjinia	Numri i Nxënësve në arsimin 9-vjeçar	Përqindja (%)
Djem	139	48.26
Vajza	149	51.74

Në arsimin 9-vjeçar, sipas të dhënave të fundit të Censurit, janë të regjistruar gjithsej 288 nxënës, nga të cilët 139 janë djem (48.26%) dhe 149 vajza (51.74%). Kjo shpërndarje tregon një raport më të balancuar mes gjinive, me një përqindje pak më të lartë të vajzave. Variacionet mes njësive administrative lidhen me specifikat

demografike dhe sociale të zonave përkatëse. Kjo e bën të domosdoshëm monitorimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes dhe zbatimin e politikave mbështetëse që sigurojnë vijimësinë e shkollimit për çdo fëmijë.

Frekuentimi në arsimin e mesëm

Gjinia	Numri i Nxënësve në arsimin e mesëm	Përqindja (%)
Djem	133	58.33
Vajza	95	41.67

Në arsimin e mesëm, sipas të dhënave të fundit të Censurit, janë të regjistruar gjithsej 228 nxënës, nga të cilët 133 janë djem (58.33%) dhe 95 vajza (41.67%). Kjo tregon një diferencë të dukshme në favor të djemve, çka mund të lidhet me faktorë të tillë si zgjedhjet individuale, preferenca për arsimin profesional apo migrimi i

herëshëm i vajzave drejt arsimit universitar jashtë bashkisë. Për të garantuar një pjesëmarrje të balancuar gjinore, është e rëndësishme të ofrohen mundësi të barabarta për të dy gjinitë, duke përfshirë orientimin në karrierë, mbështetjen për transportin dhe zgjerimin e ofertës arsimore.

4. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative

Njësia Administrative: Tepelenë

Rrjeti arsimor në njësinë administrative Tepelenë përbëhet nga 3 shkolla dhe 3 kopshte.

Shkollat:

- Nga shkollat, 2 janë shkolla 9-vjeçare (“7 Marsi” dhe “Avni Rustemi”), të cilat ofrojnë ciklin fillor dhe atë të mesëm të ulët, dhe 1 është shkollë e mesme (gjimnaz) që u mundëson nxënësve të vijnë studimet e larta ose të hyjnë në tregun e punës me përgatitje profesionale.
- Shpërndarja gjeografike e institucioneve siguron akses të qëndrueshëm për nxënësit, si në zonën urbane të qendrës së bashkisë, ashtu edhe në lagjet periferike.

Lista e shkollave:

- Avni Rustemi
- Abaz Shehu
- 7 Marsi

Kopshtet

Rrjeti i kopshteve në këtë njësi përfshin 3 institucione që ofrojnë edukim parashkollor për fëmijët 3–6 vjeç, si dhe klasa përgatitore pranë shkollave.

- Kopshti Murat Koçiu në qendër ofron gjithashtu shërbimin e vakteve ushqimore për rreth 50 fëmijë.
- Dy klasa përgatitore funksionojnë pranë shkollave 7 Marsi dhe Avni Rustemi.

Lista e kopshteve:

- Murat Koçiu (Tepelenë)
- Murat Koçiu – klasa përgatitore pranë 7 Marsi
- Murat Koçiu – klasa përgatitore pranë Avni Rustemi

Njësia Administrative: Qendër Tepelenë

Kjo njësi ka një rrjet të përbërë nga 8 shkolla 9-vjeçare, 3 shkolla fillore dhe 9 kopshte.

Shkollat:

- Shkollat 9-vjeçare dhe fillore ofrojnë një arsim bazë të plotë, duke mbuluar si ciklin fillor ashtu edhe atë të mesëm të ulët. Vendndodhja e tyre në fshatra të ndryshme të njësisë siguron që fëmijët të kenë akses në arsim pranë vendbanimeve.

Lista e shkollave:

- *Memo Nexhipi, Dukaj, shkollë qendër 9 -vjeçare*
 - *Myslym Beluli, Veliqot (fillore)*
 - *Ferit Çela, Turan (fillore)*
 - *Pato Kuçi, Bënç (fillore)*
- *Nevro Selimi, Hormos*
 - *Misto shumeli, Kodër, (vartëse)*
 - *Sejdin Dosti, Dragot (vartëse)*
 - *Llikan Ceka, Peshtan (vartëse)*
 - *Xhafer Bani, Mezhgoran (vartëse)*
 - *Lame Kanani, Luzat (vartëse)*
- *Mustafa Zoto, Salari*

Kopshtet

Rrjeti i kopshteve përfshin **9 institucione** të shpërndara në fshatra, të cilat sigurojnë edukimin dhe përgatitjen e hershme për shkollë.

Këto kopshte mbulojnë një territor të gjerë rural dhe janë një mbështetje e rëndësishme për familjet, duke ofruar kushte edukative të përshtatshme.

Lista e kopshteve:

- Kopshti fshati Bencë
- Kopshti fshati Dukaj
- Kopshti fshati Hormovë
- Kopshti fshati Kodër
- Kopshti fshati Luzat
- Kopshti fshati Mamaj
- Kopshti fshati Salari
- Kopshti fshati Turan
- Kopshti fshati Veliqot

Njësia Administrative: Kurvelesh

Rrjeti arsimor i Kurveleshit përbëhet nga 2 shkolla 9-vjeçare, 1 shkollë fillore dhe 1 kopsht.

Shkollat:

- *Asim Zeneli, Progonat shkollë qendër 9 -vjeçare*
- *Shuko Dalipi, Nivicë, (vartëse) 9 -vjeçare*
- *Sina Kërpi, Lekdush, Fillore*

Kopshtet

Kopshti i vetëm në këtë njësi ndodhet në fshatin Progonat dhe luan një rol të rëndësishëm për përgatitjen e hershme të fëmijëve për arsimin bazë.

Lista e kopshteve:

- Kopshti fshati Progonat

Njësia Administrative: Lopës

Rrjeti arsimor i Lopësit përbëhet nga 2 shkolla 9-vjeçare, 1 shkollë fillore dhe 2 kopsht.

Shkollat:

- Selam Musai, Sinanaj, *shkollë 9 -vjeçare*
- Halil Rama, Dhëmbjan, *shkollë 9 -vjeçare*
- Sali Beqiri, Matohanaj, *fillore*

Kopshtet

Rrjeti i kopshteve përfshin **2 institucione** të shpërndara në fshatra, të cilat sigurojnë edukimin dhe përgatitjen e hershme për shkollë.

Lista e kopshteve:

- Kopshti fshatit Sinanaj
- Kopshti I fshatit *Dhëmbjan*

Qendra Kulturore e Fëmijëve “Nimete Progonati”

Qendra Kulturore e Fëmijëve “Nimete Progonati” është një institucion i rëndësishëm i edukimit kulturor dhe artistik në Bashkinë Tepelenë. Ajo frekuentohet nga mbi 210 fëmijë, jo vetëm nga qyteti i Tepelenës, por edhe nga të gjitha njësitë administrative, duke e shtrirë shërbimin e saj në të gjithë territorin e bashkisë.

Qendra ofron një gamë të gjerë aktiviteteve artistike, kulturore dhe edukative, të cilat synojnë zhvillimin e talenteve të fëmijëve dhe të rinjve në fusha të ndryshme si muzika, kërcimi, teatri, arti pamor dhe veprimtaritë komunitare.

Ky institucion shërben jo vetëm si hapësirë për zhvillim kreativ, por edhe si pikë takimi dhe bashkëpunimi për fëmijët e zonave urbane dhe rurale, duke nxitur përfshirjen sociale dhe shkëmbimin kulturor mes tyre. Përmes aktiviteteve të tij, Qendra Kulturore “Nimete Progonati” luan një rol të rëndësishëm në formimin e personalitetit, zhvillimin e aftësive shoqërore dhe forcimin e identitetit kulturor të brezit të ri në Bashkinë Tepelenë.

Konvikti i nxënësve

Konvikti i nxënësve në qytetin e Tepelenës shërben si një strukturë akomodimi për nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm dhe atë 9-vjeçar, por që vijnë nga fshatra të largëta të bashkisë. Aktualisht, ky institucion frekuentohet nga rreth 11 nxënës të gjimnazit dhe 4 nxënës të shkollës 9-vjeçare.

Konvikti ofron kushte bazë për banim, higjienë dhe siguri, duke mundësuar që nxënësit të ndjekin procesin arsimor pa u penguar nga distanca gjeografike apo vështirësitë e transportit. Ky shërbim luan një rol të rëndësishëm në garantimin e aksesit të barabartë në arsim për fëmijët e zonave rurale dhe të thella, duke kontribuar në vijueshmërinë e shkollimit dhe uljen e braktisjes.

Mbështetja me transport për nxënësit

Me vendim të Këshillit Bashkiak, 19 nxënës nga Njësia Administrative Lopës përfitojnë mbulimin e pagesës së shërbimit të transportit për të udhëtuar çdo ditë drejt qytetit të Tepelenës, ku ndjekin gjimnazin. Ky vendim synon të parandalojë braktisjen shkollore dhe të inkurajojë vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë për të rinjtë e zonave të largëta.

Kjo nismë, e mbështetur financiarisht nga Bashkia Tepelenë, përbën një praktikë të mirë dhe inovative në nivel kombëtar, duke krijuar kushte të barabarta për akses në arsim dhe duke lehtësuar barrën ekonomike të familjeve. Përmes saj, nxënësit e Lopës jo vetëm që mund të ndjekin mësimet

pa pengesa logjistike, por edhe përfitojnë nga një mbështetje institucionale që forcon përfshirjen dhe barazinë në arsim.

Shërbimi i sigurisë në shkolla

Policia bashkiake kujdeset për sigurinë rrugore dhe fizike të nxënësve gjatë orareve të hyrjes dhe daljes nga shkollat. Nga ora **08:00** deri në **13:00**, punonjësit e policisë vendosen pranë institucioneve arsimore për të ndihmuar kalimin e sigurt të fëmijëve dhe për të parandaluar incidentet.

5. Burimet njerëzore në Arsimin Parauniversitar dhe shërbimet mbështetëse

Në qytetin e Tepelenës, shërbimet për institucionet e arsimit parauniversitar sigurohen nga një rrjet punonjësish të dedikuar, të cilët kontribuojnë në funksionimin e përditshëm të kopshteve dhe shkollave, duke garantuar edukim dhe përkujdesje, mjedise të pastra, të sigurta dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit edukativ dhe mësimor.

Në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë, shërbimin në institucionet parashkollore e ofrojnë gjithsej **29 edukatorë – 16** të vendosur në kopshtet e qytetit dhe **13** në njësitë administrative – si dhe **2 drejtoresha kopshtesh** që koordinojnë punën e tyre.

Kopshtet e qytetit kanë në përbërje:

- **4 sanitare** për higjienën dhe mirëmbajtjen e ambienteve,
- **2 roje** për sigurinë e objekteve,
- **2 kuzhinierë** për përgatitjen e vakteve ushqimore,
- **1 magazinier** për menaxhimin e furnizimeve dhe materialeve.

Shkollat e qytetit kanë:

- 12 sanitare që sigurojnë pastërtinë e ambienteve,
- 6 roje për ruajtjen dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës.

Njësitë administrative kanë staf mbështetës të përqendruar në shkollat qendër, i cili mbulon edhe kopshtet përkatëse:

- 4 punonjës shërbimi (roje, mirëmbajtës dhe staf teknik sipas nevojës).
- Institucionet 4 sanitare

mbështetëse të tjera

Qendra Kulturore e Fëmijëve në Tepelenë ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore dhe edukimit kulturor e artistik të fëmijëve dhe të rinjve. Personeli përbëhet nga:

- **1 përgjegjës** për drejtimin dhe organizimin e veprimtarive,
- **2 instruktorë** për zhvillimin e aktiviteteve artistike e kulturore,
- **1 roje** për sigurinë e objektit.

Shërbimet mbështetëse sanitare të Qendrës Kulturore kryhen e Qendrës Kulturore.

Konvikti i nxënësve në Tepelenë ofron akomodim dhe mbështetje për nxënësit që vijojnë arsimin në qytet, por vijnë nga zona të tjera të bashkisë. Stafi i konviktit përfshin:

- **1 përgjegjës,**
- **1 sanitarë** për mirëmbajtjen dhe higjienën e ambienteve,
- **1 roje** për sigurinë e godinës.

6. Vizioni



Vizioni i Bashkisë Tepelenë për arsimin parauniversitar 2026–2028 është krijimi i një sistemi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës, që garanton akses të barabartë, kushte optimale mësimi, mjedise të sigurta dhe mbështetje të plotë zhvillimore për çdo fëmijë e nxënës, duke forcuar kapacitetet njerëzore e infrastrukturore, promovuar metoda bashkëkohore dhe ndërtuar partneritete të qëndrueshme për zhvillimin arsimor, social e kulturor të brezave të rinj.

7. Qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar

Duke marrë në konsideratë analizat e deritanishme mbi shpërndarjen gjeografike të institucioneve arsimore, kapacitetet e burimeve njerëzore, boshllëqet në infrastrukturë dhe nivelin e pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim, Bashkia Tepelenë angazhohet të ndjekë këto qëllime dhe objektiva strategjike:

Qëllimi (Q1). Të garantohet funksionimi i qëndrueshëm, cilësor dhe gjithëpërfshirës i institucioneve të arsimit parauniversitar (parashkollor, bazë dhe i mesëm i përgjithshëm) në territorin e bashkisë, duke siguruar kushte optimale për mësimdhënie, mirëqenie dhe zhvillim të fëmijëve dhe nxënësve.

- **Objektivi 1.1** Të sigurohet mbulimi i plotë me staf arsimor dhe staf të shërbimeve mbështetëse, si dhe ofrimi i infrastrukturës, kushteve higjieno-sanitare, sistemeve të ngrohjes dhe furnizimeve të nevojshme për të gjitha institucionet arsimore në kuadër të garantimit të cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimit: *15 Kopshte; 19 Shkolla; 1 Qendër kulturore; 1 Konvikt.*
- **Objektivi 1.2** Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Tepelenë të përfundojë rikonstruksionin e të paktën një shkolle 9-vjeçare dhe një institucioni parashkollor, si dhe të krijojë e funksionalizojë një regjistër digjital të qendëruar për institucionet arsimore, me përditësim vjetor të të dhënave, për të përditësuar dhe monitoruar progresin e treguesve të performancës së shërbimit.

Qëllimi (Q2) Të garantohet ofrimi i një edukimi parashkollor cilësor dhe gjithëpërfshirës, i bazuar në standarde bashkëkohore të mësimdhënies dhe mbështetjes zhvillimore, përmes fuqizimit të kapaciteteve të stafit edukativ e mbështetës, përdorimit të metodologjive inovative dhe nxitjes së shkëmbimit të praktikave të mira, duke siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar.

- **Objektivi 2.1** Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Tepelenë, në bashkëpunim me MASR dhe partnerët lokalë e ndërkombëtarë, të zhvillojë dhe zbatojë një program të vazhdueshëm trajnimi për të gjithë edukatorët dhe stafin mbështetës të institucioneve parashkollore në territorin e saj, duke realizuar të paktën 4 module trajnimi praktike çdo vit, me synim që 100% e edukatorëve të aplikojnë metodologji bashkëkohore dhe mjete didaktike inovative në punën me fëmijët, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies dhe zhvillimin e fëmijëve.
- **Objektivi 2.2** Të sigurohet mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe nxënësit në institucionet arsimore përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, forcimit të strukturave pjesëmarrëse dhe këshilluese, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, si dhe mbështetjes së fëmijëve nga familjet në nevojë dhe atyre me rezultate të shkëlqyera, duke garantuar akses të barabartë, përfshirje aktive dhe zhvillim të plotë në procesin arsimor.

Qëllimi (Q3) Të zhvillohen dhe të institucionalizohen aktivitete të rregullta kulturore, sportive, mjedisore dhe ndërgjegjësuere në të gjitha institucionet arsimore, me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe mbështetjen e stafit pedagogjik, prindërve dhe komunitetit, me qëllim nxitjen e zhvillimit të përgjithshëm, forcimin e bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet dhe promovimin e vlerave të diversitetit, solidaritetit dhe përfshirjes sociale.

- **Objektivi 3.1** Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Tepelenë, në bashkëpunim me institucione dhe organizata partnere, organizon çdo vit të paktën 10 aktivitete kulturore, sportive, edukative dhe sensibilizuese në të gjitha njësitë administrative, me pjesëmarrjen e $\geq 80\%$ të fëmijëve/nxënësve (përfshi grupet vulnerabël) dhe përfshirjen e partnerëve institucionalë e komunitarë, për të nxitur zhvillimin gjithëpërfshirës, ruajtur trashëgiminë kulturore dhe forcuar lidhjen shkollë–komunitet.

8. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor

Plani financiar i parashikuar për periudhën 2025–2028 për arsimin bazë, duke përfshirë arsimin parashkollor, reflekton angazhimin e Bashkisë për të garantuar funksionimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit arsimor në territorin e saj.

Në vitin 2025, buxheti total i planifikuar arrin në 66,673 mijë lekë, ku pjesën më të madhe e zënë pagat dhe shpërblimet për personelin (47,774 mijë lekë), ndjekur nga kontributet për sigurime shoqërore (6,962 mijë lekë), mallrat dhe shërbimet e tjera (6,437 mijë lekë), si dhe investimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara (1,000 mijë lekë) dhe të trupëzuara (4,500 mijë lekë).

Në vitin 2026, buxheti planifikohet të rritet lehtë në 67,812 mijë lekë, kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve operative (7,722 mijë lekë) dhe aktiveve të patrupëzuara (1,139 mijë lekë). Në vitin 2027, planifikimi është 66,673 mijë lekë, ndërsa në vitin 2028 mbetet në të njëjtin nivel prej 66,673 mijë lekësh.

Këto shifra tregojnë një fokus të fortë në mbulimin e shpenzimeve të personelit dhe sigurimin e funksionalitetit të institucioneve arsimore, krahas investimeve të qëndrueshme për përmirësimin e kushteve mësimore. Plani financon jo vetëm nevojat operacionale, por edhe zhvillimin afatmesëm, duke krijuar bazën për një shërbim arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Aktivitete	Viti 2025 në lekë	Viti 2026 në lekë	Viti 2027 në lekë	Viti 2028 në lekë
Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	47,774	47,774	47,774	47,774
Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	6,962	6,962	6,962	6,962
Shpenzime operative: Mallra dhe sherbime te tjera	6,437	7,722	5,405	6,437
Shpenzime kapitale te patrupezuara	1,000	1,139	0	0
Shpenzime kapitale të trupëzuara	4,500	4,215	6,532	5,500
Totali	66,673	67,812	66,673	66,673

Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Plani financiar i periudhës 2025–2028 për arsimin e mesëm të përgjithshëm siguron vazhdimësinë e shërbimit arsimor dhe përmirësimin e cilësisë së tij.

Në vitin 2025, buxheti total arrin në 12,509 mijë lekë, ku përfshihen pagat për personelin (7,152 mijë lekë), kontributet për sigurime shoqërore (1,103 mijë lekë) dhe shpenzimet operative (4,254 mijë

lekë). Në vitin 2026, 2027 dhe 2028, buxheti planifikohet të mbetet në të njëjtin nivel prej 12,509 mijë lekësh në vit, duke garantuar stabilitet në financimin e këtij niveli arsimor.

Ky plan fokusohet në mbulimin e plotë të shpenzimeve të personelit dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme për procesin mësimor, duke ruajtur një nivel të qëndrueshëm operativ dhe financiar gjatë gjithë periudhës.

Llogaria	Viti 2025 në lekë	Viti 2026 në lekë	Viti 2027 në lekë	Viti 2028 në lekë
Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	7,152	7,152	7,152	7,152
Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,103	1,103	1,103	1,103
Shpenzime operative: Mallra dhe sherbime te tjera	4,254	4,254	4,254	4,254
Totali	12,509	12,509	12,509	12,509

9. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteve)

Qëllimi 1 (Q1) – Të garantohet funksionimi i qëndrueshëm, cilësor dhe gjithëpërfshirës i institucioneve të arsimit parauniversitar (parashkollor, bazë dhe i mesëm i përgjithshëm) në territorin e bashkisë, duke siguruar kushte optimale për mësimdhënie, mirëqenie dhe zhvillim të fëmijëve dhe nxënësve.

Objektivi specifik O1.1 Të sigurohet mbulimi i plotë me staf arsimor dhe staf të shërbimeve mbështetëse, si dhe ofrimi i infrastrukturës, kushteve higjieno-sanitare, sistemeve të ngrohjes dhe furnizimeve të nevojshme për të gjitha institucionet arsimore në kuadër të garantimit të cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimit: 15 Kopshte; 20 Shkolla; 1 Qendër kulturore; 1 Konvikt

Aktivite	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Sigurimi i stafit të nevojshëm arsimor dhe të punonjësve të shërbimeve mbështetëse për arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm <i>Ky aktivitet ka për qëllim të garantojë plotësimin e nevojave për personel mësimor dhe ndihmës në të gjitha institucionet arsimore, duke përfshirë:</i> • 15 Kopshte • 19 Shkolla • 1 Qendër kulturore • 1 Konvikt • 31 Staf edukator • 29 Staf mbështetës (gjithsej)	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Këshilli Bashkiak	Transferte specifike + Buxhet vendor	<i>Numri i kopshteve të mbështetura me staf edukativ dhe mbështetës;</i> <i>Numri i personelit edukativ në arsimin parashkollor;</i> <i>Numri i stafit për shërbimet mbështetëse në institucionet arsimore parashkollore (roje, pastrues, ndihmës teknikë, etj.);</i> <i>Raporti i mësuesve ndihmës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte;</i> <i>Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte</i> <i>Numri i fëmijëve egjiptianë të regjistruar në kopshte;</i> <i>Ndryshimi vit pas viti në % i numrit të fëmijëve egjiptian të regjistruar në kopshte;</i> <i>Numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm;</i> <i>Numri i fëmijëve rom dhe egjiptianë të regjistruar në shkolla;</i>

					<i>Ndryshimi vit pas viti në % i numrit të fëmijëve egjyptian të regjistruar; (që frekuentojne) në shkolla;</i> <i>Raporti edukator për fëmijë në kopsht;</i> <i>Numri mesatar i fëmijëve për grup;</i> <i>Numri mesatar i fëmijëve për grup në parashkollor (klasa pergatitore);</i> <i>Numri i shkollave të mbështetura me staf mbështetës;</i> <i>Numri i stafit mbështetës në institucionet arsimore shkollore (roje, pastrues; ndihmës teknikë, etj.);</i> <i>Numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin bazë;</i> <i>Numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin e mesëm;</i> <i>Shpenzime për shërbime mbështetëse për nxënës (në mijë lekë);</i>
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore <i>Për të siguruar kushte të përshtatshme mësimi dhe zhvillimi për fëmijët dhe nxënësit, do të realizohen ndërhyrje për riparime, rikonstruksione të pjesshme dhe investime të tjera të vogla infrastrukturore. Këto ndërhyrje do të fokusohen në përmirësimin e godinave ekzistuese, ambienteve të brendshme, sistemeve të ndriçimit dhe mobilimit, duke përfshirë</i> • 15 Kopshte	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet;	Shkollat, kopshtet	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar	Numri godinave të arsimit (parashkollor, 9- vjeçar, i mesëm) ku janë bërë ndërhyrje të mirëmbajtjes;

• 20 Shkolla • 1 Qendër kulturore • 1 Konvikt					
Sigurimi i furnizimit dhe shërbimit me ujë të pijshëm dhe ener;gji elektrike për të gjitha institucionet arsimore: • 15 Kopshte • 20 Shkolla • 1 Qendër kulturore • 1 Konvikt	2026–2028	Njësia përgjegjese për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Operatorë të energjisë,	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i institucioneve arsimore parashkollore, te arsimit bazë dhe atij të mesëm me furnizim të rregullt me ujë të pijshëm; Nr. i institucioneve arsimore parashkollore, te arsimit bazë dhe atij të mesëm me furnizim të rregullt me energji elektrike;
Garantimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve higjieno-sanitare <i>Do të sigurohen materiale dhe pajisje për mirëmbajtjen e higjienës, si dhe shërbime pastrimi të rregullta për të gjitha institucionet arsimore. Aktiviteti synon të mbajë ambientet e kopshteve dhe shkollave të pastra dhe të sigurta për shëndetin e fëmijëve dhe stafit. Ky aktivitet përfshin:</i> • 15 Kopshte • 20 Shkolla • 1 Qendër kulturore • 1 Konvikt	2026–2028	Njësia përgjegjese për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Shkollat, operatorë të higjienës, kopshtet	Buxhet vendor, transfertë e pakushtëzuar	Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare Nr. i kopshteve me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare

Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore <i>Kjo përfshin mirëmbajtjen e infrastrukturës së ngrohjes, dhe sigurimin e karburantit apo burimeve të tjera energjie për funksionimin e tyre. Aktiviteti mbulon , duke përfshirë:</i> • 15 Kopshte • 20 Shkolla • 1 Qendër kulturore • 1 Konvikt	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Operatorë të energjisë,	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i institucioneve arsimore parashkollre, te arsimit bazë dhe atij të mesëm me sistem të sigurtë dhe funksional ngrohjeje
Furnizimi me kancelari për institucionet arsimore <i>Për të mundësuar zhvillimin normal të procesit mësimor dhe administrativ, do të sigurohen furnizime të vazhdueshme me materialet e nevojshme kancelarike, duke përfshirë:</i> • 15 Kopshte • 19 Shkolla • 1 Qendër kulturore • 1 Konvikt	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i institucioneve të furnizuara me kancelari
Furnizimi, kontrolli dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit <i>Do të realizohet furnizimi dhe instalimi i fikseve të zjarrit në të gjitha institucionet arsimore, si dhe</i>	2026–2028	Zyra e Emergjencave	Zjarrfikësja, NjA	Buxhet vendor	Nr. i fikseve të vendosura dhe funksionale; Nr. i kopshteve dhe shkollave me fikse zjarri funksionale;

<i>kontrolli periodik i funksionalitetit të tyre dhe kolaudimi sipas standardeve të sigurisë. Ky aktivitet përfshin:</i> • 15 Kopshte • 19 Shkolla • 1 Qendër kulturore • 1 Konvikt					
Furnizimi me dokumentacion administrativ për institucionet arsimore • 15 Kopshte • 19 Shkolla • 1 Qendër kulturore • 1 Konvikt	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i shkollave të pajisura me dokumentacion administrativ
Ofrimi i shërbimit të vakteve ushqimore në institucionet e arsimit parashkollor <i>Sigurimi i ushqimit të shëndetshëm dhe të balancuar për fëmijët e moshës 3–6 vjeç në institucionet e arsimit parashkollor, duke filluar me institucionet që kanë kuzhinë funksionale dhe kapacitet për përgatitjen dhe shpërndarjen e vakteve. Aktualisht, shërbimi ofrohet në Kopshtin “Murat Koçiu” në qytetin e Tepelenës për rreth 50 fëmijë, përfshirë edhe fëmijët nga</i>	2026–2028	Zyra Shëndetit Publik & Arsimit	Operatorët e licencuar, Ministria e Arsimit, Sportit (MAS)	Buxhet vendor	Nr. i kopshteve me ushqim; Nr. i fëmijë që përfitojn nga shërbimi i vakteve ushqimore në kopsht;

<i>familjet në ndihmë ekonomike ose me një prind, të cilët e përfitojnë shërbimin falas.</i>					
Kryerja e shërbimit të dezinfektimit në institucionet arsimore Për të parandaluar përhapjen e infeksioneve dhe për të garantuar një ambient të shëndetshëm, do të kryhen dezinfektime periodike në të gjitha institucionet e arsimit parashkollor, bazë dhe të mesëm. Ky aktivitet përfshin: • 15 Kopshte • 19 Shkolla • 1 Qendër kulturore • 1 Konvikt	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), operatorë të kontraktuar	Buxhet vendor + fond emergjence	Nr. i kopshteve dhe shkollave për të cilat kryhet shërbimi i dezinfektimit;

Objektivi specifik O1.2 Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Tepelenë të përfundojë rikonstrukcionin e të paktën një shkolle 9-vjeçare dhe një institucioni parashkollor, si dhe të krijojë e funksionalizojë një regjistër digjital të qendëruar për institucionet arsimore, me përditësim vjetor të të dhënave, për të përditësuar dhe monitoruar progresin e treguesve të performancës së shërbimit.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Rikonstruktion i shkollës 7 Marsi Tepelenë	2026 - 2028	Njësia përgjegjësë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve arsimore të rikonstruktura(Rikonstrukcioni dhe përmirësimi i standardeve të të paktën 1 shkolle); Përmirësim i standarteve të infrastrukturës në shkolla;
Rikonstruktion i kopshtit “Murat Koçiu” Tepelenë (Riparim i nyjeve sanitare)	2026 - 2028	Njësia përgjegjësë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve arsimore parashkollore të rikonstruktura (Rikonstrukcioni dhe përmirësimi i standardeve të të paktën 1 institucioni arsimor parashkollor kryesor; Përmirësim i standarteve të infrastrukturës në kopshte;
Rikonstruktion i kopshtit “Murat Koçiu” Tepelenë (Riparim i lageshtires kati i pare)	2026 - 2028	Njësia përgjegjësë për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve arsimore parashkollore të rikonstruktura; Përmirësim i standarteve të infrastrukturës në kopshte;
Rikonstruktion I dritareve te kopshtit “Murat Koçiu” Tepelenë	2026 - 2028	Njësia përgjegjësë për arsimin,	Qeveria shqiptare	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve arsimore parashkollore të rikonstruktura;

		Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Bashkia, donatorë		Përmirësim i standarteve të infrastrukturës në kopshte;
Zhvillimi dhe ndërtimi i një regjistri të dhënash digjitale për institucionet arsimore <i>Krijimi i një regjistri të centralizuar elektronik që mbledh, ruan të dhënat për kopshtet dhe shkollat, duke mundësuar menaxhim më efikas të informacionit mbi infrastrukturën, stafin, numrin e fëmijëve/nxënësve, nevojat për investime dhe shërbimet mbështetëse.</i>	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Kopshtet/s hkollat; Ekspertë të jashtëm për mbështetje	Buxheti i Bashkisë (orë pune punonjës të angazhuar në punë),	Krijimi dhe funksionalizimi i regjistrit digjital të të dhënave për arsimin parauniversitar dhe atë të mesëm, me përditësim të rregullt vjetor.

Qëllimi 2 (Q2) – Të garantohet ofrimi i një edukimi parashkollor cilësor dhe gjithëpërfshirës, i bazuar në standarde bashkëkohore të mësimdhënies dhe mbështetjes zhvillimore, përmes fuqizimit të kapaciteteve të stafit edukativ e mbështetës, përdorimit të metodologjive inovative dhe nxitjes së shkëmbimit të praktikave të mira, duke siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t’u rritur dhe për t’u zhvilluar.

Objektivi specifik O2.1 Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Tepelenë, në bashkëpunim me MASR dhe partnerët lokalë e ndërkombëtarë, të zhvillojë dhe zbatojë një program të vazhdueshëm trajnimi për të gjithë edukatorët dhe stafin mbështetës të institucioneve parashkollore në territorin e saj, duke realizuar të paktën 4 module trajnimi praktike çdo vit, me synim që 100% e edukatorëve të aplikojnë metodologji bashkëkohore dhe mjete didaktike inovative në punën me fëmijët, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies dhe zhvillimin e fëmijëve.

Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Zhvillimi i një programi të vazhdueshëm trajnimi për edukatorët dhe stafin mbështetës të institucioneve parashkollore, me fokus në përdorimin e metodologjive bashkëkohore dhe mjeteve didaktike inovative. Aktiviteti do të përfshijë: • Organizimin e sesioneve praktike dhe workshopeve mbi mësimdhënien e orientuar drejt fëmijës; • Përdorimin e materialeve moderne edukative për të nxitur kreativitetin, zhvillimin social dhe emocional të fëmijëve; • Forcimin e aftësive për vlerësimin e ecurisë individuale të fëmijës dhe përshtatjen e programeve sipas nevojave të tij; • Shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira ndërmjet institucioneve brenda dhe jashtë bashkisë.	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	MASR, institucionet arsimore, OSHC, ASKAP	Buxhet vendor, projekte me financim të huaj	Nr. i edukatorëve të trajnuara; Nr. i kopshteve/fëmijëve që kanë përfituar nga praktika të përmirësuara të mësimdhënies;

Objektivi specifik O2.2 Të sigurohet mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe nxënësit në institucionet arsimore përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, forcimit të strukturave pjesëmarrëse dhe këshilluese, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, si dhe mbështetjes së fëmijëve nga familjet në nevojë dhe atyre me rezultate të shkëlqyera, duke garantuar akses të barabartë, përfshirje aktive dhe zhvillim të plotë në procesin arsimor.

Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte <i>Mbështetja me mësues ndihmës në institucionet parashkollore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata që kanë nevojë të veçanta në procesin e edukimit.</i>	2025–2028	Njësia për Arsimin	MASR, Drejtoritë e arsimit, OSHC	Buxhet vendor, transfertë e kushtëzuar sektoriale	Nr. mësues ndihmës të angazhuar; Raporti i mësuesve ndihmës me numrine fëmijëve me aftësi të kufizuara (një mësues për një fëmijë)
Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese dhe këshilluese në institucionet arsimore <i>Krijimi dhe fuqizimi i strukturave të përfaqësimit dhe këshillimit në kopshte dhe shkolla, duke përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit. Aktiviteti synon rritjen e transparencës, përfshirjes dhe bashkëpunimit ndërmjet stafit arsimor, prindërve dhe komunitetit.</i>	2025–2026	Njësia për Arsimin, Drejtuesit e IA	Prindër, komuniteti lokal	Buxhet vendor	Nr. institucioneve me struktura funksionale • 15 Kopshte • 20 Shkolla
Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte <i>Sigurimi i një shërbimi psiko-social të rregullt dhe të specializuar për fëmijët e moshës parashkollore, në partneritet me zyrën e shërbimit social të bashkisë dhe ZVA -psikologët që punojnë në shkolla.</i>	2025–2028	Njësia për Arsimin, Zyra e Shërbimit Social	OSHC, specialistë të licencuar	Buxhet vendor, projekte me financim të huaj	Nr. kopshte me shërbim psiko-social aktiv (15 Kopshte) Nr. i personelit të dedikuar për shërbimin psikosocial në kopshte

<i>Ky shërbim do të ndihmojë në identifikimin dhe adresimin e vështirësive emocionale, sociale apo zhvillimore të fëmijëve.</i>					
Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë <i>Zbatimi i programeve ndihmëse për nxënësit që vijnë nga familje me vështirësi ekonomike , duke përfshirë ofrimin e pajisjeve shkollore, transportit, ushqimit apo shërbimeve të tjera që lehtësojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë në arsim.</i>	2025–2028	Njësia për Arsimin	Drejtuesit e shkollave dhe kopshteve, OSHC	Buxhet vendor, financim donatorësh	Numri i nxënësve/fëmijëve përfitues Numri i nxënësve/fëmijëve egjiptianë Numri i nxënësve/fëmijëve në ndihmë ekonomike Numri i nxënësve/fëmijëve me një prind Numri i nxënësve/fëmijëve që banojnë larg shkollës që frekuentojnë (p.sh., nga Njësia Administrative Lopës)
Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera <i>Vlerësimi dhe motivimi i nxënësve me arritje të larta akademike përmes bursave, shpërblimeve apo mundësive për pjesëmarrje në konkurse kombëtare, me synim nxitjen e ekselencës dhe talentit të ri.</i>	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ	Buxhet vendor + donacione + projekte sociale	Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel të mbështetur

Qëllimi 3 (Q3)– Të zhvillohen dhe të institucionalizohen aktivitete të rregullta kulturore, sportive, mjedisore dhe ndërgjegjësuere në të gjitha institucionet arsimore, me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe mbështetjen e stafit pedagogjik, prindërve dhe komunitetit, me qëllim nxitjen e zhvillimit të përgjithshëm, forcimin e bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet dhe promovimin e vlerave të diversitetit, solidaritetit dhe përfshirjes sociale.

Objektivi specifik O3.1 Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Tepelenë, në bashkëpunim me institucione dhe organizata partnere, organizon çdo vit të paktën 10 aktivitete kulturore, sportive, edukative dhe sensibilizuese në të gjitha njësitë administrative, me pjesëmarrjen e $\geq 80\%$ të fëmijëve/nxënësve (përfshi grupet vulnerabël) dhe përfshirjen e partnerëve institucionalë e komunitarë, për të nxitur zhvillimin gjithëpërfshirës, ruajtur trashëgiminë kulturore dhe forcuar lidhjen shkollë–komunitet.

Aktivitete	Periodha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të fëmijëve “Nimete Progonati”: <i>(Bashkia mbështet aktivitetet jashtëshkollore të organizuara nga institucionet arsimore të parashikuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë për vitin shkollor, i cili miratohet për çdo vit.)¹</i>	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të Shoqërisë Civile, Qendra Kulturore të fëmijëve “Nimet e Progonati”	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse;
Festa e Ditës së Verës – 14 Mars Organizuar nga Muzeu i Tepelenës, me përfshirjen e	Çdo vit	Muzeu i Tepelenës Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje	Numri total i shkollave të përfshira në aktivitet.

¹ Mbështetja me fonde të sigurohet edhe në zbatim të Udhëzimit të përbashkët nr. 11, datë 27.5.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë. Ky dokument përcakton rregullat dhe procedurat për menaxhimin e buxheteve të shkollave. Ai siguron që menaxhimi i fondeve buxhetore të jetë transparent dhe në përputhje me ligjet në fuqi, duke ndihmuar shkollat të menaxhojnë më mirë shpenzimet e tyre. Roli i Bashkisë është përcaktuar si aktor që vë fonde në dispozicion, si dhe lidhet edhe me proceset inventarizuese apo asistencë për zhvillim procedurash.

<i>shkollave të njësive administrative: Qyteti, Qendër Tepelenë, Kurvelesh, Lopës.</i> <i>Aktivitetet zhvillohen çdo vit, duke sjellë elemente të traditës, kulturës dhe argëtimit për fëmijët.</i>				Organizata të Shoqërisë Civile	Numri i nxënësve dhe mësuesve pjesëmarrës (vajza/djem). Numri i njësive administrative të përfshira. Llojet e aktiviteteve të realizuara (traditë, kulturë, argëtim). Numri i partnerëve të përfshirë (institucione, OJQ, komuniteti)..
Java e Ali Pashës (Maj – hapja e sezonit turistik) <i>Një javë e pasur me aktivitete historike, kulturore, artistike dhe sportive, e organizuar nga Bashkia Tepelenë dhe institucionet vendore në bashkëpunim me partnerë kulturorë e turistikë.</i>	Çdo vit				Numri i aktiviteteve të zhvilluara gjatë javës (historike, kulturore, sportive, artistike). Numri i pjesëmarrësve gjithsej, përfshirë vizitorët nga jashtë bashkisë. Numri i institucioneve dhe organizatave partnere. Numri i grupeve kulturore, sportive dhe artistëve të përfshirë. Numri i ekspozitave dhe prezantimeve të trashëgimisë kulturore. Numri i publikimeve/promovimeve mediatike për eventin.
Aktivitetet e sugjeruara për kopshtet dhe shkollat, në zbatim të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë					
1. 23–30 Shtator – Java Evropiane e Sportit  Loja sportive në oborrin e kopshtit (loja popullore)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër fëmijësh/nxënësish (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;

- Ushtrime në natyrë (gimnastikë) - Loja të ndryshme lëvizore, Gara me biçikleta, etj.)					
2. Prill–Maj – Java Olimpikë - Loja të ndryshme sportive (stafeta me flamuj, topa) - Gara vrapimi, midis kopshteve në grupe - Gara me biçikleta	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
3. 20 Nëntor – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve - Bisedë, postera, aktivitete në natyrë (Kam të drejtë të luaj) - Ekspozitë me materiale të përgatitura nga fëmijët “Të drejtat e mia” "Unë mbroj të drejtat e mia" (bisedë)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
4. Dita e Luftës Kundër Bullizmit (21 nëntor) Bisedë me fëmijët					
1. Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe - Postera me gjuhën shqipe & ilustrime - Koncert për gjuhën shqipe (Gjuha jonë sa e mirë)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
2. Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (3 dhjetor) Biseda sensibilizuese për fëmijët me nevoja të veçanta	0	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;

- Loja me role (si t'i ndihmojmë shokët me nevoja të veçanta) - Ekspozitë me punime të përgatitura nga fëmijët me AK					
3. Dita Botërore e Gjuhës Amtare Vizitë në bibliotekë	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
4. Dita Botërore e Ujit (UNESCO 22 mars) - Rëndësia dhe vlerat e ujit (bisedë, prezantime) “Uji është jetë” (Postera, eksperiment me ujëra) - Bisedë për vlerat e ujit	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
5. Dita Ndërkombëtare e Romëve Bisedë për fëmijët romë	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
6. Zakonet dhe traditat e romëve	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
7. Dita Botërore e Librit (23 prill) - Ne dimë të bëjmë libra (aktivitet krijues) - Vizitë në bibliotekë - Dhuro një libër, hap një dritare (fushatë sensibilizuese)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;

8. Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor) ✚ Ekspozitë me mjete të riciklueshme ✚ Mbrojmë tokën, planetin tonë (projekt) ✚ Mbjellim lule në oborrin e kopshtit ose në vazo (aktivitet praktik) ✚ Mbajmë pastër mjedisin në mësime (aktivitet praktik, bisedë) ✚ Ekskursion në lulishten e qytetit	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
9. Pedalo për Turizëm dhe Kulturë në bashkëpunim me QKF ✚ Pedalim me biçikleta në pedonalen e qytetit ✚ Ekspozitë me punime, vizatime dhe postera	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
10. Yjet e Vallzimit në bashkëpunim me QKF ✚ Konkurs midis kopshteve të qytetit	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
11. Pedalo Kuq e në bashkëpunim me QKF ✚ Marshim me biçikleta të fëmijëve të kopshtit me rastin e Festave Kombëtare	0	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;

10. Plani i investimeve kapitale

Plani i investimeve kapitale për arsimin parauniversitar dhe të mesëm të përgjithshëm në Bashkinë Tepelenë për periudhën 2026–2028 synon të sigurojë kushte të qëndrueshme, moderne dhe të sigurta për zhvillimin e procesit mësimor, në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit të arsimit në territorin e bashkisë.

Investimet janë të orientuara drejt përmirësimit të infrastrukturës, përmirësimit të mjediseve të mësimi dhe pajisjes së tyre, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit dhe sigurimin e aksesit të barabartë për të gjithë nxënësit dhe fëmijët e moshës parashkollore.

Prioritetet kryesore të planit përfshijnë:

- Rikonstruksionin e plotë të infrastrukturës në shkollat dhe kopshtet kryesore, duke filluar me ndërhyrje kapitale në Shkollën 9-vjeçare “7 Marsi” dhe Kopshtin “Murat Koçiu” në qytetin e Tepelenës.
- Përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe zgjidhjen e problematikave të lagështirës në mjediset e arsimit parashkollor.
- Rritjen e sigurisë dhe efikasitetit energjetik përmes zëvendësimit të dritareve dhe elementeve të tjera strukturore të amortizuara.

Planifikimi i investimeve për arsimin bazë dhe atë të mesëm

Nr.	Investimi i planifikuar	2026 në lekë	2027 në lekë	2028 në lekë	Totali në lekë
1.	Rikonstruksion i Shkollës “7 Marsi” Tepelenë	2,700,000	2,700,000	2,700,000	8,100,000
	<i>Shënim:</i> Projekti për rikonstruksionin total të Shkollës “7 Marsi” është 16,200,000 lekë. Fondi i Bashkisë përbën 20% të totalit të projektit.				
	Totali	2,700,000	2,700,000	2,700,000	8,100,000

Planifikimi i investimeve për arsimin parashkollor

Nr.	Investimi i planifikuar	2026 në lekë	2027 në lekë	2028 në lekë	Totali në lekë
1	Rikonstruksion i Kopshtit “Murat Koçiu” Tepelenë (Riparim i nyjeve sanitare)	800,000	300,000	250,000	1,350,000
2	Rikonstruksion i Kopshtit “Murat Koçiu” Tepelenë (Riparim i lagështirës, kati i parë)	757,000	237,000	200,000	1,194,000
3	Rikonstruksion i dritareve të Kopshtit “Murat Koçiu” Tepelenë	768,000	280,000	250,000	1,298,000
	Totali	2,325,000	817,000	700,000	3,842,000

Totali i investimeve për arsimin bazë, të mesëm dhe parashkollor për periudhën 2026–2028 arrin në 11,942,000 lekë, duke reflektuar angazhimin e Bashkisë Tepelenë për të investuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve mësimore si bazë për një proces edukativ cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Treguesit e performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetsesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Eficienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore. Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënës;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performances dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
2. **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

- **0** – Aktiviteti nuk ka nisur.
- **1–9** – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.
- **10** – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete x 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbledhen në nivel objektiv. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

Përqindja e realizimit të objektivit = (Pike të realizuara / Pike maksimale) × 100

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet 0.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

Përqindja e pjesëmarrjes = (Numri real i pjesëmarrësve / Numri target) × 100

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

11. Rishikimi dhe përshtatja e planit

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Tepelenë. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Procesi i rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

- **Rishikimi vjetor** – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;
- **Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027)** – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;
- **Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

- **Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;
- **Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;
- **Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;
- **Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Tepelenë.

12. Raportimi dhe transparenca

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

13. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar

Kuadri Kushtetues dhe ligjor i përgjithshëm

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, neni 57, pika 1
- **Ligji Nr. 69/2012**, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me **Ligjin Nr. 48/2018**
- **Ligji Nr. 139/2015**, “Për Vetëqeverisjen 0Vendore”
- **Ligji Nr. 9936/2008**, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 68/2017**, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- **Ligji Nr. 9632/2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar 0

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- **Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020**, “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- **Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023**, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- **Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018**, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- **Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024**, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- **Ligji Nr. 121/2016**, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 18/2017**, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025**
- **Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014**, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019**, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-Social dhe ërfshirja Sociale

- **Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020**, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- **Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor**, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore

PLANI SOCIAL VENDOR

BASHKIA TEPELENË

2025-2029



Ky Plan Social Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Ky Plan Social Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike “Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (EU4SI), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e Tepelenë, zbatuar nga GOPA Eorldeide Consultants.

Shkurtime

AK	Aftësi të Kufizuara
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizat Joqeveritare
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
NE	Ndihmë Ekonomike
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës
NJVRN	Njësia Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave
PSV	Plani Social Vendor
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UM	Urdhër Mbrojtjeje

Contents

I.Hyrje	4
II. Metodologjia për Hartimin e Planit.....	4
III. DIAGNOZA	7
1. Diagnoza për kategoritë në nevojë.....	7
2. Diagnoza e shërbimeve shoqërore	23
3. Diagnoza për Burimet Njerëzore në Shërbimet Sociale në Bashkinë Tepelenë	26
4. Përmbyllje e diagnozës së Planit Social Vendor në Bashkinë Tepelenë	29
5. Analiza SËOT	29
IV. Vizioni, Misioni , Prioritetet Strategjike dhe Objektivat.....	29
V. Plani i Veprimit.....	34
VI. Finalizimi i Planit Social Vendor	49
VII. Monitorimi dhe Vlerësimi	51
VIII Shtojca.....	53
Shtojca 1 Kuadri legjislativ	53
Shtojca 2 Persona burimorë dhe profesionistë lokale për mbrojtjen sociale në nivel bashkie dhe njësisht administrative.....	54
Shtojca 3 Fletët e Veprimit.....	54
IX ANEKSE.....	61

I.Hyrje

Plani Social Vendor i Bashkisë Tepelenë 2025–2029 është dokumenti udhërrëfyes që i kthen prioritetet sociale në veprime të matshme, në bashkërendim me buxhetimin afatmesëm vendor dhe me partnerët lokalë. Qëllimi është i qartë: të forcojmë shërbimet afër qytetarëve, të garantojmë mbrojtje dhe përfshirje për grupet në nevojë dhe të rrisim llogaridhënien për çdo rezultat.

Tepelena ishte ndër bashkitë e përfshira në pilotimin e procesit të hartimit të planeve sociale vendore, me mbështetjen e GOPA. Pilotimi u konceptua si një qasje gjithëpërfshirëse: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, njësitë administrative, ofruesit publikë dhe jo-publikë të shërbimeve, shkollat, qendrat shëndetësore, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të komunitetit morën pjesë me role të përcaktuara qartë në identifikim, diskutim dhe dakordësim të masave.

Në aspektin administrativ, Bashkia Tepelenë përbëhet nga 4 Njësi Administrative (Tepelenë, Qendër Tepelenë, Kurvelesh dhe Lopës), me 1 qytet dhe 24 fshatra, në një territor prej 431.24 km²; popullsia sipas Censit 2023 është 6,761 banorë.

Zgjedhja e horizontit 2025–2029 siguron përputhje me ciklin shumëvjeçar të planifikim–buxhetimit (PBA), lejon vijimësinë e ndërhyrjeve, maturimin e ndikimit dhe integrimin e burimeve të ndryshme financiare. Ky afat krijon stabilitet për planifikim, zbatim dhe monitorim të rezultateve, duke mundësuar rishikime vjetore aty ku kërkohet.

Roli i Bashkisë në proces ka qenë drejtues dhe bashkërendues: Komiteti Drejtues përcaktoi drejtimet, Komiteti Teknik ndërsektorial përktheu gjetjet në objektiva dhe masa, ndërsa njësitë në terren kanë sjellë të dhëna dhe evidenca për vendimmarrje. Ky organizim garanton që plani të jetë i zbatueshëm dhe i vlerësueshëm në praktikë.

Plani mbështetet në kornizën ligjore dhe strategjike në fuqi, përfshirë: Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, legjislacionin për barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe aktet për mbrojtjen nga dhuna në familje. Përputhshmëria me strategjitë kombëtare të mbrojtjes sociale dhe të drejtat e fëmijës siguron standarde cilësie, mbrojtje të të dhënave dhe koordinim ndërinstitucional.

Dokumenti është i ndërtuar në mënyrë që lexuesi të orientohet lehtësisht: (i) diagnoza sociale dhe gjetjet kryesore; (ii) vizioni, objektivat dhe prioritetet strategjike; (iii) fletët e veprimit me aktivitetet, afatet, përgjegjësit, indikatorët dhe burimet; (iv) përafrimi


financiar me PBA-në; (v) mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit për ndjekje të rregullt të progresit. Kjo logjikë e bën planin një instrument praktik të qeverisjes vendore.

Synimi deri në vitin 2029 është i matshëm dhe realist: një rrjet shërbimesh më afër njerëzve, me standarde të qarta cilësie, me kapacitete institucionale të forcuara dhe me bashkërendim funksional mes bashkisë dhe partnerëve. Si pjesëmarrëse në pilotim, Bashkia Tepelenë konsolidon praktikatat e planifikimit dhe transparencës, duke i kthyer sfidat e sotme në përmirësime të prekshme për komunitetin.

II. Metodologjia për Hartimin e Planit

Metodologjia për hartimin e Planit Social Vendor të Bashkisë Tepelenë është ndërtuar mbi parimet e pjesëmarrjes, bazimit në të dhëna dhe orientimit drejt rezultateve, në përputhje me 'Guidën Kombëtare për Hartimin e Planit Social Vendor 2025'. Procesi është strukturuar në tre faza kryesore që kanë mundësuar përfshirjen e gjerë të aktorëve lokalë dhe përdorimin e instrumenteve të standardizuara.

Fig 1 Tri fazat kryesore të metodologjisë për hartimin e Planit Social Vendor



Faza I:

- ❖ U krijua Komiteti Drejtues dhe Grupi Teknik me përfaqësues nga bashkia dhe institucionet lokale si AKPA, ZVA, Operatori i Kujdesit Shëndetësor, Komisariati i Policisë etj.
- ❖ U hartua harta e aktorëve dhe u ndërtua një bazë e dhënash për shërbimet ekzistuese.
- ❖ U realizuan 5 intervista me drejtues institucionesh për të identifikuar boshllëqet dhe mundësitë për përmirësim.
- ❖ U zhvilluan 3 fokus grupe në qytet dhe në njësi administrative, me përfitues dhe jo-përfitues të shërbimeve.
- ❖ U grumbulluan të dhëna statistikore dhe dokumentare nga burime vendore dhe qendrore.

Faza II:

- ❖ Të dhënat u analizuan përmes mjeteve vizuale dhe analizës SËOT për çdo kategori vulnerabël.

- ❖ U organizua një seminar konsultativ me rreth 46 pjesëmarrës për të diskutuar prioritetet sociale.
- ❖ U hartua dhe u miratua raporti diagnostikues nga grupi teknik dhe Komiteti Drejtues.
- ❖ Të dhënat krahasuese për periudhat 2023 dhe 2025 u përdorën për të mbështetur analizën.

Faza III:

- ❖ U ndërtuan fletëveprimi për çdo objektiv specifik, duke përfshirë aktivitete, tregues, burime dhe partnerë.
- ❖ U zhvilluan takime me Komitetin Drejtues për planifikimin buxhetor dhe afatet trevjeçare.
- ❖ U organizua takim me donatorë dhe OJF për të diskutuar mundësitë e bashkëfinancimit.
- ❖ Plani u miratua nga Këshilli Bashkiak dhe u prezantua për komunitetin për transparencë.

Qasje metodologjike

- Përdorimi i një strukture të testuar në 5 bashki të tjera.
- Instrumente të standardizuara për mbledhjen, analizën dhe dokumentimin e të dhënave.
- Pjesëmarrje e gjerë me rreth 104 individë përmes intervistave, fokus grupeve dhe aktiviteteve konsultative.

Fig 1 Pjesëmarrja në procesin konsultativ për hartimin e Planit Social Vendor




Figura 1 paraqet përfshirjen e aktorëve lokalë në fazat kyçe të procesit të hartimit të planit, duke reflektuar angazhimin e Komitetit Drejtues, Grupit Teknik dhe komunitetit lokal përmes fokus grupeve dhe seminarit konsultativ.

III. DIAGNOZA

Ky dokument përmbledh tre diagnoza kryesore të realizuara në kuadër të Planit Social Vendor të Bashkisë Tepelenë:

1. Diagnozën për kategoritë në nevojë,
2. Diagnozën për shërbimet shoqërore,
3. Diagnozën për burimet njerëzore

1. Diagnoza për kategoritë në nevojë

Sipas Censit 2023, Bashkia Tepelenë numëron 6,761 banorë. Kjo madhësi demografike përkufizon një bashki me përmasa të menaxhueshme, ku ndryshimet shoqërore ndihen shpejt në jetën e përditshme të familjeve. Këto të dhëna merren si bazë për diagnozat e kategorive në nevojë dhe për vendimmarrjen mbi shërbimet që u duhen njerëzve. Regjistri Civil (2024), raporton 5 435 familje dhe 15 465 banorë. Diferenca me Censin nënvizon nevojën për harmonizim statistikor gjatë planifikimit të shërbimeve shoqërore.

Struktura e moshës sipas Censit 2023 tregon një komunitet me bazë të gjerë aktive, por edhe me peshë të dukshme të moshës së tretë: 0–14 vjeç janë 844 banorë (12,5%), 15–64 vjeç 4,194 banorë (62,0%) dhe 65+ vjeç 1,723 banorë (25,5%). Kjo përbërje kërkon politika të balancuara: mbështetje të hershme për fëmijët dhe familjet, orientim drejt punësimit dhe shërbime parandaluese për të rinjtë e moshës së punës, si edhe kujdes të qëndrueshëm social e shëndetësor për të moshuarit. Vëmendja ndaj aksesit, mobilitetit dhe kujdesit afatgjatë bëhet thelbësore në masat që pasojnë.

1.1 Diagnoza për familjet në nevojë

Familjet në nevojë në Bashkinë Tepelenë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të komunitetit, duke pasur nevoja të veçanta sociale dhe ekonomike. Bashkia synon të garantojë mbështetje të qëndrueshme për këto familje përmes zhvillimit të shërbimeve sociale dhe nxitjes së përfshirjes në jetën komunitare.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Kjo kategori përfshin familje me të ardhura të pamjaftueshme ose pa të ardhura, shpesh të përballura me vështirësi të shumanshme ekonomike dhe sociale. Shumë prej këtyre familjeve kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme për të siguruar nevojat bazë të jetesës, si ushqimi, strehimi dhe kujdesi shëndetësor. Sfidat tjera përfshijnë mungesën e mundësive të punësimit, përjashtimin social dhe pamundësinë për të përfituar shërbime cilësore sociale dhe edukative. Kjo gjendje ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e anëtarëve të këtyre familjeve dhe në aftësinë e tyre për të qenë pjesë aktive e komunitetit.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Pamja aktuale tregon se në vitin 2024 janë 144 familje përfituese të ndihmës ekonomike, përfshirë 5 raste me vajza-nëna. Në total në bashki janë të regjistruara 5,435 familje, pra rreth 3% e tyre marrin ndihmë ekonomike. Në vijimësi kohore, numri i përfituesve ka rënë nga 201 në vitin 2022, në 186 në vitin 2023 dhe në 144 në vitin 2024. Kjo tregon një tendencë zbritëse që duhet interpretuar me kujdes, sepse ulja mund të pasqyrojë përmirësim real për disa familje, por po aq mund të lidhet me ndryshime në kritere dhe administrim, lëvizje demografike ose mos-përditësim të rasteve.

Gjeografikisht, rastet janë të përqendruara kryesisht në Njësinë Administrative Qendër me rreth 46%, të pasuara nga Qyteti me rreth 30%, ndërsa Lopës dhe Kurvelesh kanë nga rreth 12% secila. Sipas madhësisë së familjes, përfituesit dominohen nga familje me tre deri pesë anëtarë, me peshë më të lartë të familjeve me katër anëtarë. Shumë pak janë familjet shumë të mëdha, ndërsa familje njëanëtarëshe nuk raportohen si përfituese. Ky profil përforcon nevojën për mbështetje të kombinuar ekonomike dhe psikosociale, të përshtatur me ciklin familjar.

Përveç familjeve përfituese, përfitime mujore marrin edhe kategori të tjera vulnerabël, si tre jetime dhe një fëmijë në kujdestari për periudhën 2022–2024, të cilat kërkojnë koordinim të ngushtë me mekanizmat e mbrojtjes së fëmijës.

Megjithëse këto të dhëna japin një tablo të qartë të volumit dhe të përqendrimeve, mungojnë disa elemente thelbësore për matjen e rezultatit. Nuk dokumentohen arsyet e daljes nga skema, kohëqëndrimi mesatar, profili i kryefamiljarit si mosha, gjinia, niveli arsimor dhe statusi i punës, si dhe shënjimi i shërbimeve komplementare të marra nga e njëjta familje. Pa këto të dhëna është e vështirë të dallohet nëse rënia e numrit të përfituesve vjen nga përmirësimi real i jetesës apo nga faktorë administrativë dhe demografikë.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Aktualisht, shërbimet për familjet në nevojë në Bashkinë Tepelenë ofrohen kryesisht përmes ndihmës ekonomike dhe mbështetjes nga administratorët shoqërorë, të cilët ofrojnë shërbime parashoqërore në të gjithë territorin e bashkisë. Mungojnë shërbime të strukturuar dhe të specializuara për këtë kategori, si këshillimi psiko-social, ndërhyrjet për përfshirjen në tregun e punës, apo mbështetja për edukimin prindëror. Kuadri ligjor që mbështet këtë kategori përfshin Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe dispozitat që rregullojnë skemën e ndihmës ekonomike. Ekziston potencial për zgjerimin e gamës së shërbimeve, duke shfrytëzuar mundësitë për bashkëpunim me organizata joqeveritare dhe partnerë ndërkombëtarë.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Bazuar në analizën e situatës, nevojat prioritare për këtë kategori përfshijnë:

- ✓ Krijimi i shërbimeve të strukturuar sociale për familjet në nevojë.
- ✓ Zhvillimi i programeve të punësimit dhe trajnimit profesional për anëtarët e këtyre familjeve.
- ✓ Sigurimi i mbështetjes psiko-sociale dhe edukimit prindëror.
- ✓ Forcimi i bashkëpunimit me organizata dhe institucione për të zgjeruar mbështetjen.
- ✓ Përmirësimi i sistemit të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për familjet vulnerabël.

Bashkia Tepelenë është e angazhuar për të ofruar mbështetje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për familjet në nevojë, duke synuar rritjen e cilësisë së jetesës dhe krijimin e mundësive të reja për përfshirjen e tyre aktive në komunitet. Përmes një qasjeje të integruar dhe bashkëpunimit ndërinstitutional, synohet ndërtimi i një sistemi shërbimesh që adreson nevojat reale dhe afatgjata të këtyre familjeve.

1.2 Diagnoza për Personat me AK

Personat me aftësi të kufizuara (PAK) në Bashkinë Tepelenë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të komunitetit, me nevoja të ndryshme sociale, arsimore dhe shëndetësore. Bashkia njeh potencialin e këtij grupi për të qenë pjesë aktive e jetës komunitare dhe synon të ndërtojë një mjedis gjithëpërfshirës dhe mbështetës për të gjithë.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Në territorin e Bashkisë Tepelenë jetojnë gjithsej 576 persona me aftësi të kufizuara, që përbëjnë rreth 4% të popullsisë sipas regjistrit civil. Ky grup përfshin persona para dhe tetraplegjikë, të verbër, invalidë dhe persona me aftësi të tjera të kufizuara. Ata përballen me sfida të lidhura me aksesin në shërbime shëndetësore, sociale, arsim dhe punësim, duke kërkuar mbështetje të përshtatur sipas llojit dhe nivelit të aftësisë së kufizuar.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Sipas të dhënave të vitit 2024, nga 576 persona me AK (35 fëmijë me AK), 304 jetojnë në qytet dhe 272 në njësitë administrative. Kategoritë më të përfaqësuara janë invalidët (279 persona) dhe PAK të tjerë (217 persona).

Ndihma personale përfitohet nga 84 persona, ku përfshihen 17 persona para/tetraplegjikë, 15 të verbër dhe 52 me aftësi të tjera të kufizuara. Në fushën e arsimit, 14 fëmijë me AK ndjekin arsimin bazë, 8 fëmijëarsimin e mesëm dhe 4 të rritur me AK arsimin e lartë. 8 persona me AK përfitojnë bonus qiraje, një shifër që ka mbetur e pandryshuar në tre vitet e fundit.

Në periudhën Qershor 2025 deri në shkurt 2025, 39 fëmijë me AK marrin shërbime të specializuara në qendrat e mundësuara nga projekti UNDP dhe Bashkia Tepelenë, ndërkohë që 35 fëmijë me AK përfitojnë pagesën e AK. Diferenca shpjegohet me rastet kur prindërit, megjithëse e njohin gjendjen e fëmijës, nuk kanë kryer vlerësimin biopsikosocial të domosdoshëm për të përfituar pagesën. Për këta fëmijë, komisioni vlerësues pranë Drejtorisë Arsimore Tepelenë ka kryer vlerësimin pedagogjik, por procedura e vlerësimit biopsikosocial për skemën e pagesës nuk është finalizuar. Qasja e ndërgjegjësimit respekton zgjedhjen e prindërve dhe synon vendim të informuar në interesin më të mirë të fëmijës, pasi vlerësimi biopsikosocial u hap akses më të gjerë në shërbime dhe mbështetje të përshtatur, përtej pagesës, si terapi të specializuara, pajisje ndihmëse, përshtatje arsimore dhe ndërhyrje të hershme.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Bashkia Tepelenë angazhohet për të garantuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara në shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara”. Këto akte ligjore përcaktojnë standardet për mbrojtjen e të drejtave dhe ofrimin e shërbimeve të personalizuara, duke mbështetur integrimin e plotë të PAK në jetën shoqërore, ekonomike dhe kulturore të komunitetit.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Nevojat prioritare të personave me aftësi të kufizuara për Bashkinë Tepelenë janë:

- ✓ Zhvillimi i shërbimeve të specializuara për rehabilitim dhe integrim.
- ✓ Rritja e aksesit në arsim gjithëpërfshirës dhe mbështetje mësimore.
- ✓ Fuqizimi i shërbimeve komunitare për mbështetje psiko-sociale.
- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës për akses të sigurt dhe të përshtatshëm.
- ✓ Zgjerimi i programeve të punësimit të përshtatur.

Me një angazhim të fortë institucional dhe bashkëpunim me partnerët lokalë e kombëtarë, Bashkia Tepelenë synon të krijojë një mjedis ku çdo person me aftësi të kufizuara të ndjehet i mbështetur, i respektuar dhe të ketë mundësi të barabarta për zhvillim dhe pjesëmarrje aktive.

1.3 Diagnoza e fëmijëve në rrezik

Diagnoza paraqet pamjen aktuale të situatës së fëmijëve në nevojë në territorin e Bashkisë Tepelenë, duke artikuluar sfidat kryesore dhe nevojat prioritare për shërbime të integruara në komunitet. Qasja fokusohet në mirëqenien e fëmijës, vijueshmërinë arsimore dhe forcimin e funksioneve prindërore, nëpërmjet ndërhyrjeve të koordinuara me institucionet lokale dhe partnerët.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Grupi përfshin fëmijë që jetojnë në familje me vështirësi ekonomike, fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijë që ekspozohen ndaj sjelljeve me rrezik si përdorimi i substancave, si dhe fëmijë që kanë humbur ose rrezikojnë të humbasin kujdesin prindëror. Sfidat lidhen me qëndrueshmërinë familjare, përfshirjen e hershme në edukim, vijueshmërinë shkollore, mbështetjen psiko-sociale të prindërimit dhe parandalimin e sjelljeve me rrezik. Kërkohet vlerësim i plotë i situatës së familjes dhe bashkërendim i aktorëve vendorë, që shërbimet të ofrohen në kohë, afër vendbanimit dhe me vijimësi.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Në territorin e bashkisë jetojnë 844 fëmijë sipas Censurit 2023; ky numër i referohet fëmijëve rezidentë. Fëmijët në rrezik ose në nevojë përfshijnë fëmijët që jetojnë në familje përfituese të ndihmës ekonomike 163, fëmijët me aftësi të kufizuara 35, fëmijët në konflikt me ligjin 2, fëmijët përdorues të drogave 10 dhe të alkoolit 3, fëmijët me status jetimi 3, si dhe fëmijët e vendosur në familje kujdestare 1 rast. Në total rezultojnë 216 fëmijë në nevojë (pa korrigjuar mbivendosjet), që përbëjnë rreth 25.6 për qind të totalit të fëmijëve rezidentë. Në sistemin arsimor janë të regjistruar 661 fëmijë në arsimin bazë dhe të mesëm, prej të cilëve 540 në arsimin nëntëvjeçar dhe 121 në arsimin e mesëm. Në edukimin e hershëm 192 fëmijë frekuentojnë kopshtet dhe 59 ndjekin arsimin parashkollor. Janë evidentuar 17 fëmijë me prindër me aftësi të kufizuara mendore dhe 1 fëmijë me prind me aftësi të kufizuara fizike. Sipas rregullores së brendshme të bashkisë nuk parashikohet një pozicion i dedikuar ‘Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF)’; funksionet e mbrojtjes së fëmijës kryhen brenda Sektorit të kujdesit shoqëror dhe, në nivel njësisht administrative, mbulohen si funksion i deleguar nga administratori shoqëror. Mungojnë të dhëna për punësimin ose papunësinë e të miturve 16–18 vjeç dhe për fëmijët e vendosur në familje kujdestare.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Shërbimet për fëmijët mbështeten në rrjetin arsimor dhe në kapacitetet e sektorit social në bashki. Shkollat nëntëvjeçare dhe degët e arsimit të mesëm në njësitë administrative funksionojnë si pika lokale të ofrimit të shërbimeve shoqërore, me hapësira të dedikuara (klasë shumëfunksionale/kënd këshillimi) me prani periodike së stafit social. Në këto hapësira zhvillohen identifikimi i hershëm, këshillimi prindëror, mbështetja psiko-sociale e lëvizshme, aktivitetet pas shkolle dhe referimi drejt shërbimeve specialistike. Çerdhja funksionon në qytet, ndërsa kopshtet në të gjitha njësitë administrative, duke lehtësuar aksesin në edukimin e hershëm.

Në zbatim të Ligjit nr. 121/2016 dhe Ligjit nr. 18/2017, bashkia formalizon delegimin e përkohshëm të funksionit të PMF te administratorët shoqërorë deri në miratimin e pozicionit të posaçëm dhe unifikon praktikën e menaxhimit të rastit. Administratorët shoqërorë ofrojnë shërbime parashoqërore dhe, sipas rastit, mbulojnë funksionin e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe të specialistit të NJVRN, në koordinim me Sektorin e kujdesit shoqëror. Stafi i sektorit, në bashkëpunim me organizata lokale dhe kombëtare të shoqërisë civile, zhvillon fushata ndërgjegjëse dhe sesione edukative në shkolla dhe komunitet për të drejtat e fëmijëve, parandalimin e dhunës, përdorimin e sigurt të internetit, shëndetin mendor dhe prindërimin pozitiv. Bashkërendimi me drejtoritë e shkollave, qendrat shëndetësore dhe strukturat e rendit mundëson menaxhim rasti dhe ndjekje të strukturuar pranë vendbanimit.

Aktualisht në Bashkinë Tepelenë mungojnë shërbime shoqërore të strukturuar për fëmijë; ndërhyrjet janë kryesisht parashoqërore dhe të herëpashershme, pa një PMF të dedikuar.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Bazuar në diagnozën dhe orientimin strategjik të Bashkisë Tepelenë, nevojat prioritare janë:

- ✓ Formalizimi i PMF dhe unifikimi i menaxhimit të rastit
- ✓ Zhvillimi i shërbimeve komunitare të dedikuara për fëmijë, në partneritet me OJF-të dhe institucionet vendore.
- ✓ Sistem elektronik unik i të dhënave dhe monitorimit.
- ✓ Forcimi i kapaciteteve të stafit social dhe administratorëve shoqërorë për identifikim të hershëm, referim dhe menaxhim rasti

Diagnoza pasqyron një realitet me potencial: megjithëse mungojnë shërbime të strukturuar të dedikuara për fëmijë, ekziston një bazë funksionale mbi të cilën mund të ndërtohet. Rrjeti i shkollave dhe kopshteve, bashkë me angazhimin e administratorëve

shoqërorë dhe stafit të sektorit social, krijon terrenin për identifikim të hershëm, këshillim dhe mbështetje të afërt me komunitetin. Me formalizimin e rolit të mbrojtjes së fëmijës, standardizimin e referimit dhe menaxhimit të rastit, si dhe forcimin e partneriteteve me OJF-të dhe institucionet, Bashkia Tepelenë mund të shndërrojë ndërhyrjet e shpërndara në shërbime të qëndrueshme e të besueshme. Kjo qasje rrit aksesin, cilësinë dhe ndikimin, duke e vendosur mirëqenien e fëmijëve në qendër të veprimit publik.

1.4 Diagnoza për viktimat e dhunës dhe trafikimit

Dhuna në marrëdhëniet familjare dhe në bazë gjinore cenon dinjitetin, shëndetin fizik e mendor dhe kohezionin social të komunitetit. Për një bashki të vogël, si Bashkia Tepelenë, ku njerëzit njihen mes tyre, parandalimi dhe reagimi kërkojnë besim, komunikim të qartë dhe mekanizma funksionalë mbrojtjeje. Kjo diagnozë vendos fokusin te krijimi i kushteve për raportim të sigurt, koordinim ndërinstitutional dhe ofrim shërbimesh të aksesueshme, duke u mbështetur në rolin ligjor të bashkisë për garantimin e mbrojtjes dhe barazisë gjinore.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ngarkon bashkitë të sigurojnë parandalim, mbrojtje dhe ndërhyrje të koordinuar, përfshirë emërimin e Koordinatorit Vendor dhe funksionimin e mekanizmit vendor të referimit. VKM nr. 327, datë 2.06.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës”, përcakton krijimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) pranë çdo bashkie, përbërjen (komitet drejtues, ekip teknik ndërdisiplinor, koordinator vendor), procedurën e menaxhimit të rasteve dhe bashkëpunimin ndërinstitutional. Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, forcon rolin e bashkive në vlerësim, planifikim, financim dhe kontraktim/licencim të shërbimeve, si dhe në garantimin e standardeve të cilësisë, përfshirë paketat mbështetëse për viktimat e dhunës.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Viktimat e dhunës mund të jenë gra, burra, fëmijë, të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara; dhuna shfaqet në forma fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale. Në realitetin vendor, barrierat kryesore janë frika nga ekspozimi në një mjedis të vogël, varësia ekonomike, stigmatizimi, normalizimi i dhunës si “çështje familjare” dhe mosbesimi te institucionet. Këto sjellin mosraportim, vonesë në kërkimin e ndihmës dhe rrezik të përsëritjes së dhunës. Pa një figurë të qartë përgjegjëse dhe pa kanale të sigurta komunikimi, viktimat nuk e shohin sistemin si të besueshëm dhe mbeten të pambrojtura.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Tri vitet e fundit nuk ka raste të deklaruara. Kjo kërkon vendosjen e “zero-reporting” dhe ngritjen e një regjistri të unifikuar për sinjalizime, konsultime dhe referime, me role dhe afate të qarta. Koordinatori për Dhunën dhe Barazinë Gjinore nuk është i emëruar zyrtarisht; funksioni kryhet si detyrë e deleguar nga Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Sociale, çka kufizon vizibilitetin, llogaridhënien dhe komunikimin publik.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Nuk ka shërbime të dedikuara për viktimat e dhunës në nivel vendor dhe NJVRN nuk funksionon si mekanizëm i rregullt për identifikim, vlerësim dhe referim. Nuk ka evidenca për një kanal të dedikuar e konfidencial raportimi (telefon) të publikuar, as për materiale informative të standardizuara që shpjegojnë hapat e ndihmës; mungesa e tyre ul gatishmërinë për të raportuar. Ndërveprimi ndërmjet sektorit social, policisë dhe shërbimeve shëndetësore mbetet i rastësishëm, pa protokoll të unifikuar me afate dhe role të qarta, duke e bërë reagimin të vonuar dhe të paunifikuar.

Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Të formalizohet dhe të fuqizohet pozicioni i koordinatorit të dhunës dhe barazisë gjinore
- ✓ Të ngrihet NJVRN dhe të ndiqet protokoll bashkërendimi me Policinë dhe shërbimet shëndetësore.
- ✓ Të krijohen kanale të sigurta dhe konfidenciale të raportimit dhe të informohet komuniteti për to.
- ✓ Të zbatohen programe ndërgjegjësimi dhe informimi për parandalim dhe akses në mbrojtje.
- ✓ Të zhvillohet bazë e të dhënave për monitorim dhe raportim periodik.

Duke emëruar zyrtarisht Koordinatorin për Dhunën dhe Barazinë Gjinore dhe duke vënë në lëvizje NJVRN, bashkia kthen besimin e qytetarëve në mbrojtje sociale reale. Me kanale raportimi të sigurta dhe me një ekip që bashkëpunon sipas protokollit, çdo thirrje për ndihmë merr përgjigje të shpejtë. Fushatat e informimit dhe ndërgjegjësimit hapin rrugë për parandalim dhe e bëjnë komunitetin aleat të viktimave. Baza e të dhënave dhe raportimi periodik na lejojnë të masim progresin dhe të përmirësojmë vazhdimisht shërbimet. Ky është një tranzicion nga heshtja te veprimi, nga pasiguria te mbrojtja, dhe nga rreziku te shpresa.

1.5 Diagnoza për të moshuarit në nevojë

Të moshuarit në Bashkinë Tepelenë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të komunitetit, me nevoja të veçanta që lidhen me kujdesin shëndetësor, social dhe emocional. Ndërsa bashkia përballët me mungesën e shërbimeve të specializuara për këtë grup, ekziston potencial për përmirësim përmes zhvillimit të shërbimeve komunitare dhe

bashkëpunimeve ndërbashkiake, veçanërisht me Bashkinë Gjirokastrë, e cila disponon një qendër rezidenciale për të moshuar.

Sesion 1: Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Në vitet e fundit është vërejtur një rritje e numrit të të moshuarve në territorin e Bashkisë Tepelenë, duke theksuar nevojën për shërbime të përshtatura dhe të qëndrueshme. Sfidat kryesore përfshijnë vetminë, mungesën e mbështetjes familjare dhe kufizimet shëndetësore, të cilat shpesh shoqërohen me mungesën e aksesit në shërbime të strukturuar. Këto rrethana kërkojnë zhvillimin e një rrjeti të integruar mbështetjeje që ofron kujdes dhe përfshirje sociale për këtë grupmoshë.

Sesion 2: Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Sipas Censit 2023, Bashkia Tepelenë ka një popullsi prej 6,761 banorësh në qytet dhe 5,731 në 3 Njësitë administrative Qender, Lopes, Kurvelesh, prej të cilëve 1,723 janë të moshuar (65+ vjeç). Nga të dhënat për vitin 2025 rezulton se 300 të moshuar kërkojnë shërbim në familje dhe 5 kërkojnë shërbim rezidencial. Po ashtu, janë evidentuar 332 të moshuar të vetmuar, ndërsa vetëm 9 prej tyre përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. Shpërndarja sipas njësive administrative tregon se NJA Qytete ka numrin më të lartë të të moshuarve që kërkojnë shërbim (135 raste) dhe të vetmuar (203 raste), ndërsa NJA Kurvelesh dhe NJA Lopës kanë numra më të ulët por me nevoja specifike. Në bashki ofrohet një shërbim i dedikuara shoqërore për të moshuarit por është i kufizuar dhe i fokusuar vetëm në qytetin e Tepelenës, çka thekson nevojën për zhvillimin e një rrjeti shërbimesh të integruara në nivel vendor.

Sesion 3: Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Aktualisht në Bashkinë Tepelenë ofrohet një shërbimle vizës duke ofruar shërbime në familje për të moshuarit. Nevojat për shërbime rezidenciale mbulohen nëpërmjet Qendrës Rezidenciale Gjirokastrë. Mungojnë forma të tjera të shërbimeve sociale si shërbime ditore, komunitare etj. Shërbimi levizës është i kufizuar, vetëm 70 të moshuar përfitojnë shërbime në shtëpi ndërkohë nevojat janë më të mëdha. Mbështetja ofrohet gjithashtu edhe përmes ndihmës ekonomike dhe shërbimeve bazë të administratorëve shoqërorë. Nuk ekzistojnë qendra komunitare ose programe të dedikuara për këtë grupmoshë, gjë që kufizon mundësinë për përfshirje sociale dhe akses në shërbime të përshtatura.

Sesion 4: Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Ngritja e një shërbimi rezidencial ose ditor për të moshuarit.
- ✓ Zgjerimi i shërbimeve në familje dhe shtimi i stafit të specializuar.
- ✓ Krijimi i programeve të përfshirjes sociale dhe aktiviteteve komunitare.
- ✓ Hartimi i një databaze të plotë me të dhëna për të moshuarit dhe nevojat e tyre.

- ✓ Forcimi i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare dhe partnerët e tjerë lokalë.

Pavarësisht sfidave aktuale, Bashkia Tepelenë ka potencial të ndjeshëm për të avancuar në kujdesin ndaj të moshuarve. Duke forcuar bashkëpunimin institucional, zhvilluar shërbime komunitare dhe shfrytëzuar mundësitë e qendrave ekzistuese në rajon, mund të krijohet një mjedis ku të moshuarit ndihen të përfshirë, të respektuar dhe të mbështetur. Ky orientim do të kontribuojë në një jetë më aktive, dinjitoze dhe të gëzuar për moshën e tretë.

1.6 Diagnoza për komunitetin egjiptian

Diagnoza – Komuniteti Egjiptian (Bashkia Tepelenë)

Diagnoza fokusohet vetëm te komuniteti egjiptian, i vetmi komunitet i pranishëm në Bashkinë Tepelenë (konfirmim zyrtar). Dokumenti është praktik dhe i shkurtër, i lidhur me masat e planit social 2025–2029.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Komuniteti egjiptian ka lidhje të forta familjare dhe një ekonomi të brishtë. Sfidat kryesore janë vijueshmëria arsimore e fëmijëve, akses i kufizuar në shërbimet shëndetësore dhe sociale, përmirësimi i kushteve të banimit dhe mundësi reale për punësim dhe formim profesional.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Aktualisht bashkia evidenton 542 familje egjiptiane me 789 banorë. Në edukimin e hershëm janë 5 fëmijë në kopsht dhe 1 në çerdhe, ndërsa 35 fëmijë ndjekin shkollën. Identifikohen 2 fëmijë dhe 12 të rritur me AK, prej të cilëve 1 fëmijë merr shërbime shoqërore. Nga skemat sociale përfitojnë 22 familje nga Ndihma Ekonomike dhe 9 familje nga bonusi i qirasë.

Boshllëqet e të dhënave burojnë nga mungesa e një baseline të unifikuar që të sigurojë ndarje sipas gjinisë dhe moshës, shpërndarje sipas njësive administrative, pasqyrim të nevojave sipas ciklit jetësor të anëtarëve (fëmijë, të rritur, të moshuar) si dhe raporte periodike të strukturuar me indikatorë, prirje dhe devijime për përdorim menaxherial dhe rishikim masash.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Aktualisht nuk rezultojnë shërbime sociale të strukturuar të bashkisë për komunitetin egjiptian.

Në strukturën e bashkisë nuk ka staf të dedikuar për trajtimin e çështjeve të komunitetit egjiptian. Lidhja me shërbimet realizohet vetëm përmes Administratorit Shoqëror, ndaj mbulimi territorial, ndjekja e rasteve dhe intensiteti i mbështetjes mbeten të kufizuara.

Mungojnë programe të strukturuar të ndërgjegjësimit dhe informimit komunitar (p.sh. për të drejtat dhe aksesin në shërbime, edukim prindëror, shëndet parësor, strehim dhe punësim). Kjo tregon nevojën për shërbime komunitare dhe në familje, si dhe koordinim të qëndrueshëm ndërsektorial (arsimi, shëndetësia, strehimi dhe punësimi).

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Nevojat e mëposhtme burojnë nga analiza dhe boshllëqet e identifikuar më lart.

- ✓ Ngritja e një databaze elektronike të unifikuar me ndarje sipas gjinisë, moshës, njësive administrative dhe nevojave (fëmijë/të rritur/të moshuar).
- ✓ Krijimi dhe funksionalizimi i shërbimeve komunitare dhe shërbimeve në familje (paketa të shkurtra, mobile dhe në qendër komunitare).
- ✓ Programe të strukturuar ndërgjegjësimi dhe informimi për komunitetin egjiptian (arsimi, shëndeti, strehimi, të drejtat dhe skemat sociale).
- ✓ Fuqizimi socio-ekonomik përmes formimit profesional të orientuar, ndërmjetësimit në punë dhe mbështetjes për akses në kurse (p.sh. transport).
- ✓ Të përcaktohet një rol i dedikuar në Sektorin e Çështjeve Sociale për çështjet e komunitetit egjiptian dhe të trajnohet stafi i sektorit për koordinim, punë në terren, ndërgjegjësim dhe referim rastesh.
- ✓ Sistem raportimi periodik (vjetor/tremujor) i indikatorëve kryesorë me analiza prirjesh dhe rishikim masash (M&E).

Vendosja e baseline-it, ngritja e shërbimeve komunitare/dhe në familje, programet e ndërgjegjësimit dhe forcimi i stafit janë kushtet kyçe për mbulim real dhe të barabartë të komunitetit egjiptian në Bashkinë Tepelenë gjatë periudhës 2025–2029.

1.7 Diagnoza për individë përdorues të alkoolit

Përdorimi i alkoolit në bashki ndikon tek të rriturit dhe tek fëmijët, dëmton shëndetin, rrit rreziqet sociale dhe e rëndon funksionimin familjar e komunitar. Të dhënat nga Policia konfirmojnë praninë e rasteve; mungesa e një regjistri të përbashkët në nivel bashkie e vështirëson vlerësimin dhe planifikimin vendor. Kjo diagnozë qartëson përshkrimin e grupit, boshllëqet e informacionit dhe situatën e shërbimeve, duke përcaktuar prioritetet për një reagim të koordinuar vendor.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Sipas të dhënave vendore, të gjithë rastet e evidentuara të përdoruesve të alkoolit janë meshkuj; 3 prej tyre janë fëmijë djem. Pasojat shfaqen në shëndetin fizik dhe mendor, në marrëdhëniet familjare, në kujdesin prindëror dhe në integrimin shoqëror.

Në familje vihen re tensione, konflikte dhe rrezik i neglizhencës prindërore; te fëmijët shfaqen vështirësi në pjesëmarrjen shkollore dhe në mirëqenie emocionale, ndërsa komuniteti përballët me sjellje që çenojnë rendin dhe sigurinë. Stigma dhe frika nga ekspozimi e pengojnë kërkimin e ndihmës, duke vonuar adresimin e hershëm. Në mungesë të një pike të qartë kontakti në sektorin social, familjet nuk e dinë ku të drejtohen dhe rrezikojnë të mbeten pa mbështetje të strukturuar.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Aktualisht bashkia nuk disponon të dhëna të strukturuar për përdoruesit e alkoolit. Policia raporton 23 persona (të gjithë meshkuj), nga të cilët 3 janë fëmijë djem; ky informacion nuk është i integruar në një bazë të përbashkët me ndarje sipas njësive administrative dhe moshës. Mungon regjistri i rasteve në sektorin social, mungojnë frekuenca dhe formatet e raportimit, dhe nuk ka mekanizma të dakordësuar për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Policisë, shëndetësisë dhe bashkisë.

Pa një set minimal treguesish dhe pa standarde për cilësinë e të dhënave, nuk sigurohet gjurmueshmëri e rasteve, nuk parashikohen nevojat dhe mbetet e pamundur të vlerësohet ndikimi i ndërhyrjeve.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Aktualisht mungojnë shërbime shoqërore të dedikuara për personat me përdorim problematik të alkoolit dhe NJVRN nuk funksionon si mekanizëm vendor për vlerësim dhe referim. Administratorët shoqërorë në njësitë administrative ofrojnë shërbime parashoqërore për identifikim bazë, informim dhe orientim të familjeve, por nuk kanë trajnim të specializuar për problematikën e alkoolit dhe kanë nevojë për përmirësim të aftësive në identifikim të hershëm, këshillim bazë dhe procedura referimi. Rekomandohet emërimi i një specialisti (pike kontakti) në sektorin social për koordinim me Policinë dhe shërbimet shëndetësore.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Ngritja e NJVRN si mekanizëm lokal për identifikim, vlerësim dhe referim të rasteve.
- ✓ Krijimi i një baze të përbashkët të të dhënave me ndarje sipas moshës dhe njësive administrative, me protokolle raportimi periodik.
- ✓ Emërimi i një pike të vetme kontakti në sektorin social për koordinim me Policinë dhe shërbimet shëndetësore (specialisti i çështjeve sociale).

- ✓ Zbatimi i programeve të ndërgjegjësimit dhe parandalimit në komunitet dhe në shkolla.
- ✓ Ndërtimi i protokolleve të referimit drejt shërbimeve shëndetësore dhe mbështetjes familjare.
- ✓ Trajnim i administratorëve shoqërorë për identifikim të hershëm, këshillim bazë, menaxhim dokumentacioni dhe referim të sigurt.
- ✓ Vendosja e raportimit mujor/trimestral ndër-institucional me format unik dhe listë minimale treguesish.

Diagnoza evidenton praninë e rasteve të përdorimit të alkoolit dhe një boshllëk të dukshëm në të dhëna dhe shërbime. Të dhënat aktuale tregojnë se të gjithë rastet e raportuara janë meshkuj, përfshirë 3 djem. Theksi vendoset te ngritja e një mekanizmi vendor funksional, rrugë referimi të qarta dhe një bazë e përbashkët të dhënash. Administratorët shoqërorë përbëjnë një aset në terren dhe, me trajnimin e duhur, mund të rrisin identifikimin e hershëm dhe orientimin e familjeve. Përmes koordinimit me Policinë dhe shëndetësinë dhe programeve parandalese në komunitet e shkolla, bashkia mund të ndërtojë një përgjigje efektive dhe të qëndrueshme.

1.8 Diagnoza për individë përdorues të drogës

Përdorimi i drogave në territorin e bashkisë ndikon në shëndetin, mirëqenien familjare dhe sigurinë komunitare. Të dhënat orientuese nga Policia për territorin e bashkisë raportojnë 30 raste, përfshirë 10 fëmijë, ndërsa mungon një regjistër i unifikuar vendor që lehtëson planifikimin dhe vlerësimin. Kjo diagnozë sqaron përmasat, boshllëqet informuese dhe situatën e shërbimeve, duke përcaktuar nevoja konkrete për veprim të koordinuar.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Përdoruesit përfshijnë të rinj dhe të rritur me profile të ndryshme sociale; fëmijët preken drejtpërdrejt ose përmes dinamikave familjare. Pasojat shfaqen në shëndetin fizik e mendor, braktisje ose dobësim të pjesëmarrjes shkollore, konflikte familjare, rrezik viktimizimi dhe izolim social.

Stigma dhe frika nga ekspozimi vonojnë kërkimin e ndihmës në kohë; pa ndërhyrje të hershme rritet rreziku i përkeqësimit dhe përsëritjes. Familjet përballen me ngarkesë të lartë emocionale dhe ekonomike, ndërsa komuniteti has shqetësime për sigurinë dhe rendin. Pa orientim të qartë dhe ndërhyrje të hershme, rritet rreziku për përkeqësim të gjendjes dhe përsëritje të sjelljeve problematike.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Bashkia nuk disponon të dhëna të strukturuar për përdoruesit e drogave me ndarje sipas gjinisë, moshës dhe njësive administrative. Policia referon 30 raste, nga të cilat 10 janë fëmijë, por ky informacion nuk integrohet në një bazë të vetme me standarde të qarta raportimi.

Mungon regjistri i rasteve në sektorin social, seti minimal i treguesve, periodiciteti i raportimit dhe protokollet ndërinstitucionale për shkëmbim të sigurt të të dhënave. Pa këto elemente, gjurmueshmëria e rasteve, vlerësimi i nevojave dhe matja e rezultateve mbeten të kufizuara.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Nuk ka shërbime shoqërore të dedikuara për përdoruesit e drogave dhe NJVRN nuk funksionon si mekanizëm vendor për identifikim, vlerësim dhe referim. Administratorët shoqërorë në njësitë administrative ofrojnë shërbime parashoqërore (identifikim bazë, informim, orientim), por nuk janë të trajnuar për problematikat e varësisë dhe kanë nevojë për aftësim në identifikim të hershëm, këshillim bazë dhe procedura të standardizuara referimi.

Nuk ekziston një pikë e vetme kontakti në sektorin social dhe rruga e referimit me Policinë dhe shëndetësinë nuk është e unifikuar, çka vonon adresimin e rasteve.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Funksionalizimi i NJVRN për identifikim, vlerësim dhe referim të rasteve.
- ✓ Krijimi i një baze të unifikuar të të dhënave me ndarje sipas gjinisë, moshës dhe njësive administrative, me raportim periodik.
- ✓ Përcaktimi i pikës së vetme të kontaktit në sektorin social dhe protokolle të qarta bashkërendimi me Policinë dhe shëndetësinë.
- ✓ Zbatimi i programeve të parandalimit dhe ndërgjegjësimit në komunitet dhe në shkolla.
- ✓ Mbështetje psikosociale për individët dhe familjet, lidhje sistematike me shërbimet shëndetësore dhe ndjekje e rasteve.
- ✓ Trajnim i administratorëve shoqërorë për identifikim të hershëm, menaxhim dokumentacioni dhe referim të sigurt.
- ✓ Protokolle referimit drejt shërbimeve të trajtimit të varësisë dhe ndjekje e rregullt deri në mbyllje të rastit.

Kjo diagnozë përcakton qartë problemin, boshllëqet dhe hapat e zgjidhjes në nivel vendor. Me një NJVRN funksionale, pikë të vetme kontakti dhe bazë të dhënash të unifikuar, bashkia fiton kapacitet për reagim të shpejtë dhe të koordinuar. Trajnimi i administratorëve shoqërorë dhe programet parandaluese në komunitet e shkolla rrisin identifikimin e hershëm dhe ulin rreziqet. Mbështetja psikosociale për familjet dhe lidhja

e strukturuar me shëndetësinë garanton ndjekje të qëndrueshme. Qasja e propozuar është realiste, e matshme dhe e orientuar drejt rezultatit për fëmijët, familjet dhe komunitetin.

1.9 Diagnoza për individë LGBTIQ+

Personat LGBTIQ+ përballen me sfida që prekin mirëqenien individuale, marrëdhëniet familjare, mjedisin shkollor dhe mundësitë ekonomike në territorin e bashkisë. Aktualisht mungojnë të dhënat zyrtare dhe nuk ekzistojnë shërbime të dedikuara, çka e vështirëson vlerësimin e saktë të nevojave dhe planifikimin e ndërhyrjeve. Kjo diagnozë përshkruan situatën, boshllëqet kryesore dhe gjendjen e shërbimeve, duke përcaktuar një paketë të qartë veprimesh për një përgjigje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Personat LGBTIQ+ janë një grup i larmishëm me identitete gjinore dhe orientime seksuale të ndryshme (SOGIESC: orientim seksual, identitet/ekspresion gjinor dhe karakteristika seksuale). Në mungesë të shërbimeve miqësore dhe kanaleve të sigurta, dukshmëria e ulët çon në nën-raportim dhe izolim social.

Diskriminimi, stigmatizimi dhe bullizmi ndikojnë në shëndetin mendor, rrisin rrezikun e braktisjes ose mospjesëmarrjes shkollore te të rinjtë dhe krijojnë tensione në marrëdhëniet familjare. Frika nga ekspozimi dhe mungesa e besimit te institucionet pengojnë kërkimin e ndihmës. Brenda komunitetit, të rinjtë, personat trans dhe ata që jetojnë në varfëri mund të përballen me rreziqe të shtuara për dhunë dhe viktimizim.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Nuk ka të dhëna të strukturuar në nivel bashkie për personat LGBTIQ+. Mungon një bazë e përbashkët e të dhënave, nuk ka ndarje sipas moshës dhe njësive administrative dhe nuk ekzistojnë standarde për mbledhje, ruajtje dhe përdorim të sigurta të informacionit.

Nuk ka protokolle për vetëdeklarim vullnetar, as format të unifikuar raportimi me respektim të konfidencialitetit. Pa tregues minimalë dhe pa periodicitet raportimi, bashkia nuk mund të vlerësojë përmasën e problemit, të projektojë nevoja apo të masë ndikimin e ndërhyrjeve. Aktualisht, informacioni mbështetet në perceptime të stafit dhe sinjalizime joformale, të pamjaftueshme për planifikim.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Nuk ka shërbime shoqërore të dedikuara për personat LGBTIQ+ dhe NJVRN nuk funksionon për identifikim, vlerësim dhe referim të kësaj kategorie. Administratorët shoqërorë në njësitë administrative ofrojnë shërbime parashoqërore për orientim dhe

informim bazë, por nuk janë të trajnuar për komunikimin jodiskriminues, dhe trajtimin e çështjeve të orientimit seksual dhe shprehjes gjinore, nuk kanë udhëzues praktik për komunikim të sigurt dhe nuk përdorin procedura të standardizuara për referim të konfidencial.

Nuk ekziston një pikë e vetme kontakti në sektorin social, nuk ka hapësira miqësore ose këshillim psikosocial të specializuar dhe rrugët e referimit drejt shëndetësisë, arsimit dhe mekanizmave të mbrojtjes nga diskriminimi nuk janë të qarta.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Të funksionalizohet NJVRN me procedura gjithëpërfshirëse dhe konfidenciale.
- ✓ Të emërohet një pikë e vetme kontakti e trajnuar për çështjet e orientimit seksual, identitetit dhe shprehjes gjinore si dhe të miratohen protokolle koordinimi me shëndetësinë, arsimin dhe rendin.
- ✓ Të krijohet një bazë e dhënash e sigurt me tregues minimalë dhe raportim mujor/trimestral, duke përdorur vetëdeklarim vullnetar.
- ✓ Të trajnohet stafi në vijë të parë për identifikim të hershëm, komunikim të paanshëm, këshillim bazë dhe referim të sigurt.
- ✓ Të krijohen shërbime miqësore dhe rrugë referimi, të vendoset mekanizëm i thjeshtë ankimi dhe të zhvillohen fushata kundër stigmatizimit e bullizmit.

Diagnoza vë në dukje boshllëkun total në të dhëna dhe shërbime, por ofron një rrugë të qartë zgjidhjeje. Me NJVRN funksionale, një pikë të vetme kontakti të trajnuar dhe një bazë të dhënash të sigurt, bashkia fiton kapacitet për reagim të shpejtë dhe koherent. Trajnimi i stafit dhe shërbimet miqësore rrisin identifikimin e hershëm dhe besimin e qytetarëve. Rrugët e referimit dhe mekanizmat e ankimit sigurojnë mbrojtje dhe akses të barabartë. Qasja e propozuar është realiste, e maturueshme dhe e orientuar drejt rezultateve për një komunitet më gjithëpërfshirës.

Përmbledhje e diagnozës sociale së familjeve dhe individëve në nevojë

. Pamja e përgjithshme tregon se grupet vulnerabël përballen me vështirësi të ndërthurura ekonomike, sociale dhe shëndetësore, ndërsa mbështetja publike mbetet e fragmentuar dhe kryesisht parashoqërore. Mungon një sistem i unifikuar informacioni për identifikim të hershëm, ndjekje dhe vlerësim të rasteve; mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional nuk funksionojnë rregullisht; dhe shërbimet e strukturuar (në familje, ditore, komunitare, të specializuara) janë të pakta dhe të përqendruara kryesisht në qendër, duke krijuar pabarazi territoriale në akses. Në nivel stafi dhe funksionesh, rolet kyçe (punonjësi

për mbrojtjen e fëmijës, koordinatori për dhunën dhe barazinë gjinore, ekipi teknik ndërdisiplinor) kërkojnë formalizim, rritje kapacitetesh dhe protokolle të unifikuara për menaxhimin e rasteve. Në planin socio-ekonomik, varfëria, papunësia dhe mungesa e lidhjeve të qëndrueshme me tregun e punës kufizojnë efektin e mbështetjes; po ashtu, nënraportimi (p.sh. i dhunës), stigma dhe mungesa e kanaleve konfidenciale e bëjnë një pjesë të nevojave “të padukshme”. Në sfond vepron struktura demografike me peshë të lartë të moshës së tretë, që rrit kërkesën për kujdes afatgjatë, mobilitet dhe shërbime të përshtatura në komunitet.

Tre drejtime kryesore veprimi

1. **Shtrirja dhe standardizimi i shërbimeve të integruara afër vendbanimit.** Zhvillim i shërbimeve në familje dhe në qendra komunitare multifunktionale; paketa mbështetëse të personalizuar; aksesueshmëri fizike dhe digjitale në gjithë territorin.
2. **Qeverisje dhe koordinim për cilësi.** Formalizim rolesh dhe mekanizmash (PMF, koordinator, ekip ndërdisiplinor/NJVRN); protokolle unike të menaxhimit të rasteve; sistem elektronik të dhënash për identifikim të hershëm, monitorim dhe llogaridhënie, rritje e kapaciteteve të stafit.
3. **Fuqizim social-ekonomik dhe përfshirje.** Programe formimi profesional e ndërmjetësimi në punësim; këshillim prindëror dhe mbështetje psikosociale; fushata informimi/ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrje aktive e përfituesve në vendimmarrje.

2. Diagnoza e shërbimeve shoqërore

Diagnoza e shërbimeve shoqërore në Bashkinë Tepelenë synon të ofrojë një vlerësim të thelluar të situatës aktuale të mbështetjes për familjet dhe individët në nevojë, të evidentojë boshllëqet dhe të orientojë ndërhyrjet e duhura për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes sociale në nivel vendor. Procesi bazohet në të dhënat e përdorura gjatë diagnozës së kategorive në nevojë dhe në informacionin zyrtar mbi shërbimet ekzistuese: qendra e profilizuar për fëmijët me aftësi të kufizuara (AK), e mbështetur nga UNDP (në funksion prej rreth dy vitesh), dhe shërbimi lëvizës në familje për të moshuarit i mbështetur nga Fondi Social dhe Bashkia.

Vëmendja është përqendruar në vlerësimin e aksesit, cilësisë dhe mbulimit të shërbimeve për kategori të ndryshme vulnerabël, si dhe në identifikimin e grupeve të papërfshira në sistemin aktual të referimit dhe përkujdesjes. Dokumenti hartohet në përputhje me Ligjin nr. 121/2016 dhe Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2023–2029.

1. Përshkrimi i përgjithshëm dhe sfidat kryesore

Bashkia Tepelenë ofron dy shërbime kyçe (një qendër të profilizuar për fëmijët me AK dhe shërbimin lëvizës në familje për të moshuarit) nëpërmjet projekteve të mbështetura

nga Fondi Social dhe UNPD ,ndërsa administratorët shoqërorë, në mungesë të roleve të formalizuara, mbulojnë de facto funksionet e PMF dhe NJVRN. Sfidat përqendrohen te fragmentimi i ofertës, mungesa e protokolleve të unifikuara dhe e një sistemi elektronik për regjistrim/raportim (përfshirë standardizimin e takimeve ndërdisiplinore), lidhja ende e dobët mes të dhënave, planifikimit dhe buxhetimit, buxheti vendor i kufizuar (bashki e vogël me të ardhura të ulëta dhe varësi nga transferat qendrore) si edhe mungesa e një ekosistemi aktiv të shoqërisë civile; në këto kushte, pavarësisht dy shërbimeve ekzistuese, kufizohen cilësia e menaxhimit të rasteve, shpejtësia e reagimit dhe llogaridhënia.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Të dhënat tregojnë një diferencë të qartë ndërmjet madhësisë së nevojës dhe mbulimit me shërbime të strukturuar. Regjistri Civil 2024 evidenton bazën familjare dhe madhësinë e popullsisë, ndërsa të dhënat tematike pasqyrojnë grupe specifike në nevojë dhe shërbimet reale që funksionojnë sot. Mungesa e një sistemi unik elektronik dhe e raportimit të standardizuar për kategoritë në nevojë e mban një pjesë të nevojave të padukshme në planifikim.

Analiza prezanton:

- a) Familje dhe individë në nevojë:
 - 576 persona me AK;
 - 144 familje në nevojë;
 - 216 fëmijë në nevojë;
 - 332 të moshuar të vetmuar në nevojë;
 - 23 përdorues alkooli dhe
 - 30 përdorues droge.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi territorial

Qendra për fëmijët me AK dhe shërbimi lëvizës në familje për të moshuarit përbëjnë boshtin aktual të mbështetjes së strukturuar. Krahës tyre, administratorët shoqërorë në njësitë administrative sigurojnë shërbime parashoqërore (identifikim të hershëm, informim, orientim, ndihmë për dokumentacionin dhe referim) duke shërbyer si porta hyrëse për rastet. Bashkia ka zbatuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e fëmijës duke i deleguar funksionin e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) administratorit shoqëror, çka ka mundësuar reagim minimal funksional edhe në mungesë të një pozicioni të dedikuar.

Mekanizmat e referimit dhe menaxhimit të rastit aktivizohen sipas nevojës dhe koordinohen nga Sektori i Shërbimeve Sociale; i njëjti model koordinator zbatohet për

Koordinatorin për Dhunën dhe Barazinë Gjinore dhe për Mekanizmin e Koordinuar të Referimit (MKR).

Mbi mbulimin territorial dhe të përfituesve, qendra për fëmijët me AK mbulon 39 fëmijë dhe ka shtrirje të kufizuar, ndërsa shërbimi lëvizës në familje siguron kujdes në familje për 79 të moshuar në nevojë. Të dy shërbimet ofrohen në territorin e qytetit të Tepelenës dhe kapaciteti mbetet i pamjaftueshëm krahasuar me nevojën. Mungojnë qendra ditore/komunitare për fëmijët, familjet në nevojë dhe të rritur me AK, shërbime të specializuara për viktimat e dhunës (përfshirë strehimin emergjent), si edhe programe të dedikuara për përdoruesit e substancave/alkoolit dhe për personat LGBTIQ+. Kjo krijon pabarazi në akses dhe fragmenton zinxhirin e mbrojtjes sociale në territor.

4. Përmbledhje sintetike e mbulimit dhe nevojave

Kategoria në nevojë	Përfitues aktualë (shërbime të strukturuar)	Shërbimet ekzistuese	Nevojat për shërbime
Familje në nevojë	144	-	Qendra ditore; shërbime në familje; programe prindërimi
Fëmijë me AK	39 ¹	Qendër e profilizuar (UNDP)	Zgjerim kapacitetesh; terapi/rehabilitim; shtrirje komunitare
Të rritur me AK	541	-	Qendra ditore; shërbime në familje;
Fëmijë	216	-	Qendra ditore; shërbime në familje; mbrojtje e fëmijës
Të moshuar të vetmuar në nevojë 332	79 (në familje)	Shërbimi lëvizës në familje	Zgjerim në të gjitha njësitë; qendra ditore; kujdes afatgjatë
Dhunë në familje	-	-	Mekanizëm funksional (NJVRN); strehim emergjent; ndihmë ligjore/psikologjike

¹ Numri i fëmijëve me AK është i lartë se numri i fëmijëve përfitues të AK, kjo për shkak të mospranimit të prindërve të dërgojnë për vlerësim bio-psiko-social fëmijët e tyre. Këto fëmijë janë vlerësuar me AK nga komisionet e vlerësimit nga drejtoria arsimore.

Përdorues substancave/alkoolit (23 përdorues alkooli dhe 30 përdorues droge)	-	-	Programe komunitare parandaluese/rehabilituese; këshillim
Personat LGBTQ+	-	-	Shërbime miqësore; pikë kontakti; protokolle gjithëpërfshirëse

Burimi: Bashkia Tepelenë

5. Nevojat për ndërhyrje (tre drejtime)

- ✓ Rrjet shërbimesh afër qytetarëve (qytet dhe njësi administrative). Zgjerim i shërbimit në familje dhe hapje e qendrave komunitare multifunksionale me paketa të personalizuar në çdo njësi.
- ✓ Protokolle të qartë, sisteme informacioni dhe monitorimit për qeverisje cilësore. Role të dedikuara (PMF, koordinator për dhunën/barazinë gjinore), NJVRN funksional, sistem elektronik unik për rastet, trajnime/supervizim.
- ✓ Autonomi sociale-ekonomike dhe përfshirje. Formim profesional dhe ndërmjetësim në punësim, këshillim prindëror dhe mbështetje psikosociale, fushata informimi dhe pjesëmarrje aktive.

3. Diagnoza për Burimet Njerëzore në Shërbimet Sociale në Bashkinë Tepelenë

Kjo diagnozë vlerëson kapacitetet njerëzore të shërbimeve sociale të Bashkisë Tepelenë, bazuar në rregulloren institucionale dhe organizimin aktual në nivel drejtorie, sektori dhe njësive administrative (NjA). Analiza fokusohet te rolet funksionale, flukset e punës dhe standardet ligjore, me synim rritjen e cilësisë, njëtrajtësisë dhe llogaridhënies.

1. Përshkrimi i strukturës aktuale dhe funksionit

Shërbimet sociale operojnë brenda Drejtorisë së Arsimit, Sportit dhe Kujdesit Social. Sektori i kujdesit shoqëror, strehimit dhe emergjencës civile mbulon ndihmën ekonomike, PAK, menaxhimin e rasteve dhe koordinimin ndërsektorial, si dhe gatishmërinë e shërbimeve për emergjenca natyrore, sociale dhe shëndetësore në bashkërendim me strukturat përkatëse. Në praktikë, përgjegjësjë e sektorit mban edhe rolin e NJVRN dhe të Koordinatorit për Dhunën dhe Barazinë Gjinore; një person kryen funksionin e NJMF në nivel sektori, ndërsa personeli tjetër mbulon PMF në territor.

Funksioni NJMF organizon dhe bashkërendon punën e PMF-ve në NjA (Qendër, Kurvelesh, Lopës), të cilat janë pika e parë e kontaktit dhe kryejnë identifikim, referim dhe ndjekje fillestare të rasteve.

Kjo skemë organizimi lidhet drejtpërdrejt me pozicionet e ngritura nga bashkia: Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” mbështet rolin e PMF-ve në NjA dhe përcakton proceset e mbrojtjes; Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” (i ndryshuar) jep bazën për funksionin e NJMF brenda sektorit (administrimi i mbështetjes familjare, koordinimi i rasteve dhe raportimi i cilësisë); ndërsa Ligji nr. 9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar) legjitimon rolin e Koordinatorit për Dhunën dhe Barazinë Gjinore dhe funksionin e NJVRN për vlerësimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve të dhunës në nivel vendor. Në këtë mënyrë, struktura aktuale (në qender/sektor NJMF një person, NJVRN dhe Koordinatori i dhunës dhe barazisë gjinore, në NjA/territor kemi PMF dhe NJVRN) përputhet me kërkesat e kuadrit ligjor, por kërkon formalizim më të qartë në rregullore.

2. Boshllëqet dhe sfidat në kapacitetet njerëzore

Rregullorja në fuqi nuk i ndan qartë pozicionet, çka sjell mbivendosje funksionesh dhe zbehje të llogaridhënies. Aktualisht, një person ushtron NJMF në nivel sektori, ndërsa personeli tjetër mbulon PMF në territor; për rrjedhojë, ngarkesa e koordinimit dhe mbikëqyrjes së rasteve bie disproporcionalisht mbi pak individë. Në të njëjtën kohë, roli i Koordinatorit për Dhunën dhe Barazinë Gjinore mbahet nga përgjegjësjë e sektorit, duke e vështirësuar përqendrimin në menaxhimin e thelluar të rasteve dhe në koordinimin ndërsektorial.

Dominimi i proceseve administrative (ndihmë ekonomike/PAK) kufizon kohën dhe hapësirën për ndërhyrje psiko-sociale rehabilituese në familje dhe komunitet. Mungojnë Procedura Standarte të Operimit (PSO) të unifikuara dhe një sistem i vetëm elektronik për menaxhimin e rasteve dhe të indikatorëve, prandaj të dhënat janë të pjesshme dhe të paktëzuara sipas njësive. Po ashtu, gatishmëria për emergjenca natyrore, sociale dhe shëndetësore nuk është e standardizuar nëpërmjet PSO-ve të emergjencës, pikave fokale, zinxhirit të komunikimit dhe shërbimit pas orarit.

Mungon një specialist i dedikuar për monitorimin e cilësisë së shërbimeve në territor për të matur indikatorë, kryer verifikime në vend, organizuar auditime të brendshme dhe nxjerrë raporte periodike. Për më tepër, stafi është i kufizuar përballë shtrirjes territoriale të NjA-ve dhe nuk ekziston një cikël vjetor i aftësimit dhe i supervizimit profesional për rolet kyçe (PMF, NJMF, NJVRN, koordinatorët dhe stafi i NjA).

3. Pasojat e mungesës së burimeve njerëzore

Boshllëqet e mësipërme ndikojnë drejtpërdrejt në kohën e reagimit dhe thellësinë e ndërhyrjes. Identifikimi i rrezikut dhe nevojave komplekse (fëmijë në rrezik, PAK, të moshuar të vetmuar) vonohet, ndërhyrjet fragmentohen dhe rritet rreziku për nënraportim apo mosreferim të rasteve të dhunës dhe abuzimit. Në praktikë, mbështetja priret të mbetet parashoqërore, ndërsa ndjekja psiko-sociale e thelluar dhe planet individuale të shërbimit realizohen në mënyrë të paqëndrueshme.

Vendosja e një sistemi unik elektronik dhe e PSO-ve të unifikuara do ta bëjë planifikimin dhe buxhetimin më të targetuar, duke harmonizuar cilësinë ndërmjet njësive administrative dhe rritur kënaqësinë e qytetarëve. Në të njëjtën linjë, standardizimi i PSO-ve të emergjencës dhe përcaktimi i qartë i pikave fokale për koordinim gjatë dhe pas orarit do të sigurojnë një reagim të njëtrajtshëm, të shpejtë dhe efektiv në çdo emergjencë natyrore, sociale apo shëndetësore.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Për të adresuar boshllëqet dhe për të garantuar standard, matshmëri dhe njëtrajtësi në territor, nevojat prioritare janë:

- ✓ Rishikim i rregullores për formalizimin e PMF dhe NJVRN si pozicione të dedikuara dhe qartësimin e dallimit me MKR (mekanizëm, jo strukturë).
- ✓ Emërim i një specialisti të monitorimit të cilësisë së shërbimeve shoqërore (indikatore, auditim i brendshëm, raportim periodik).
- ✓ Rivendosje e ngarkesës dhe flukseve të punës me përshkrime të qarta detyrash për sektorin dhe stafin e NjA (NJMF organizon PMF në territor).
- ✓ Hartim/miratim të PSO-ve dhe manuali unik i procedurave me formularë standardë.
- ✓ Zbatim i një sistemi unik elektronik për menaxhimin e rasteve me indikatorë vendorë dhe raportim periodik analitik.
- ✓ Gatishmëri e standardizuar për emergjenca natyrore/sociale/shëndetësore (PSO të emergjencës, pika fokale në NjA, shërbim 24/7, ushtrime provë).
- ✓ Program vjetor aftësimi dhe supervizimi profesional për PMF, NJMF, NJVRN, Koordinatorët e Dhunës/Barazisë Gjinore dhe stafin e NjA.
- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me OJF/ofrues rajonalë për profile të specializuara (psikolog, logoped, terapist zhvillimor).

Me rishikim të rregullores, formalizim rolesh, standardizim të PSO-ve dhe forcim të gatishmërisë për emergjenca, Bashkia Tepelenë mund të konsolidojë rrjetin e shërbimeve, të rrisë cilësinë dhe barazinë në mbulim dhe të përmirësojë llogaridhënien. Kjo është një rrugë konkrete dhe e realizueshme me riorganizim të matur, aftësim të qëndrueshëm dhe bashkëpunim aktiv me partnerët.

4. Përmbyllje e diagnozës së Planit Social Vendor në Bashkinë Tepelenë

5. Analiza SËOT

Analiza SËOT – Mundësia për Zbatimin e Planit Social 2025–2029 Bashkia Tepelenë

Pikat e Forta

- Shërbime shoqërore bazë në funksion prej 2 vitesh: shërbimi lëvizës për të moshuarit dhe qendra e profilizuar për fëmijët me AK.
- Rrjet administratorësh shoqërorë aktivë në NjA për identifikim dhe orientim rastesh.
- Gatishmëri institucionale për riorganizim dhe formalizim rolesh (PMF/NJVRN).
- Praktikë e konsoliduar bashkëpunimi me institucionet lokale dhe rajonale (shkolla, qendra shëndetësore, Policia; Shtëpia e të Moshuarve & Universiteti i Gjirokastrës).
- Kapacitet për të tërhequr fonde dhe për të hartuar projekte me donatorë; bashkia ka mbështetur financiarisht shërbimet shoqërore prej 2 vitesh.

Pikat e Dobëta

- Mungesë formalizimi të plotë të roleve kyçe (PMF dhe NJVRN) në rregullore/organikë.
- Sistem i paunifikuar i të dhënave dhe raportimit (mungon regjistër elektronik unik; “zero-reporting” jo i standardizuar).
- Mbulim i pabarabartë gjeografik dhe mungesë shërbimesh të specializuara (psikolog, logoped, terapi).
- Protokolle jo të unifikuara për menaxhimin e rasteve dhe referim ndërsektorial.
- Kapacitete financiare dhe operationale të kufizuara për ngritjen/shkallëzimin e shërbimeve.

Mundësitë

- Kuadri ligjor (Ligji nr. 121/2016) mundëson kontraktim të shërbimeve me OJF/privat.
- Grante qendrore dhe thirrje të donatorëve (p.sh., Fondi Social, UNDP) për shërbime komunitare.
- Kapitalizimi i bashkëpunimeve të suksesshme të mëparshme me donatorë (UNDP, Fondi Social).
- Shërbime të përbashkëta ndërbashkiake me Gjirokastrën (Shtëpia e të Moshuarve dhe Universiteti “Eqrem Çabej”): ekiye lëvizëse, praktika, trajnime, me kosto të ndarë.

- Digitalizim i thjeshtë: regjistër unik, standard “zero-reporting” dhe raporte tremujore për M&E.

Kërcënimet

- Tkurrja demografike dhe plakja e popullsisë rrisin kërkesën dhe ulin bazën fiskale.
- Varësia nga projektet dhe pasiguria e financimit të jashtëm.
- Stigma sociale dhe normalizimi i dhunës ulin raportimin dhe aksesin në shërbime.
- Distanca/infrastruktura e kufizuar që rrit koston e ofrimit të shërbimeve në NjA të largëta.
- Ndryshime në politikat dhe fondet qendrore që kufizojnë bashkëfinancimin.

IV. Vizioni, Misioni, Prioritetet Strategjike dhe Objektivat

Hartimi i Planit Social Vendor të Bashkisë Tepelenë është udhëhequr nga angazhimi për të ndërtuar një sistem mbrojtjeje sociale që i përgjigjet nevojave reale të komunitetit dhe që përputhet me parimet e përcaktuara në kuadrin kombëtar të politikave sociale. Vizioni, misioni dhe qëllimi strategjik i këtij plani pasqyrojnë drejtimin që bashkia synon të ndjekë në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të drejtë, që garanton akses, dinjitet dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët, veçanërisht për ata në situatë vulnerabël. Këto shtylla themelore përbëjnë boshtin orientues për përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave specifike, mbi të cilat është ndërtuar ndërhyrja afatmesme për periudhën 2025–2029.

Vizioni

Tepelena – një bashki që punon me përkushtim për të garantuar mbrojtje sociale, gjithëpërfshirje dhe mundësi të barabarta për çdo qytetar

Misioni

Bashkia Tepelenë angazhohet të ndërtojë një sistem social të integruar dhe gjithëpërfshirës që mbështet të gjithë qytetarët në nevojë, fuqizon kapacitetet e tyre për vetëpërmbytje, dhe siguron akses të barabartë në arsim, punësim, strehim dhe shërbime sociale, pa dallim gjinie, etnie apo orientimi.

Qëllimi:

Të zhvillohet dhe konsolidohet një rrjet shërbimesh sociale gjithëpërfshirëse dhe të integruara në Bashkinë Tepelenë. Ky rrjet do të garantojë mbështetje për grupet në

nevojë, do të rrisë pjesëmarrjen e tyre sociale dhe ekonomike dhe do të sigurojë akses të barabartë në mirëqenie dhe dinjitet për të gjithë qytetarët

Vizioni, misioni dhe qëllimi i Planit Social Vendor për Bashkinë Tepelenë përcaktojnë orientimin strategjik të institucionit drejt ndërtimit të një sistemi social gjithëpërfshirës, të drejtë dhe të qëndrueshëm, i cili garanton mbështetje për grupet në nevojë dhe fuqizon pjesëmarrjen e tyre sociale dhe ekonomike. Për të bërë të mundur konkretizimin e këtyre parimeve në veprime të matshme dhe të koordinuara, plani është strukturuar në tre prioritete kryesore që udhëheqin ndërhyrjet përgjatë gjithë periudhës së zbatimit 2025–2029:

Prioriteti 1:

Zhvillimi i shërbimeve sociale bazë dhe komunitare për grupet vulnerabël, me fokus te fëmijët me aftësi të kufizuara, të moshuarit, komuniteti egjiptian dhe familjet në nevojë, duke garantuar mbulim të barabartë dhe gjithëpërfshirës në të gjithë territorin e Bashkisë.

Objektivi 1: Zhvillimi dhe zgjerimi i shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse dhe të integruara për grupet vulnerabël

Masa 1: Krijimi dhe funksionalizimi i shërbimeve komunitare dhe në familje

Aktivitete:

- ✓ A 1.1 Ngritja e qendrës komunitare multifunktionale për familjet në nevojë, fëmijët, të moshuarit, PAK, komunitetin egjiptian etj.
- ✓ A 1.2 Ofrimi i shërbimeve në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara në zonat rurale.
- ✓ A 1.3 Përmirësimi i koordinimit të shërbimeve ekzistuese për të garantuar mbulim të plotë territorial

Masa 2: Rritja e aksesit të komunitetit egjiptian dhe grupeve të marginalizuara në shërbime sociale

Aktivitete

- ✓ A 2.1 Hartimi i programeve të dedikuara për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit egjiptian.
- ✓ A 2.2 Trajnimi i personelit për të ofruar shërbime të ndjeshme ndaj diversitetit kulturor.
- ✓ A 2.3 Bashkëpunimi me OJF-të për të adresuar nevojat specifike të komunitetit egjiptian dhe familjeve në nevojë.

Prioriteti 2:Rritja e përfshirjes ekonomike dhe sociale të grupeve vulnerabël përmes arsimit profesional, punësimit dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë, duke promovuar barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen aktive në jetën komunitare.

Objektivi 1: *Fuqizimi socio-ekonomik i grupeve vulnerabël përmes aksesit në formim profesional, punësim dhe përmirësimit të kushteve të jetesës, me përparësi për gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetin egjiptian*

Masa 1: Nxitja e formimit profesional dhe punësimit për grupet vulnerabël

Aktivitete:

- ✓ A 1.1 Bashkëpunimi me AKPA Gjirokastrë dhe Qendrën e Formimit Profesional Gjirokastrë për orientimin dhe përfshirjen e PAK, grave, të rinjve dhe komunitetit egjiptian në kurse profesionale.
- ✓ A 1.2 Krijimi i mekanizmave për identifikimin e nevojave të trajnimit të qytetarëve në nevojë dhe ndërlidhjen me ofertën e kurseve

Masa2: Mbështetja financiare për akses në formim profesional

Aktivitete:

- ✓ A 2.1 Mbulimi i kostos së transportit për PAK dhe kategori të tjera vulnerabël për të ndjekur kurset e formimit profesional në Gjirokastrë.
- ✓ A 2.2 Sigurimi i mbështetjes logjistike dhe administrative për të lehtësuar përfshirjen e përfituesve në programe.

Masa 3: Nxitja e përfshirjes sociale dhe barazisë gjinore

Aktivitete:

- ✓ A 3.1 Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për reduktimin e diskriminimit dhe për promovimin e barazisë gjinore
- ✓ A 3.2 Përfshirja e grave dhe të rinjve në vendimmarrjen lokale për politikat sociale

Prioriteti 3:Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i sistemit të informacionit, monitorimit dhe ndërgjegjësimit, për të garantuar ofrimin cilësor dhe të qëndrueshëm të shërbimeve sociale në bashkëpunim me komunitetin dhe aktorët lokalë.

Objektivi 1: *Përmirësimi i cilësisë dhe aksesit në shërbimet sociale përmes forcimit të kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimit të komunitetit*

Masa 1: Rritja e kapaciteteve të stafit dhe strukturës vendore për shërbime sociale cilësore

Aktivitete

- ✓ A 1.1 Trajnimi i punonjësve të shërbimeve sociale mbi vlerësimin e nevojave, hartimin e planeve të ndërhyrjes dhe ndjekjen e rasteve
- ✓ A 1.2 Riorganizimi i sektorit të shërbimeve sociale për të siguruar mbulim më të mirë në territor dhe ndarje të qartë rolesh.

Masa 2: Forcimi i sistemit të informacionit dhe monitorimit të shërbimeve sociale

Aktivitete

- ✓ A 2.1 Ngritja e një databaze elektronike të rasteve sociale, të përditësueshme dhe të përdorshme nga stafi vendor.
- ✓ A 2.2 Hartimi i raporteve vjetore mbi situatën e grupeve vulnerabël dhe efektivitetin e ndërhyrjeve.
- ✓ A 2.3 Zhvillimi i një mekanizmi të rregullt për monitorimin periodik dhe rishikimin e Planit Social Vendor për të siguruar përputhjen me nevojat e reja dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.

Masa 3: Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit për mbrojtje sociale dhe përfshirje

Aktivitete

- ✓ A 3.1 Organizimi i fushatave informuese në komunitet për të rritur njohjen mbi të drejtat sociale dhe shërbimet ekzistuese.
- ✓ A 3.2 Fushata për reduktimin e stigmës ndaj PAK, komunitetit egjiptian dhe personave në nevojë për mbështetje sociale.
- ✓ A 3.3 Përdorimi i shkollave, qendrave shëndetësore, njësive administrative dhe rrjeteve sociale për përhapjen e mesazheve ndërgjegjëse.

Masa 4: Nxitja e pjesëmarrjes së komunitetit dhe bashkëpunimit ndërsektorial

Aktivitete

- ✓ A 4.1 Bashkëpunimi me OJF-të, shkollat, shërbimet shëndetësore dhe institucionet e tjera për ndërhyrje të koordinuara.
- ✓ A 4.2 Zhvillimi i mekanizmave për konsultim dhe reagim nga qytetarët mbi cilësinë e shërbimeve sociale.

STRATEGJIA E ZBATIMIT

Planifikimi tre-fazor (2025–2029)

Zbatimi i masave prioritare të Planit Social Vendor 2025–2029 të Bashkisë Tepelenë do të zhvillohet në mënyrë të strukturuar dhe të fazuar, për të siguruar efikasitet, qëndrueshmëri dhe llogaridhënie publike. Plani zbatohet në tri faza, duke rritur gradualisht kapacitetet, shtrirjen e ndërhyrjeve dhe cilësinë e monitorimit. Kjo qasje garanton realizimin e objektivave dhe përgatitjen për ciklin pasues të planifikimit social.

Kalendari vjetor me aktivitetet kryesore:

Periodha	Veprimet / Aktivitetet Kryesore
Viti 1 (2025)	➤ Ngritja e strukturës monitoruese dhe hartimi i instrumenteve standard për ndjekjen e planit; emërimi i përgjegjës të NJVRN dhe formalizimi i roleve. ➤ Trajnimi i stafit për zbatim/raportim; vendosja e partneriteteve me aktorët lokalë dhe donatorët. ➤ Informim dhe ndërgjegjësim i komunitetit mbi planin dhe kanalet e referimit. ➤ Fillimi i masave me ndikim të shpejtë dhe kosto të ulët, të koduara në PBA/VKB sipas Matricës së Kostimit.
Viti 2 (2026)	➤ Thellimi i ndërhyrjeve në fushat prioritare dhe zgjerimi i mbulimit për kategori të ndryshme përfituesish. ➤ Zbatimi i projekteve sociale me financim të kombinuar (bashkia/partnerë). ➤ Monitorimi i ndërmjetëm dhe raport i progresit me të dhëna mbi rezultatet dhe buxhetin. ➤ Rishikimi i aktiviteteve dhe masave mbi bazën e të dhënave dhe feedback-ut të komunitetit.
Viti 3 (2027–2029)	➤ Finalizimi i aktiviteteve të mbetura dhe konsolidimi i ndërhyrjeve të suksesshme. ➤ Ngritja/funksionalizimi i shërbimeve të qëndrueshme në nivel vendor (p.sh. për të moshuarit, PAK 18+, parandalimi/menaxhimi i dhunës). ➤ Vlerësimi përfundimtar i planit dhe dokumentimi i rezultateve të arritura. ➤ Hartimi i rekomandimeve për ciklin e ri dhe konsultim publik me komunitetin dhe aktorët.

PLANI I VEPRIMIT

Prioriteti 1: Zhvillimi i shërbimeve sociale bazë dhe komunitare për grupet vulnerabël, me fokus te fëmijët me aftësi të kufizuara, të moshuarit, komuniteti egjiptian dhe familjet në nevojë, duke garantuar mbulim të barabartë dhe gjithëpërfshirës në të gjithë territorin e Bashkisë.							
Objektivat	Aktiviteti	Treguesit	Afati zbatimit		Buxheti dhe burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	
Masat			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/Sektori/Departamenti(U dheheqes)	Institucion kontribues (nese ka)
Objektivi 1: Zhvillimi dhe zgjerimi i shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse dhe të integruara për grupet vulnerabël							
Masa 1: Krijimi dhe funksionalizimi i shërbimeve komunitare dhe në familje	A 1.1 Ngritja e qendrës komunitare multifunksionale për familjet në nevojë, të moshuarit dhe PAK.	Qendra multifunksionale funksionale 70 përfituesve (fëmijë, PAK, të moshuar, familje)	2028	2029	21,000,000 ALL Donator i pambuluar	Drejtoria e kujdesit shoqëror dhe Drejtoria Financës	OJF

	A 1.2 Ofrimi i shërbimeve në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara në zonat rurale	Shërbimi i ngritur dhe funksional 50 të moshuar në nevojë dhe 20 PAK marrin shërbime në familje	2026	2029	15,000,000 ALL Bashkia me fondet e veta 10,000,000 ALL Donator	Drejtoria e kujdesit shoqëror dhe Drejtoria Financës	OJF
	A 1.3 Përmirësimi i koordinimit të shërbimeve ekzistuese për mbulim të plotë territorial.						
	A 1.3.1 Vijimësia e shërbimit të specializuar për fëmijët me AK	Qendra e shërbimit për fëmijët me AK funksionale , 39 fëmijë me AK marrin shërbime	2025	2029		Drejtoria e kujdesit shoqëror dhe Drejtoria Financës	OJF

	A 1.3.2 Vijimi e shërbimit lëvizës në familje për personat e moshuar në nevojë	Shërbimi lëvizës në familje për të moshuar funksional 79 të moshuar në nevojë marrin shërbime në familje	2025	2029	9,000,000 ALL Bashkia me fondet e saj	Drejtoria e kujdesit shoqëror dhe Drejtoria Financës	OJF
Masa 2: Rritja e aksesit të komunitetit egjiptian dhe grupeve të margjinalizu ara në shërbime sociale	A 2.1 Hartimi i programeve të dedikuara për përmirësimi n e kushteve të jetesës së komunitetit egjiptian.	Programi i miratuar 20% familjeve/individ ëve egjiptianë të mbështetur/vit	2026	2029	225,000 ALL Donator i pambulua r	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
	A 2.2 Trajnimi i personelit për shërbime të ndjeshme	3 moduleve të hartuara dhe miratuara	2026	2029	225,000 ALL Donator i pambulua r	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF

	ndaj diversitetit kulturor.	1 trajnim të zhvilluara/vit 15 punonjësve të trajnuar Rritje me 90% e njohurive pas trajnimit	2026	2029	90,000 ALL Donator i pambuluar	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
	A 2.3 Bashkëpunimi me OJF/të për adresimin e nevojave specifike të komunitetit egjiptian dhe familjeve në nevojë.	3 marrëveshjeve të bashkëpunimi 30 raste referimi të trajtuara për komunitetin egjiptian 2 iniciativave të përbashkëta/vit	2026	2029	90,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
	TOTALI				60,130,000		

Prioriteti 2: Rritja e përfshirjes ekonomike dhe sociale të grupeve vulnerabël përmes arsimit profesional, punësimit dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë, duke promovuar barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen aktive në jetën komunitare.							
Objektivat	Aktiviteti	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillim	Afati i mbarimit		Drejtoria/Spektori/Departamenti (Udheheqes)	Institucion kontrib

			it				ues (nese ka)
Objektivi 1: Fuqizimi socio-ekonomik i grupeve vulnerabël përmes aksesit në formim profesional, punësim dhe përmirësimin të kushteve të jetesës, me përparësi për gratë, të rinjtë, personat me AK dhe komunitetin egjiptian							
Masa 1: Nxitja e formimit profesio nal dhe punësimi t për grupet vulnerab ël	A 1.1 Bashkëpunimi me AKPA Gjirokastrë dhe Qendrën e Formimit Profesional Gjirokastrë për orientimin dhe përfshirjen e PAK, grave, të rinjve dhe komunitetit egjiptian në kurse profesionale .	1 marrëveshje me AKPA/QFP 20 persona të përfshirë në kurse/vit	2026	2029	30,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF

	A 1.2 Krijimi i mekanizmave për identifikimin e nevojave të trajnimit dhe ndërlidhjen me ofertën e kurseve.	Instrumenti i vlerësimit të nevojave i miratuar Nr. profileve të trajnimit të përcaktuara Nr. rekomandimeve të adresuara nga ofruesit e kurseve	2027	2028	210,000 ALL donator i pambuluar	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
Masa 2: Mbështetja financiare për akses në formim profesional	A 2.1 Mbulimi i kostos së transportit për PAK dhe kategori të tjera vulnerabël për të ndjekur kurset e formimit profesional në Gjirokastrë.	12 përfitues/vit mbeshteten	2026	2029	648,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror + drejtoria Financës	OJF

	A 2.2 Sigurimi i mbështetjes logjistike dhe administrati ve për përfshirjen e përfituesve në programe.	Mbi 90 persona në vit të asistuar administrativisht	2026	2029	576,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
Masa 3: Nxitja e përfshirjes sociale dhe barazisë gjinore	A 3.1 Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për reduktimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë gjinore.	2 fushata/vit 50 pjesëmarrës/fushatë 3 kanaleve të komunikimit të përdorura	2026	2029	480,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
	A 3.2 Përfshirja e grave dhe të rinjve në vendimmarrjen lokale për politikën sociale.	3 forumeve/vit 15 pjesëmarrës/forumi 1 rekomandim në vit i marra në konsideratë nga Këshilli Bashkiak	2026	2029	360,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF

	Total				2,304,000		

Prioriteti 3: Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i sistemit të informacionit, monitorimit dhe ndërgjegjësimit, për të garantuar ofrimin cilësor dhe të qëndrueshëm të shërbimeve sociale në bashkëpunim me komunitetin dhe aktorët lokalë..

Objektivat	Aktiviteti	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afat i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/Spektori/Departamenti (Udhëheqes)	Institucion kontribues (nese ka)
Objektivi 1: Përmirësimi i cilësisë dhe aksesit në shërbimet sociale përmes forcimit të kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimit të komunitetit							
Masa 1: Rritja e kapaciteteve të stafit dhe strukturës vendore për shërbime sociale cilësore	A 1.1 Trajnimi i punonjësve të shërbimeve sociale mbi vlerësimin e nevojave, planet e ndërhyrjes dhe ndjekjen e rasteve.	3 module trajnimit të hartuara	2026	2029	450,000 ALL Donator i pambuluar	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
		3 trajnime të realizuara 15 punonjës të trajnuar/vit Rritja mesatare e njohurive pas trajnimit (me 60%)	2026	2029	90,000 ALL donator i pambuluar	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF

	A 1.2 Riorganizimi i sektorit të shërbimeve sociale për mbulim më të mirë territorial dhe ndarje të qartë rolesh.	Organograma e rishikuar e miratuar 100% e NjA-ve me pika fokale funksionale	2025	2026	45,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
		Emërimi i përgjegjës të NJVRN	2028	2029	2,880,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
		Rishikimi i rregullores së sektorit dhe miratimi i saj	2026	2026	45,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
		Manual/protokolle të roleve dhe flukseve	2026	2027	750,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
Masa 2: Forcimi i sistemit të informacionit dhe monitorimit	A 2.1 Ngritja e një databaze elektronike të rasteve sociale, të përditësueshme dhe të	Databaza funksionale	2026	2027	150,000 ALL Donator i pambuluar	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF

të shërbimeve sociale	përdorshme nga stafi vendor.	Modul i hartuar për përdorimin e databazës 1 trajnim i realizuar	2027	2027	75,000 ALL Donator i pambuluar	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
	A 2.2 Hartimi i raporteve vjetore mbi situatën e grupeve vulnerabël dhe efektivitetin e ndërhyrjeve.	1 raport vjetore publikuara/vit Afati i publikimit (deri në prill të vitit pasardhës) 1 rekomandim i adresuara nga raportet	2027	2029	Pa kosto nga fondet e bashkise	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
	A 2.3 Zhvillimi i mekanizmit të monitorimit periodik dhe rishikimit të Planit Social Vendor.	2 mbledhje të monitorimit/vit Mbi 80% e detyrave të realizuara sipas planit Nr rishikimeve/raporteve të progresit	2026	2029	Pa kosto nga fondet e bashkise	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
Masa 3: Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësi mit për mbrojtje sociale dhe përfshirje	A 3.1 Organizimi i fushatave informuese për të rritur njohjen mbi të drejtat sociale dhe shërbimet ekzistuese.	2 fushata/vit 50 pjesëmarrës/fushatë Shtrirja e komunikimit (p.sh., numri i kanaleve/postaimeve)	2026	2029	480,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF

	A 3.2 Fushata për reduktimin e stigmës ndaj PAK, komunitetit egjiptian dhe personave në nevojë për mbështetje sociale.	3 fushata/vit 50 pjesëmarrës/fushatë Shtrirja e komunikimit (p.sh., numri i kanaleve/postaimeve)	2026	2029	720,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
	A 3.3 Përdorimi i shkollave, qendrave shëndetësore, njësive administrative dhe rrjeteve sociale për përhapjen e mesazheve.	Të paktën 5 institucione të përfshira	2025	2029	Pa kosto nga fondet e bashkise	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
		1000 materialeve të prodhuara/shpërndara ne vit per 4 vite	2026	2029	120,000 ALL Donator i pambuluar	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
Masa 4: Nxitja e pjesëmarrjes së komunitetit dhe bashkëpunimit ndërsektorial	A 4.1 Bashkëpunimi me OJF-të, shkollat, shërbimet shëndetësore dhe institucionet e tjera për ndërhyrje të koordinuara.	4 marrëveshje të bashkëpunimit 2 iniciativa të përbashkëta/vit 2 referime ndër-institucionale	2025	2029	Pa kosto nga fondet e bashkise	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF

	A4.2 Zhvillimi i mekanizmave për konsultim dhe reagim nga qytetarët mbi cilësinë e shërbimeve sociale.	3 tryeza/forume/vit 50 pjesëmarrës/tryezë 70 % e rekomandime të marra në konsideratë nga institucioni	2026	2029	720,000 ALL Bashkia me fondet e veta	Drejtoria e kujdesit shoqëror	OJF
	Totali				6,525,000		

VI. Finalizimi i Planit Social Vendor

Ky kapitull përmbledh metodologjinë e hartimit, gjetjet kyçe të diagnozës territoriale, boshtet strategjike dhe mënyrën e zbatimit përmes fletëve të veprimit, si dhe përafrimin financiar me PBA-në 2025–2029.

1) Metodologjia e hartimit

Procesi u udhëhoq nga Komiteti Drejtues, ndërsa u realizua nga Komiteti Teknik me përfaqësim ndërsektorial. U analizuan të dhënat administrative dhe dokumentet orientuese të bashkisë; u zhvilluan intervista të strukturuar me aktorët institucionalë; si dhe takime me përfitues dhe jopërfitues të shërbimeve për të kuptuar përvojat dhe pengesat reale në akses. Në fund, u organizua një seminar konsultativ ku u verifikuan gjetjet dhe u dakordësuan masat që kalojnë në planin e veprimit 2025–2029. Masat u përkthyen në fletë veprimi me objektiva, afate dhe përgjegjësi të qarta, ndërsa kostot orientuese u përafruan me ciklin buxhetor dhe PBA-në.

2) Prezantimi i diagnozës territoriale

Diagnoza fokusohet te familjet në nevojë, PAK, fëmijët, të moshuarit, viktimat e dhunës, komunitetin egjiptian, përdorues të drogës dhe alkoolit, si dhe personat LGBTIQ+. Bashkia ofron shërbime bazë në zgjerim, por kapacitetet njerëzore/financiare janë të kufizuara, rolet/procedurat kërkojnë qartësim, dhe mbulimi rural mbetet sfidë. Ka potencial për bashkëpunim me shkollat, qendrat shëndetësore dhe qendrat komunitare për identifikim të hershëm, referim të standardizuar dhe mbështetje të qëndrueshme; nevojitet forcim i shërbimeve të profilizuara për fëmijët me AK dhe i shërbimeve në familje për të moshuarit, si dhe rritje e aksesit të komunitetit egjiptian ndaj shërbimeve.

3) Strategjia dhe ndërhyrjet

Tre prioritetet e mëposhtme konkretizojnë drejtimet strategjike të planit në masa, afate dhe përgjegjësi të qarta.

Prioriteti 1 – Shërbime bazë & komunitare. Konsolidon dhe zgjeron shërbimet komunitare dhe në familje, forcon shërbimin e profilizuar për fëmijët me AK dhe shtrinë mbulimin në NjA, me lidhje të forta me shkollat e qendrat shëndetësore; synon rritjen e aksesit për të moshuarit, PAK, komunitetin egjiptian dhe familjet në nevojë.

Prioriteti 2 – Fuqizim socio-ekonomik. Lehtëson përfshirjen në formimin profesional (në bashkëpunim me AKPA/QFP), mbështet transportin/logjistikën për ndjekjen e kurseve, krijon mekanizma për identifikimin e nevojave të trajnimit dhe zhvillon fushata ndërgjegjësimi kundër diskriminimit, duke nxitur pjesëmarrjen e grave dhe të rinjve.

Prioriteti 3 – Qeverisje & kapacitete. Ristrukturon dhe qartëson rolet e sektorit social, vendos databazë elektronike dhe protokolle të shkëmbimit të të dhënave, standardizon monitorimin/raportimin vjetor dhe forcon marrëveshjet ndërsektoriale e mekanizmat e referimit, së bashku me trajnim sistematik të stafit.

4) Fletët e veprimit, përgjegjësitë dhe përafrimi financiar

Zbatimi bëhet përmes fletëve të veprimit të unifikuara që përshkruajnë objektivat, aktivitetet me afate, indikatorët dhe burimet e të dhënave, institucionet përgjegjëse/partnerët, buxhetin orientues dhe menaxhimin e rrezikut. Fletët kodifikohen sipas skemës FV–[Prioriteti].[Objektivi].[Nr. fletës] dhe përdoren si bazë për raportim e buxhetim. Drejtoria e Shërbimeve Sociale koordinon zbatimin/raportimin; Drejtoria e Financave dhe Buxhetit përafron me PBA dhe verifikon burimet; Sekretaria e Këshillit Bashkiak siguron miratimin/arkivimin; Zyra e Komunikimit/IT publikon dhe garanton transparencën. Konsultimi publik zgjat të paktën dy javë para miratimit. Raporti gjashtëmuor publikohet në korrik dhe raporti vjetor në janar.

Përafrimi financiar orientues sipas prioritetëve (Lek):

Prioriteti	Totali	Bashkia	Donatorë
Prioriteti 1	60,130,000	37,590,000	22,540,000
Prioriteti 2	2,304,000	2,094,000	210,000
Prioriteti 3	6,525,000	4,890,000	1,635,000
Totali	68,959,000	44,574,000	24,385,000

Kostot e detajuara dhe ndarja vjetore pasqyrohen në Kreun V, në harmoni me PBA-në. Mbledhja dhe raportimi i të dhënave respektojnë mbrojtjen e të dhënave personale; burimet e indikatorëve përfshijnë regjistrin e rasteve, INSTAT dhe raportet e qendrave komunitare/partnerëve.

5) Miratimi, publikimi dhe hyrja në fuqi

- Konsolidimi teknik i tekstit dhe i fletëve të veprimit.
- Përfundimi i kostimit dhe ndarja vjetore e buxhetit (2025–2029).
- Konsultimi publik final dhe përfshirja e komenteve.
- Përgatitja e relacionit dhe projekt-VKB-së për Këshillin Bashkiak; miratimi.
- Publikimi i planit dhe i fletëve në faqen zyrtare të Bashkisë; komunikim publik.
- Hyrja në fuqi pas miratimit të VKB-së dhe publikimit.

VII. Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi dhe vlerësimi përbëjnë një komponent thelbësor për zbatimin efektiv të Planit të Veprimit Social të Bashkisë Tepelenë, duke garantuar ndjekje të vazhdueshme të progresit dhe përmirësim të ndërhyrjeve në kohë reale. Qëllimi kryesor është të sigurojë transparencë, llogaridhënie dhe përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve për grupet vulnerabël.

Struktura përgjegjëse për monitorimin

Drejtoria e Shërbimeve Sociale (DSS) në Bashkinë Tepelenë është përgjegjëse për koordinimin e procesit. Brenda saj emërohet një koordinator M&V dhe ngrihet një grup i dedikuar, i përbërë nga specialistë të sektorit dhe përfaqësues të njësive administrative, që sigurojnë mbledhjen e të dhënave, ndjekjen e treguesve dhe përgatitjen e raporteve përkatëse. Drejtoria e Financave lidh gjetjet me PBA-në; IT/Komunikimi mbështet regjistrin/dashbordet dhe transparencën publike.

Mjetet dhe format e monitorimit

Procesi bazohet në formularë standardë raportimi dhe regjistër elektronik për përditësime të rregullta; kombinohen të dhëna sasiore dhe cilësore dhe zhvillohen takime periodike me aktorë lokalë e përfitues, për të kapur progresin, pengesat dhe sugjerimet praktike. Respektohen parimet bazë të cilësisë së të dhënave (saktësi, plotësi, afati, gjurmueshmëri) dhe mbrojtjes së privatësisë.

Raportimi dhe kalendar

Raportimi i të dhënave realizohet mujore nga njësiti përgjegjëse, ndërsa tremujore zhvillohen sesione të brendshme shqyrtimi me DSS, njësiti administrative dhe Financat. Raporti gjashtëmujor (korrik) përmbledh ecurinë sipas prioritetëve/objektivave, dhe raporti vjetor (janar i vitit pasardhës) paraqet rezultatet, sfidat dhe masat për përmirësim. Ky kalendar siguron ndjekje të qëndrueshme gjatë gjithë periudhës së planit 2025–2029.

Vlerësimi i planit

Kryerja e vlerësimit bëhet në fund të çdo viti dhe në mbyllje të planit (fund 2029), për të analizuar efektivitetin e masave, ndikimin social dhe përdorimin e burimeve. Për rritjen e objektivitetit, Bashkia mund të përfshijë partnerë të jashtëm (OJF ose institucione të pavarura) në vlerësimet periodike/përfundimtare.

Mekanizmat për rishikim dhe përmirësim

Bazuar në gjetjet e monitorimit dhe vlerësimit, Bashkia Tepelenë rishikon aktivitetet, përditëson planin e zbatimit dhe, kur nevojitet, shton masa të reja në përputhje me nevojat

e komunitetit dhe zhvillimet sociale. Ndryshimet miratohen me vendime institucionale dhe publikohen në kanalet zyrtare, duke garantuar përfshirje të aktorëve lokalë dhe transparencë të plotë të procesit.

VIII Shtojca

Shtojca 1 Kuadri legjislativ

Plani Social Vendor hartohet në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Konventën për të Drejtat e Njeriut;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar);
- Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale;
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSh);
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- CEDAË

Dokumentet strategjike:

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi;
- ✓ Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar;
- ✓ Dokumenti Politik – Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore;
- ✓ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale.

Korniza e përgjithshme ligjore, mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (FZ 20-1996).

Dokumente vendore:

- Strategjia Territoriale Bashkia Tepelenë;

- Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Tepelenë.

Shtojca 2 Persona burimorë dhe profesionistë lokale për mbrojtjen sociale në nivel bashkie dhe njësis administrative

Grafiku paraqet rrjetin e aktorëve institucionalë dhe komunitarë që mbështesin kategoritë në nevojë në nivel lagje/fshat, bashkie dhe qarku. Ai shërben si mjet orientues për profesionistët e shërbimeve sociale, duke i ndihmuar të përdorin në mënyrë efektive burimet ekzistuese për parandalimin, referimin dhe mbështetjen e rasteve vulnerabël.

Rrathëtkoncentrikë përfaqësojnë nivelet e ndërhyrjes: i) Rrethi i brendshëm: niveli lokal/komunitar; ii) Rrethi i mesëm: niveli bashkiak; iii) Rrethi i jashtëm: niveli rajonal dhe kombëtar. **Ngjyrat** tregojnë institucionet dhe aktorët komunitarë përkatës, të cilët janë të pranishëm në nivele të ndryshme. Aktorët me të njëjtën ngjyrë përfaqësojnë të njëjtin institucion apo funksion në formatin e tij lokal, bashkiak dhe rajonal.

Shtojca 3 Fletët e Veprimit

Fleta e Veprimit Nr 1

Elementi	Përshkrimi
Titulli i Prioritetit	Prioriteti 1: Zhvillimi i shërbimeve sociale bazë dhe komunitare për grupet vulnerabël, me fokus te fëmijët me aftësi të kufizuara, të moshuarit, komuniteti egjiptian dhe familjet në nevojë, duke garantuar mbulim të barabartë dhe gjithëpërfshirës në të gjithë territorin e Bashkisë.
Titulli i Objektivit Specifik	Objektivi 1: Zhvillimi dhe zgjerimi i shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse dhe të integruara për grupet vulnerabël
Titulli i Fletës së Veprimit	Shërbimet bazë & komunitare — Fleta e Veprimit e Objektivit 1
Elementët Diagnostikues	• Mbulim i pjesshëm i shërbimeve komunitare dhe në familje, sidomos në zonat rurale. • Nevoja për konsolidimin e shërbimit të specializuar për fëmijët me AK dhe shërbimit lëvizës për të moshuar. • Akses i kufizuar i komunitetit egjiptian dhe grupeve të marginalizuara në shërbime. • Koordinim i fragmentuar ndërmjet ofruesve; mungesë mbulimi të plotë territorial në NJA/
Kuadri Rregullator	• Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”. • Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. • Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. • Ligji nr. 9669/2006, i ndryshuar, “Për masat ndaj dhunës

	në marrëdhëniet familjare”. • Ligji nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”. • Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. • VKM për standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe procedurat e licencimit/financimit. • Udhëzimet e MSHMS për vlerësimin bio-psiko-social, referimin, monitorimin dhe raportimin e shërbimeve. • Udhëzime për Mekanizmin të Referimit dhe bashkëpunimin ndërsektorial.
Masat per Objektivin	➤ Masa 1: Krijimi dhe funksionalizimi i shërbimeve komunitare dhe në familje ➤ Masa 2: Rritja e aksesit të komunitetit egjiptian dhe grupeve të marginalizuara në shërbime sociale
Koordinatori Përgjegjës	Spektori i kujdesit shoqëror dhe Drejtoria Financës; Spektori i kujdesit shoqëror
Partnerë të Përshirë	OJF
.Afati i Zbatimit për çdo aktivitet	A 1.1: Ngritja e qendrës komunitare multifunksionale për familjet në nevojë, fëmijët, të moshuarit dhe PAK. (2028–2029) A 1.2: Ofrimi i shërbimeve në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara në zonat rurale (2026–2029) A 1.3: Përmirësimi i koordinimit të shërbimeve ekzistuese për mbulim të plotë territorial. ✚ A 1.3.1: Vijimësia e shërbimit të specializuar për fëmijët me AK (2025–2029) ✚ A 1.3.2: Vijimi e shërbimit lëvizës në familje për personat e moshuar në nevojë (2025–2029) A 2.1: Hartimi i programeve të dedikuara për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit egjiptian. (2026–2029) A 2.2: Trajnimi i personelit për shërbime të ndjeshme ndaj diversitetit kulturor. (2026–2029) A 2.3: Bashkëpunimi me OJF/të për adresimin e nevojave specifike të komunitetit egjiptian dhe familjeve në nevojë. (2026–2029)
Rezultatet Pritshme	Qendra multifunksionale funksionale 70 përfitues (fëmijë, PAK, të moshuar, familje) Shërbimi lëvizës në familje i ngritur dhe funksional 50 të moshuar në nevojë dhe 20 PAK marrin shërbime në familje Qendra e shërbimit për fëmijët me AK funksionale , 39 fëmijë me AK marrin shërbime Shërbimi lëvizës në familje për të moshuar funksional, 79 të moshuar në nevojë marrin shërbime në familje

	Programi i miratuar 20% familjeve/individëve egjiptianë të mbështetur/vit 1 trajnim të zhvilluara/vit 15 punonjës të trajnuar Rritje me 90% e njohurive pas trajnimit 3 marrëveshjeve të bashkëpunimi 30 raste referimi të trajtuara për komunitetin egjiptian iniciativave të përbashkëta/vit	2
Buxheti Total dhe Plani i Financimit	Kosto Totale: 60 130 000 ALL Ndarja e financimit: Bashkia 37 590 000 ALL; Qeveria & Donatorë 22 540 000 ALL Sipas viteve: 2025=2 500 000 2026=12 210 000 2027=15 210 000 2028=15 030 000 2029=15 180 000	

Fleta e Veprimit Nr 2

Elementi	Përshkrimi
Titulli i Prioritetit	Prioriteti 2: Rritja e përfshirjes ekonomike dhe sociale të grupeve vulnerabël përmes arsimit profesional, punësimit dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë, duke promovuar barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen aktive në jetën komunitare.
Titulli i Objektivit Specifik	Objektivi 2: Fuqizimi socio-ekonomik i grupeve vulnerabël përmes aksesit në formim profesional, punësim dhe përmirësimit të kushteve të jetesës, me përparësi për gratë, të rinjtë, personat me AK dhe komunitetin egjiptian
Titulli i Fletës së Veprimit	Fuqizimi socio-ekonomik i grupeve në nevojë – Fleta e Veprimit e Objektivit 1
Elementët Diagnostikues	➤ Nevojë për rritjen e përfshirjes në formim profesional dhe punësim për gratë, të rinjtë, PAK dhe komunitetin egjiptian. ➤ Barriera ekonomike dhe logjistike (transporti, asistencë administrative) për akses në kurse profesionale. ➤ Nevoja për ndërgjegjësim dhe ulje të diskriminimit për barazi gjinore dhe pjesëmarrje komunitare.
Kuadri Rregullator	Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”; VKM për standardet e shërbimeve; kuadri për barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale; marrëveshje bashkëpunimi me AKPA/QFP.
Masat per Objektivin	➤ Masa 1: Nxitja e formimit profesional dhe punësimit për grupet vulnerabël ➤ Masa 2: Mbështetja financiare për akses në formim profesional

	➤ Masa 3: Nxitja e përfshirjes sociale dhe barazisë gjinore
Koordinatori Përgjegjës	Spektori i kujdesit shoqëror; Drejtoria e Financës
Partnerë të Përshtirë	OJF
Afati i Zbatimit për çdo aktivitet	A 1.1: Bashkëpunimi me AKPA Gjirrokastër dhe Qendrën e Formimit Profesional Gjirrokastër për orientimin dhe përfshirjen e PAK, grave, të rinjve dhe komunitetit egjiptian në kurse profesionale. (2026–2029) A 1.2: Krijimi i mekanizmave për identifikimin e nevojave të trajnimit dhe ndërlihdjen me ofertën e kurseve. (2027–2028) A 2.1: Mbulimi i kostos së transportit për PAK dhe kategori të tjera vulnerabël për të ndjekur kurset e formimit profesional në Gjirrokastër. (2026–2029) A 2.2: Sigurimi i mbështetjes logjistike dhe administrative për përfshirjen e përfituesve në programe. (2026–2029) A 3.1: Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për reduktimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë gjinore. (2026–2029) A 3.2: Përfshirja e grave dhe të rinjve në vendimarrjen lokale për politikën sociale. (2026–2029)
Rezultatet Pritshme	1 marrëveshje me AKPA/QFP 20 personave të përfshirë në kurse/vit Instrumenti i vlerësimit të nevojave i miratuar Nr. profileve të trajnimit të përcaktuara Nr. rekomandimeve të adresuara nga ofruesit e kurseve 12 përfitues/vit mbeshteten Mbi 90 persona në vit të asistuar administrativisht 2 fushata/vit 50 pjesëmarrës/fushatë 3 kanaleve të komunikimit të përdorura 3 forume/vit 15 pjesëmarrës/forumi 1 rekomandim në vit i marrë në konsideratë nga Këshilli Bashkiak
Buxheti Total dhe Plani i Financimit	Kosto Totale: 2 304 000 ALL Ndarja e financimit: Bashkia 2 094 000 ALL; Qeveria & Donatorë 210 000 ALL Sipas viteve: 2025=0 2026=546 000 2027=726 000 2028=516 000 2029=516 000

Fleta e Veprimit Nr 3


Elementi	Përshkrimi
Titulli i Prioritetit	Prioriteti 3: Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i sistemit të informacionit, monitorimit dhe ndërgjegjësimit, për të garantuar ofrimin cilësor dhe të qëndrueshëm të shërbimeve sociale në bashkëpunim me komunitetin dhe aktorët lokalë..
Titulli i Objektivit Specifik	Objektivi 1: Përmirësimi i cilësisë dhe aksesit në shërbimet sociale përmes forcimit të kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimit të komunitetit
Titulli i Fletës së Veprimit	Forcimi i kapaciteteve & qeverisjes — Fleta e Veprimit e Objektivit 1
Elementët Diagnostikues	• Kapacitete të pamjaftueshme të stafit; procedura jo të unifikuar. • Role/organigramë e paqartë (sektor social, pika fokale në NjA). • Mungesë databaze elektronike funksionale dhe protokollesh të të dhënave. • Monitorim/raportim vjetor i pjesshëm për grupet vulnerabël dhe ndërhyrjet. • Nevojë për informim publik ; stigmë ndaj grupeve në nevojë. • Pjesëmarrje e ulët komunitare. • Bashkëpunim ndërsektorial i pjesshëm; mungesë marrëveshjesh/referimesh standard. • Burime financiare/teknike të pamjaftueshme.
Kuadri Rregullator	• Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”. • Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. • Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. • Ligji nr. 9669/2006, i ndryshuar, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. • Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. • VKM për standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe procedurat e licencimit/financimit. • Udhëzimet e MSHMS
Masat për Objektivin	➤ M 1: Rritja e kapaciteteve të stafit dhe strukturës vendore për shërbime sociale cilësore ➤ M 2: Forcimi i sistemit të informacionit dhe

	monitorimit të shërbimeve sociale. ➤ M 3: Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit për mbrojtje sociale dhe përfshirje. ➤ M 4: Nxitja e pjesëmarrjes së komunitetit dhe bashkëpunimit ndërsektorial
Koordinatori Përgjegjës	Drejtoria e kujdesit shoqëror
Partnerë të Përshirë	OJF
Afati i Zbatimit për çdo aktivitet	A 1.1: Trajnimi i punonjësve të shërbimeve sociale mbi vlerësimin e nevojave, planet e ndërhyrjes dhe ndjekjen e rasteve. (2026–2029) A 1.2: Riorganizimi i sektorit të shërbimeve sociale për mbulim më të mirë territorial dhe ndarje të qartë rolesh. (2025–2026) A 2.1: Ngritja e një databaze elektronike të rasteve sociale, të përditësueshme dhe të përdorshme nga stafi vendor. (2026–2027) A 2.2: Hartimi i raporteve vjetore mbi situatën e grupeve vulnerabël dhe efektivitetin e ndërhyrjeve. (2027–2029) A 2.3: Zhvillimi i mekanizmit të monitorimit periodik dhe rishikimit të Planit Social Vendor. (2026–2029) A 3.1: Organizimi i fushatave informuese për të rritur njohjen mbi të drejtat sociale dhe shërbimet ekzistuese. (2026–2029) A 3.2: Fushata për reduktimin e stigmës ndaj PAK, komunitetit egjiptian dhe personave në nevojë për mbështetje sociale. (2026–2029) A 3.3: Përdorimi i shkollave, qendrave shëndetësore, njësive administrative dhe rrjeteve sociale për përhapjen e mesazheve. (2025–2029) A 4.1: Bashkëpunimi me OJF-të, shkollat, shërbimet shëndetësore dhe institucionet e tjera për ndërhyrje të koordinuara. (2025–2029) A 4.2: Zhvillimi i mekanizmave për konsultim dhe reagim nga qytetarët mbi cilësinë e shërbimeve sociale. (2026–2029)
Rezultatet e Pritshme	3 module trajnimit të hartuara 3 trajnime të realizuara 15 punonjës të trajnuar/vit Rritja mesatare e njohurive pas trajnimit (me 60%) Organograma e rishikuar e miratuar 100% e NjA-ve me pika fokale funksionale


	Databaza funksionale 1 raport vjetore publikuara/vit Afati i publikimit (deri në prill të vitit pasardhës) 1 rekomandim i adresuara nga raportet 2 mbledhjeve të monitorimit/vit Mbi 80% e detyrave të realizuara sipas planit Nr rishikimeve/raporteve të progresit 2 fushata/vit 50 pjesëmarrës /fushatë Shtrirja e komunikimit (p.sh., numri i kanaleve/postaimeve) 3 fushata/vit 50 pjesëmarrës/fushatë Shtrirja e komunikimit (p.sh., numri i kanaleve/postaimeve) Të paktën 5 institucione të përfshira 4 marrëveshjeve të bashkëpunimit 2 iniciativave të përbashkëta/vit 2 referimeve ndër-institucionale 3 tryeza/forume/vit 50 pjesëmarrës/tryezë 70 % e rekomandimeve të marra në konsideratë nga institucioni
Buxheti Total dhe Plani i Financimit	Kosto Totale: 6 525 000 ALL Ndarja e financimit: Bashkia 4 890 000 ALL; Qeveria & Donatorë 1 635 000 ALL Sipas viteve: 2025=0 2026=780 000 2027=1 215 000 2028=2 430 000 2029=2 100 000



Shtojca 4 Figurat

Figura 1



Burimi: Bashkia Tepelene





IX ANEKSE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

KESHILLI

Nr. 1480/Prot

3

Tepelene me 20.08.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. Datë __. __. 2025

PËR

MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDOR DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2025–2029
BASHKIA TEPELENE

Këshilli i Bashkisë Tepelenë pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Sportit dhe Sherbimit Social , bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma “b”, nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma “k”, neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe aktet nënligjore, si dhe me Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës __. __. 2025.

V E N D O S I

1. Të miratojë Planin Social Vendor dhe Planin e Veprimit 2025–2029 të Bashkisë Tepelenë , bashkëngjitur këtij dokumenti.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit dhe Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike e Finacës dhe Buxhetit .
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARË NE DETYRË E BASHKISË TEPELENË

Julinda Kartori



KRYETARI

Arben Gumeni



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENE
DREJTORIA E ARSIMIT SPORTIT DHE KUJDESIT SOCIAL

RELACION

Për miratimin e Planit Social Vendor dhe Planit të Veprimit 2025–2029
Bashkia Tepelene

1. Qëllimi i relacionit

Ky relacion paraqet, për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak, paketën e Planit Social Vendor (PSV) dhe Planit të Veprimit 2025–2029 të Bashkisë Tepelene . Dokumenti përmbledh bazën ligjore, procesin e hartimit, gjetjet kryesore diagnostikuese, prioritetet strategjike, kornizën e zbatimit dhe miratimit, si dhe përputhjen me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA).

2. Baza ligjore dhe përputhja strategjike

PSV 2025–2028 hartohet në përputhje me Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe aktet nënligjore, si dhe me Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale. Dokumenti përafrohet me PBA-në dhe programimin vjetor të buxhetit të Bashkisë.

3. Përmbledhje e metodologjisë

Procesi u udhëhoq nga Komiteti Drejtues dhe u realizua nga Komiteti Teknik me përfaqësim ndërsektorial. U përdorën të dhëna administrative dhe statistika vendore/kombëtare; u zhvilluan intervista të strukturuar me aktorët institucionalë dhe takime me përfitues e jopërfitues të shërbimeve; u organizua një seminar konsultativ për verifikimin e gjetjeve dhe dakordësimin e masave. Masat u përkthyen në Fletë Veprimi me objektiva, afate, indikatorë dhe përgjegjësi të qarta.

4. Diagnoza – përmbledhje e gjetjeve kyçe

Grupet prioritare: familjet në nevojë; personat me aftësi të kufizuara (PAK); fëmijët; të moshuarit; viktimat e dhunës në familje, personat përdorues të drogës dhe alkoolit, personat LGBTIQ+:

- Akses i pabarabartë në shërbime në njësitë periferike; vonesa në identifikim dhe ndërhyrje; nevojë për standardizim të procedurave të menaxhimit të rasteve.
- Kapacitete njerëzore dhe financiare të kufizuara; mungesë shërbimesh komunitare të strukturuar (qendra ditore, shërbim i lëvizshëm me mbulim të plotë).
- Nevojë për koordinim më të fortë ndërsektorial (shëndetësi–arsim–shërbime sociale) dhe gjurmim sistematik të indikatorëve.

5. Strategjia dhe prioritetet 2025–2029

Prioriteti 1 – Fuqizimi i kapaciteteve organizative dhe profesionale

Ngritja/shtimi i strukturës dhe emërimi i Njësish së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN); përditësimi i roleve/procedurave; standardizim i menaxhimit të rasteve; trajnime periodike.

Prioriteti 2 – Zgjerimi dhe balancimi i shërbimeve në territor

Funksionalizim i qendrave komunitare si pika referimi; shërbim i lëvizshëm për zonat e largëta; integrim me arsimin dhe shëndetësinë për identifikim të hershëm dhe mbështetje të vazhdueshme.

Prioriteti 3 – Ndërgjegjësim dhe fuqizim i grupeve në nevojë

Fushata informuese, aktivitete komunitare dhe programe mbështetëse për fëmijë, të rinj dhe familje.

6. Fletët e Veprimit dhe përgjegjësitë

Zbatimi realizohet përmes Fletëve të Veprimit të standardizuara që përshkruajnë objektivat, aktivitetet me afate, indikatorët dhe burimet e të dhënave, përgjegjësit/partnerët, buxhetin orientues dhe menaxhimin e rrezikut. Fletët kodifikohen sipas skemës FV–[Prioriteti].[Objekti]. [Nr.], e cila përdoret në raportim dhe buxhetim.

Koordinimi: Drejtoria e Shërbimeve Sociale (zbatim/raportim); Drejtoria e Financave dhe Buxhetit (përafrimi me PBA, verifikimi i burimeve); Sekretaria e Këshillit Bashkiak (miratim/arkivim); Zyra e Komunikimit/IT (publikim/transparencë).

7. Korniza financiare orientuese (2025–2029)

Përputhja me PBA realizohet duke konsoliduar kostot orientuese të fletëve dhe planifikimin vjetor të tyre. Përmbledhja sipas prioritetëve:

Prioriteti	Totali (Lek)	Bashkia (Lek)	Donatorë (Lek)
Prioriteti 1	5,348,600	4,048,600	1,300,000
Prioriteti 2	57,464,480	24,674,480	32,790,000
Prioriteti 3	3,417,000	3,177,000	240,000

Totali: 66,230,080 Lek (Bashkia: 31,900,080 Lek; Donatorë: 34,330,000 Lek).

8. Monitorimi, raportimi dhe rishikimi

Ecuriamatetmbitreguesit e FletëvetëVeprimitdhe cilësinë e shërbimit. Raporti gjashtëmuor publikohet në korrik; raporti vjetor në janar, sëbashku me përditësimin e treguesve dhe planit vjetor të zbatimit. Respektohet mbrojtja e të dhënave personale; burimet e indikatorëve përfshijnë regjistrin e rasteve, INSTAT dhe raportet e qendrave komunitare/partnerëve.

9. Miratimi, publikimi dhe hyrja në fuqi

1. Konsolidimi teknik i tekstit dhe i Fletëve të Veprimit.

2. Përfundimi i kostimit dhe ndarja vjetore e buxhetit (2025–2029).
3. Konsultimi publik final dhe përfshirja e komenteve.
4. Përgatitja e relacionit dhe projekt-VKB-së për Këshillin Bashkiak; miratimi.
5. Publikimi i planit dhe fletëvënësfaqen zyrtare të Bashkisë; komunikim publik.
6. Hyrja në fuqi pas miratimit të VKB-së dhe publikimit.

Ky relacion është përgatitur mbi bazën e dokumentacionit të planit 2025–2029 të Bashkisë Tepelene

DREJTORI

Arta Shaha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELNË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1490 / 5 prot

Tepelenë, më 20.08.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. __, datë __. __. 2025

**“PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRIJTJEN E KAPACITETEVE TE QEVERISJES
VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)”**

Në mbështetje të nenit 2, pika 11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 54, shkronja “d” dhe “gj”, nenit 55 pikat 3, neni 64 shkronja “h”, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, dhe anëtarësimin e Bashkisë Tepelenë në SKP, të quajtur “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi”.

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t'i shërbyer cilësisht komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënjen e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulence ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve.

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Tepelenë në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Tepelenë si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përlllogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Tepelenë të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”* dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij vendimmi, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA-s;
5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Tepelenë të përfaqësojë Bashkinë Tepelenë organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj

marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Tepelenë nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA.

6. Ngarkohet Kryetari Bashkisë, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar të Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

KRYETARI I BASHKISË
JULINDA KARTERI



KRYETARI I KËSHILLIT
ARBEN GUMENI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELNË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ prot

Tepelenë, më 20.08.2025

**RELACION
PER
PROJEKT VENDIMIT**

**“PËR
MIRATIMIN E PROJEKTMARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR RRITJEN E
KAPACITETEVE TË QEVERISJES VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE
TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)”**

Të nderuar Këshilltarë !

I. Qëllimi i projekt vendimit dhe objektivat që synohen të arrihen

Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ka përcaktuar funksionet e NJVV-ve dhe të drejtën dhe detyrimin për trajnimin e zyrtarëve (punonjësit dhe të zgjedhurit vendorë) në mënyrë që ato të ushtrojnë këto funksione sipas ligjit, standarteve, me efektivitet, efikasitet dhe në përputhje me strategjitë dhe prioritetet kombëtare, si dhe me standardet e BE-së. Në ligj parashikohet trajnim sistematik dhe buxhetor i stafit të NJVV-ve. Në këtë kuadër, kryetari i bashkisë duhet të marrë masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive (Neni 64/h), ndërkohë këshilltarët kanë të drejtën e formimit profesional, sipas një programi të miratuar nga këshilli bashkiak (Neni 51/4).

Ky projekt vendim ka si qëllim mundësimin e zhvillimit dhe kualifikimit profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të bashkisë.

Ky projekt vendim ka si objektiva:

- Krijimin e mundësive për ushtimin e përgjegjësive ligjore të këshillit bashkiak dhe të kryetarit të bashkisë për zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të këshillit të qarkut.
- Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030.
- Zbatimin e Dokumentit Kombëtar të Politikave dhe të Strategjisë për Administratën Publike.
- Aftësimin e zyrtarëve të bashkisë për të përballuar sfidat dhe kërkesat e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- Krijimi i një strukture të dedikuar për aftësimin, kualifikimin profesional dhe trajnimin e zyrtarëve të bashkisë.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premisat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta (SPK) në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, neni 14 pika 5. Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Palët përcaktojnë ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave të SKP.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërlidhen dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizatë Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve”, ndryshuar. Ky opsion ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarrje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshirë donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarrjen dhe financimin e saj.

II. Vlerësimi i projekt aktit në raport me politikat dhe prioritet e bashkisë dhe të Qeverisë së Shqipërisë.

Vetëqeverisja vendore është shtyllë themelore e funksionimit të një shoqërie demokratike dhe e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit, dhe garanton qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër me qytetarët. Suksesi i procesit të decentralizimit dhe i ushtrimit të autonomisë vendore varet, ndër të tjera, edhe nga cilësia e hartimit, zbatimit dhe moniorimit të politikave të bashkisë, cilësia e shërbimeve të ofruara nga bashkia dhe aftësia e bashkisë për t'ju përgjigjur cilësisht nevojave dhe tendencave zhvillimore në nivel vendor, varen në një masë të madhe nga njohuritë, aftësitë, sjelljet dhe profesionalizimi i të zgjedhurive vendorë, i nëpunësve publikë të administratës së bashkisë si dhe i punonjësve të institucioneve, enteve dhe ndërmarrjeve në varësi të bashkisë.

Vetëqeverisja vendore në Shqipëri përballlet me sfida të konsiderueshme në menaxhimin efektiv të burimeve, hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve dhe komuniteteve, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Procesi i decentralizimit të funksioneve tek bashkitë si dhe rritja e kërkesave për shërbime nga qytetarët dhe komunitetet e bëjnë të domosdoshme rifreskimin, përmirësimin dhe avancimin e njohurive dhe aftësive të zyrtarëve vendorë. Gjithashtu edhe politikat kombëtare për të modernizuar administratën publike si dhe për të digjitalizuar qeverisjen dhe shërbimet administrative, bëjnë të domosdoshme kualifikimin, profesionalizimin dhe modernizimin e administratës publike të NJVV-ve.

Trajnimet për zyrtarët e NJVV-ve janë ofruar nga subjekte të ndryshme shtetërore dhe në një masë të madhe nga programet e huaja të asistencës teknike, por këto trajnime kanë qenë sporadike, nuk kanë qenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat konkrete të NJVV-ve. Trajnimet nuk janë ofruar për të gjitha funksionet e NJVV-ve, dhe për më tepër kanë lënë shpesh jashtë vëmendjes të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jo-nëpunës civil të NJVV-ve. Trajnimet janë fokusuar kryesisht në përmbushjen e nevojave të përgjithshme horizontale, duke mos adresuar në mënyrë të gjerë dhe të thelluar temat vertikale që lidhen me funksionet dhe shërbimet specifike sektoriale të qeverisjes vendore. Për më tepër, nuk ka ekzistuar ndonjë proces i institucionalizuar dhe i rregullt konsultimi me zyrtarët e NJVV-ve për identifikimin e nevojave për trajnime apo për përmbajtjen e kurrikulave të trajnimit, veçanërisht ato sektoriale.

ASPAs dhe institucione të tjera shtetërore kanë ofruar një grup shërbimesh trajnimi për NJVV-të sipas parashikimeve ligjore, por ato mbeten të pamjaftueshme përkundrejt sfidave që NJVV-të përballen dhe pritet që të përballen në kuadër të procesit të integrimit në BE.

Për pasojë, NJVV-të nuk kanë arritur të plotësojnë nevojat specifike të punonjësve të tyre, duke krijuar një hendek të madh në përmbushjen e kërkesave për trajnim dhe kjo ka sjell në pah nevojën për një qasje më strategjike dhe të integruar dhe një strukturë të qëndrueshme për zhvillimin e kapaciteteve dhe kualifikimin profesional të zyrtarëve të NJVV-ve, në mënyrë që ato të përmbushin kërkesat në rritje për shërbime cilësore të vetëqeverisjes vendore.

Numri i zyrtarëve të NJVV-ve ka ardhur në rritje, nga rreth 21,442 (2015), në rreth 32,000 (2021), 37,518 (2022), dhe rreth 39,000 (2023), ku të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jashtë shërbimit civil përbëjnë shumicën e zyrtarëve të NJVV-ve, rreth 85% (*White Paper për Akademinë-2024*). Pavarësisht rritjes së numrit të zyrtarëve të NJVV-ve, mbështetja financiare e NJVV-ve për trajnimet e tyre mbetet e ulët.

Por ndërkohë që numri i zyrtarëve të NJVV-ve dhe nevoja e tyre për trajnim ka ardhur në rritje, asnjë strukturë nuk ka pasur mandatin apo kapacitetin për të trajnuar në mënyrë të plotë, praktike dhe në kohën e duhur të zgjedhurit vendorë, nëpunësit civil dhe punonjësit e institucioneve e ndërmarrjeve në varësinë e NJVV-ve.

III. Koncepti, procesi, aktorët dhe modalitetet për ngritjen e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjen Vendore.

Ngritja e Akademisë për Qeverisjen Vendore, si një strukturë të dedikuar për trajnim të zyrtarëve të NJVV-ve, përfaqëson realizimin e një nisme të kahershme dhe një kërkesë të artikuluar e lobuar prej vitesh nga NJVV-të, me synimin për të përmbushur nevojat e mëdha dhe në rritje për aftësimin dhe kualifikimin e të gjithë zyrtarëve të tyre.

Vizioni për të ngritur një strukturë të dedikuar për trajnimin e zyrtarëve të NJVV-ve u materializua në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimi dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 miratuar me VKM nr. 252, datë 20.4.2023, dhe u mbështet nga grupi ndër-institucional të punës të ngritur me urdhër të Kryeministrit (Janar 2023), dhe në takimet e të cilit morën pjesë morën pjesë aktive edhe shoqatat e NJVV-ve. Procesi i diznimit të Akademisë u mbështet me ekspertizë të huaj dhe vendase, të financuar nga Qeveria Svicerane dhe Qeveria Suedeze, u realizua në konsultim me kryetarë të bashkive dhe të këshillave bashkiakë të spektrit të ndryshëm politik si dhe me kryetarë të këshillave të qarqeve. Procesi i diznimit të Akademisë u realizua me përfshirjen e zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë dhe me praninë e zyrës së Komisionit Evropian në Tiranë dhe të donatorëve të tjerë. Për diznimin e Akademisë u morën parasysh 10 modele të shkollave dhe qendrave të trajnimit për administratën publike në Evropë dhe në rajon, si dhe modele të qendrave të trajnimit në Shqipëri. Ndërkohë, me shkresën nr. 532 prot., datë 18.09.2024 Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) ju drejtua 61 kryetarëve të bashkive, duke kërkuar konfirmimin për përfshirjen në buxhetin e vitit 2025 të kontributit financiar të secilës bashki për të mbështetur trajnimet e zyrtarëve të tyre përmes një strukture të dedikuar dhe në bazë të numrit të punonjësve të tyre.

Nga ana e NJVV-ve dhe në funksion të realizimit të iniciativës për ngritjen e Akademisë, Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Bashkive, me vendimin e saj të datës 04.09.2024, dakortësoi angazhimin e

bashkive të Shqipërisë për mbështetjen e kësaj iniciative, si dhe për bashkëfinancimin e Akademisë në vlerën 50% të shpenzimeve operationale dhe të trajnimeve.

Në vijim të këtyre iniciativave, Grupi Ndër-institucional i Punës miratoi Dokumentin e Politikës (White Paper) për Akademinë (Shtator 2024), dokument që më pas u miratua nga Këshilli Konsultativ Qeveri Qendrore - Qeveri Vendore (Dhjetor 2024).

Në përgjigje të angazhimit të Qeverisë së Shqipërisë për të mbështetur ngritjen e Akademisë si dhe të mbështetjes së shoqatave të NJVV-ve për ngritjen e Akademisë, këshillat bashkiakë konfirmuan njëzëri mbështetjen e tyre për nevojën e ngritjes së Akademisë, përmes miratimit të një fondi për trajnimet e zyrtarëve të bashkisë e që do t'i vihej në dispozicion Akademisë në momentin e regjistrimit të saj. Ky angazhim financiar përbën një shprehje e vullnetit të fortë të bashkive për ngritjen dhe financimin e Akademisë, si dhe përbën një element të rëndësishëm për avancimin e procesit të ngritjes së subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP).

Edhe Këshilli Bashkiak Tepelenë me Vendimin Nr, 72, datë 27.11.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 si dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027”, miratoi fondin që do i vihej në dispozicion Akademisë, në vlerën totale 200,744 lekë për trajnimin e 36 personave.

Akademia që propozohet të ngrihet si personi juridik subjekt i kompetencave të përbashkëta, do të ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh për të mbështetur dhe përmirësuar kapacitetet e NJVV-ve në Shqipëri duke përfshirë hartimin e kurrikulave dhe ofrimin e trajnimeve të specializuara, administrimin e platformës për menaxhimin dhe ndarjen e njohurive mes zyrtarëve të NJVV-ve, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin mes tyre, ofrimi i ekspertizës dhe shërbimeve të konsulencës ndaj NJVV-të për zgjidhjen e problemeve dhe arritjen e objektivave në lidhje me zhvillimin e burimeve të tyre njerëzore.

Ngritja e Akademisë është thelbësore për t'i mundësuar NJVV-ve përballimin e sfidave për rritjen e cilësisë së jetës, zhvillim të qëndrueshëm të territorit dhe komuniteteve vendore si dhe sfidave që po sjell procesi i integritetit të Shqipërisë në BE. Vlerësohet se 70% e *acquis* zbatohet nga qeveritë vendore dhe rajonale dhe NJVV-të do të kenë një rol të rëndësishëm në këtë proces, dhe kjo është arsyeja pse niveli i njohurive dhe aftësive të zyrtarëve të NJVV-ve, për të përballuar këto procese, merr një rëndësi të veçantë.

Synohet që ofrimi i trajnimeve të përfshijnë tema specifike dhe sektoriale “vertikale” që lidhen me funksionet e NJVV-ve dhe me rreth 41 shërbimet e vetëqeverisjes vendore të tilla si Zhvillimi i Territorit, Infrastruktura dhe Shërbimet Publike, Shërbimet Sociale; Mbrojtja e Mjedisit; Bujqësia; Zhvillimi Rural; Pyjet dhe Kullotat Publike; Zhvillimi Ekonomik Vendor, Siguria Publike, etj. Programet e trajnimit do të hartohen bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim, do të jenë paktike dhe dinamike, ndërkohë që hartimi i kurrikulave dhe dhënja e trajnimeve do të koordinohet me ASPA për të evituar mbivendosje të trajnimeve të ofruara.

Përfituesit kryesorë të shërbimeve janë nëpunësit civilë dhe punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi të NJVV-ve, si dhe të zgjedhurit vendorë, që përbëjnë rreth 39,000 persona. Kjo përfshirje e gjerë ndihmon në përmirësimin e performancës së qeverisjes vendore dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premisat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, neni 14 (5). Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërlidhen dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizatë Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve”, ndryshuar. Ky opsion ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarrje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshirë donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarrjen dhe financimin e saj.

Stategjia decentralizimit

Themelimi i OJF-së si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis qeverisjes qendrore dhe NJVV-ve, përmes aktit themelues dhe statutit, kërkon në të njëjtën kohë miratimin nga të gjithë këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve të marrëveshjes për anëtarësimin në Akademi, SKP në formë OJF-je, si dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshje nga ministri përgjegjës për çështjet vendore sipas autorizimit të dhënë nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përmes VKM 405 dt.16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me

njesite e vetëqeverisjes vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të republikës së shqipërisë". Sipas këtij vendimi, Këshilli i Ministrave ka marrë angazhimin të mbështesë financiarisht Akademinë përmes mbulimit të kostove fillestare të themelimit të saj si subjekt i kompetencave të përbashkëta, si dhe të financojë jo më pak se 50% të kostove operacionale të funksionimit të Akademisë për tri vitet e para të funksionimit për përmbushjen e objektivave të saj.

Hapi vijues në këtë proces është miratimi i marrëveshjes nga këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar. Pas përfundimit të këtij procesi të miratimit, do të vijohet me regjistrimin e personit juridik në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8788/2001, "Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve", të ndryshuar.

IV. Propozimi për ngritjen e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Për sa më sipër, dhe në mbështetje të nenit 2, pika 11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.6, shkronja "b", nenit 14 pika 5, nenit 54, shkronja "d" dhe "gj", nenit 55, pikat 3, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore", Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 "Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë", i propozojmë Këshillit Bashkiak si më poshtë vijon:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi, të quajtur "Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)".

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t'i shërbyer cilësisht komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënjën e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e

zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administrojnë një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulence ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin e emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Tepelenë në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Tepelenë si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përlllogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Tepelenë të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”* dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij vendimmi, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA-s;
5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë të përfaqësojë Bashkinë Tepelenë në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Tepelenë nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA-s.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar

SPIRO KORA

KRYETARI I BASHKISË

JULINDA KARTERI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI

Nr 1499 / 4 Prot

Tepelene me 20 / 07 /2025

PROJEKT/ VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2025

**PËR EMËRTIM RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE QENDER ,
BASHKIA TEPELENË**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____ me propozim të Kryetarit të Bashkisë , mbështetur në nenin 9 pika 1, nën-pika 1.1 shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 23 , të nenit 54 shkronja “ll”, dhe nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, relacionit të Drejtorisë së Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social

VENDOSI

- 1- Miratimin e emërimit me emrin “Gligor Llambi Prifti ” (Pas vdekjes) të rrugës sipas fragmentimit të hartës bashkëngjitur , në njësine Administrative Qender Tepelenë si më poshtë :

Segmenti : P.NR.312/6 me Sip=385 m2 dhe P.Nr.312/32 me Sip =421 rruge

*Nga ish shkolla “Polo Bezhani” deri tek çezma Bashta , fshati Lekel të marrë emrin
“”Gligor Llambi Prifti” (Pas vdekjes)” .*

- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social si dhe Njësia Administrative Qender Tepelenë.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” .



KRYETARI

Arben GUMENI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENE
DREJTORIA E ARSIM KULTURES DHE KUJDESIT SOCIAL

RELACION

PËR EMËRTIM RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE QENDER ,
BASHKIA TEPELENË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", pranë Drejtorisë së Arsimit kulturës dhe Kujdesit social është paraqitur me shkresë nr 235 prot , Njesia Administrative Qender Tepelene , kërkesë për emërtim rruge në Njesine Administrative Qender , fshati Lekël Segmenti i rruges : *P.NR.312/6 me Sip=385 m2 dhe P.Nr.312/32 me Sip =421 rruge*

Nga ish shkolla "Polo Bezhani" deri tek çezma Bashta , fshati Lekel të marrë emrin "Gligor Llambi Prifti" (Pas vdekjes)"

Jeta dhe veprimtaria

Lindi në fshatin Lekel të Tepelenës Familja e tij rrjedh nga një familje patriotike e cila në pavarësinë e Shqipërisë ashtu dhe në luftën Nacional-Çlirimtare ka dhënë një kontribut të thellë duke pasur përfaqësuesit e saj.

Gole Prifti ka qenë dhe kryeplak I fshatit Lekël nën fjalën e tij shumë burra të fshatit dhe të zonës përreth u bashkuan me Luftën Nacional-Çlirimtare. Gligor (Gole) Prifti , një emër që ndërlidhet ngushtë me historinë e fshatit Lekël në Tepelenë, është simbol I patriotizmit dhe I devotshmërisë ndaj vendit. Në një kohë kur Shqipëria përballlej me sfida të mëdha , Gole Prifti u shfaq si një lider frymëzues , I cili nuk hezitoi të sakrifikonte për lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Ai ishte një figurë karizmatike , I njohur për mençurinë dhe vizionin e tij për një Shqipëri të lirë dhe të bashkuar.

Grigor (Gole) Prifti nuk ishte vetëm një lider ushtarak, ai ishte gjithashtu një njeri I kulturës dhe arsimit. Ai kuptonte se liria nuk mjafton vetëm përmes luftës, por kërkon edhe njohuri dhe edukim. Gole Prifti inkurajoi lirinë të studiojë , duke organizuar mësimë në shtëpinë e tij me mësues të fshatit dhe duke siguruar libra që shpërndanin ide të progresit dhe lirisë. Kështu ai, ndihmoi në krijimin e një brezi të ri, të vetëdijshëm për rëndësinë e identitetit kombëtar.

Një nga arritjet më të rëndësishme të tij ishte krijimi I një rrjeti mbështetje për luftëtarët e lirisë. Në kohë të vështira, ai mobilizoi burime për t'i ndihmuar ata që ishin angazhuar në luftë, duke ofruar strehim dhe ushqim për ata që luftonin për kauzën e përbashkët.

Pas luftës ai u angazhua në rindërtimin e fshatit Lekël. Përkushtimi I tij për zonën e bëri atë një figurë të dashur dhe të respektuar . Pas vdekjes ai u kujtua si heri I zonës, dhe historia e tij u transmetua brez pas brezi, duke bërë një inspirim për ata që vijnë pas.

Gole Prifti është shembull I shkëlqyer I patriotizmit dhe përkushtimit për atdheun. Një nga aktivitetet e tij ishte organizimi I festave tradicionale,ku njerëzit mbledheshin për të kremtuar historinë dhe kulturën e tyre në fshatin Lekël. Këto ngjarje jo vetëm forconin ndjenjën e identitetit të tij, por gjithashtu nxisin një ndjenjë të përbashkët të qëllimit më të gjithëve.

Nisur nga sa më sipër kërkojmë miratimin e Këshillit Bashkiak për propozimin e bërë nga Njësia Administrative Qendër Tepelenë.

DREJTORI

Arta Shaha





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENE
KRYETARI

PËR EMËRTIM RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE QENDER ,
BASHKIA TEPELENË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", pranë Drejtorisë së Arsim kulturës dhe Kujdesit social është paraqitur me shkresë nr 235 prot , Njesia Administrative Qender Tepelene , kërkesë për emërtim rruge në Njesine Administrative Qender , fshati Lekël

Segmenti : P.NR.312/6 me Sip=385 m2 dhe P.Nr.312/32 me Sip =421 rruge

Nga ish shkolla "Polo Bezhani" deri tek çezma Bashta , fshati Lekel të marrë emrin "Gligor Llambi Prifti" (Pas vdekjes)"

Jeta dhe veprimtaria

Lindi në fshatin Lekel të Tepelenës Familja e tij rrjedh nga një familje patriotike e cila në pavarësinë e Shqipërisë ashtu dhe në luftën Nacional-Çlirimtare ka dhënë një kontribut të thellë duke pasur përfaqësuesit e saj.

Gole Prifti ka qenë dhe kryeplak I fshatit Lekël nën fjalën e tij shumë burra të fshatit dhe të zonës përreth u bashkuan me Luftën Nacional-Çlirimtare. Gligor (Gole) Prifti , një emër që ndërlidhet ngushtë me historinë e fshatit Lekël në Tepelenë, është simbol I patriotizmit dhe I devotshmërisë ndaj vendit.Në një kohë kur Shqipëria përballlej me sfida të mëdha , Gole Prifti u shfaq si një lider frymëzues , I cili nuk hezitoi të sakrifikonte për lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Ai ishte një figurë karizmatike , I njohur për mençurinë dhe vizionin e tij për një Shqipëri të lirë dhe të bashkuar.

Grigor (Gole) Prifti nuk ishte vetëm një lider ushtarak, ai ishte gjithashtu një njeri I kulturës dhe arsimit. Ai kuptonte se liria nuk mjafton vetëm përmes luftës,por kërkon edhe njohuri dhe edukim.Gole Prifti inkurajoi lirinë të studiojë , duke organizuar mësimë në shtëpinë e tij me mësues të fshatit dhe duke siguruar libra që shpërndanin ide të progresit dhe lirisë. Kështu ai,ndihmoi në krijimin e një brezi të ri, të vetëdijshëm për rëndësinë e identitetit kombëtar.

Një nga arritjet më të rëndësishme të tij ishte krijimi I një rrjeti mbështetje për luftëtarët e lirisë.Në kohë të vështira,ai mobilizoi burime për t'i ndihmuar ata që ishin angazhuar në luftë,duke ofruar strehim dhe ushqim për ata që luftonin për kauzën e përbashkët.

Pas luftës ai u angazhua në rindërtimin e fshatit Lekël. Përkushtimi i tij për zonën e bëri atë një figurë të dashur dhe të respektuar. Pas vdekjes ai u kujtua si heri i zonës, dhe historia e tij u transmetua brez pas brezi, duke bërë një inspirim për ata që vijnë pas.

Gole prifti është shembull i shkëlqyer i patriotizmit dhe përkushtimit për atdheun. Një nga aktivitetet e tij ishte organizimi i festave tradicionale, ku njerëzit mbledheshin për të kremtuar historinë dhe kulturën e tyre në fshatin Lekël. Këto ngjarje jo vetëm forconin ndjenjën e identitetit të tij, por gjithashtu nxisin një ndjenjë të përbashkët të qëllimit mes të gjithëve.

KRYETARI

Julinda Karteri



Nr. 1408
08.08.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR

Handwritten signature and date: 08.08.2025

Nr. 235 prot.

Tepelenë, më 07.08.2025

LËNDA: Kërkesë për emërtim rruge në fshatin Lekël

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Tepelenë
Për djeni: Kryetares së Bashkisë Tepelenë

Znj. Julinda Karteri

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe në përputhje me rregulloren për emërtimin e rrugëve, institucioneve dhe hapësirave publike, Njësia Administrative Qendër, si dhe në përgjigje të propozimit të kryesisë së fshatit paraqet për shqyrtim dhe miratim propozimin për emërtimin e një segmenti rruge në fshatin Lekël, si më poshtë:

Segmenti i rrugës: Nga ish-shkolla “Polo Bezhani” deri tek çezma Bashta, të emërtohet rruga; **“Gligor Lambi Prifti”**

Ky propozim bëhet në shenjë vlerësimi për kontributin e çmuar të z. Gligor Lamvbi Prifti në: Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, rindërtimin e vendit pas çlirimit, trashëgiminë historike, kulturore dhe folklorike Si një lider frymëzues për lirinë dhe pavarësinë e atdheut, zhvillimin ekonomik dhe social të fshatit Lekël.

Figura e tij përfaqëson një model të përkushtimit atdhetar dhe angazhimit qytetar që meriton të ruhet dhe të kujtohet për brezat e ardhshëm.

Faleminderit për mirekuptimin dhe bashkepunimin,

Me respekt,
Administratori i Njesisë Administrative Qendër

Leonidha SHUMELI

Handwritten signature of Leonidha Shumeli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENE
DREJTORIA E ARSIM KULTURES DHE KUJDESIT SOCIAL

RELACION

PËR EMËRTIM RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE QENDER ,
BASHKIA TEPELENË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, pranë Drejtorisë së Arsimit kulturës dhe Kujdesit social është paraqitur me shkresë nr 235 prot , Njesia Administrative Qender Tepelene , kërkesë për emërtim rruge në Njesine Administrative Qender , fshati Lekël Segmenti i rruges : *P.NR.312/6 me Sip=385 m2 dhe P.Nr.312/32 me Sip =421 rruge*

Nga ish shkolla “Polo Bezhani” deri tek çezma Bashta , fshati Lekel të marrë emrin “Gligor Llambi Prifti” (Pas vdekjes)”

Jeta dhe veprimtaria

Lindi në fshatin Lekel të Tepelenës Familja e tij rrjedh nga një familje patriotike e cila në pavarësinë e Shqipërisë ashtu dhe në luftën Nacional-Çlirimtare ka dhënë një kontribut të thellë duke pasur përfaqësuesit e saj.

Gole Prifti ka qenë dhe kryeplak I fshatit Lekël nën fjalën e tij shumë burra të fshatit dhe të zonës përreth u bashkuan me Luftën Nacional-Çlirimtare. Gligor (Gole) Prifti , një emër që ndërlihet ngushtë me historinë e fshatit Lekël në Tepelenë, është symbol I patriotizmit dhe I devotshmërisë ndaj vendit.Në një kohë kur Shqipëria përballlej me sfida të mëdha , Gole Prifti u shfaq si një lider frymëzues , I cili nuk hezitoi të sakrifikonte për lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Ai ishte një figurë karizmatike , I njohur për mençurinë dhe vizionin e tij për një Shqipëri të lirë dhe të bashkuar.

Grigor (Gole) Prifti nuk ishte vetëm një lider ushtarak, ai ishte gjithashtu një njeri I kulturës dhe arsimit. Ai kuptonte se liria nuk mjafton vetëm përmes luftës,por kërkon edhe njohuri dhe edukim.Gole Prifti inkurajoi lirinë të studiojë , duke organizuar mësimë në shtëpinë e tij me mësues të fshatit dhe duke siguruar libra që shpërndanin ide të progresit dhe lirisë. Kështu ai,ndihmoi në krijimin e një brezi të ri, të vetëdijshëm për rëndësinë e identitetit kombëtar.

Një nga arritjet më të rëndësishme të tij ishte krijimi I një rrjeti mbështetje për luftëtarët e lirisë.Në kohë të vështira,ai mobilizoi burime për t’I ndihmuar ata që ishin angazhuar në luftë,duke ofruar strehim dhe ushqim për ata që luftonin për kauzën e përbashkët.

Pas luftës ai u angazhua në rindërtimin e fshatit Lekël. Përkushtimi I tij për zonën e bëri atë një figurë të dashur dhe të respektuar .Pas vdekjes ai u kujtua si heri I zonës, dhe historia e tij u transmetua brez pas brezi,duke bërë një inspirim për ata që vijnë pas.

Gole Prifti është shembull I shkëlqyer I patriotizmit dhe përkushtimit për atdheun. Një nga aktivitetet e tij ishte organizimi I festave tradicionale, ku njerëzit mbledheshin për të kremtuar historinë dhe kulturën e tyre në fshatin Lekël. Këto ngjarje jo vetëm forconin ndjenjën e identitetit të tij, por gjithashtu nxisin një ndjenjë të përbashkët të qëllimit mes të gjithëve.

Nisur nga sa më sipër kërkojmë miratimin e Këshillit Bashkiak për propozimin e bërë nga Njësia Administrative Qendër Tepelenë.

DREJTORI

Arta Shaha



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET

DATE : 08/08/2025

QELLIMI: PER EMERTIM RRUGE

VENDNDODHJA

BASHKIA TEPELENE

DVAKSH/ZVAKSH

ZONA KADASTRALE : 2405

NUMURI PASURISE : 312/6+312/32 INDEKS HARTE: K-34-137-(51-C)

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE : RRUGE


SIP PASURISE = 806 m² (385 m² + 421 m²)

SIP. GJURMES NDERTIMIT = m²

NR. KATEVE

NR. PEMEVE

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



REALIZOI PER BASHKINE TEPELENE

EMRI: MAKSIM SHEHU

LICENCA NR. T0025/3

NENESHKRIMI

KONFIRMOI

PERGJEGJESI DREJTORI

NENESHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE : Z- Zyre

PERCAKTIMI I KUFIRIT : HK- Harta Kadastrale

SHENIME TE VECANTA:

P.NR. 312/6 ME SIP= 385m², RRUGE DHE P.NR. 312/32 ME SIP= 421m² RRUGE DO TE EMERTOHEN

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIMI MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI: BASHKIA TEPELENE

NENESHKRIMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI

Nr 1490 / Prot

Tepelene me 22 / 08 / 2025

PROJEKT/ VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2025

**PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË NJË MJEDISI PUNE NË SHKOLLËN "SINAN KËRPI"
LEKDUSH, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KURVELESH, BASHKIA TEPELENË**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____ me propozim të Kryetarit të Bashkisë , mbështetur në nenin 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronjat "a" dhe "b", të nenit 23 , të nenit 54 shkronja "II", dhe nenit 55 të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", relacionit të Drejtorisë së Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social

VENDOSI

- 1- Vënie në dispozicion të një mjedisi pune në shkollën "Sinan Kërpi" Lekdush, në Njësine Administrative Kurvelesh, Bashkia Tepelenë, për përdorim të Kryesisë së fshatit Lekdush , sipas kushteve të mëposhtme :
 - a) Ambjenti "Salla e mesuesve" do të vihet në dispozicion të takimeve të Kryesisë së fshatit Lekdush vetëm të shtunën dhe të dielën gjatë gjithë ditës dhe ditët e javës pas orarit mësimor.
 - b) Ambjenti "Salla e mësuesve" do të vihet në dispozicion si bibliotekë e shkollës gjatë gjithë orarit mësimor por dhe pas tij në funksion të nxënësve dhe komunitetit të zonës.
 - c) Përjashtimisht në rastet e emergjencave ky ambjent do të jetë në funksion të Kryesisë së fshatit vetëm me konfirmim të Administratorit të Njesisë Administrative Kurvelesh pa cënuar procesin mësimor.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social dhe Njësia Administrative Kurvelesh.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".

KRYETARE NË DËTYRË E BASHKISË

Julinda Karteri

KRYETARI I KËSHILLIT

Arben GUMENI



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA TEPELENË
DREJTORIA E ARSIM KULTURËS DHE KUJDESIT SOCIAL

RELACION

**PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË NJË MJEDISI PUNE NË SHKOLLËN “SINAN KËRPI”
LEKDUSH, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KURVELESH,**

BASHKIA TEPELENË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, pranë Bashkisë Tepelenë është paraqitur me shkresë nr 1001 prot, Kryepjeqesia e fshatit Lekdush Njesia Administrative Kurvelesh Tepelene , kërkesë për vënie në dispozicion të një mjedisi pune në shkollën “Sinan Kërpi” në Njesinë Administrative Kurvelesh në përdorim për Kryesinë e fshatit Lekdush . Ky ambjent do të jetë në funksion të takimeve të Kryesisë së fshatit por gjithashtu do të shërbejë dhe si bibliotekë e komunitetit por dhe e fëmijëve, pasi ka një numër të konsiderueshëm librash të grumbulluar në formën e dhuratave nga bashkëfshatarët, libra artistikë, shkencore, periodikë etj. Biblioteka do të jetë e disponueshme për fëmijët e kësaj shkolle por dhe për gjithë komunitetin e kësaj zone.

Këshilli Bashkiak Tepelenë me shkresë nr 1001/1 prot datë 01.07.2025 i është drejtuar Kryetares së Bashkisë Tepelenë për shqyrtimin e kërkesës së kryesisë së Fshatit Lekdush dhe vendosi: Organizimin e dëgjësës publike me banorët e fshatit Lekdush.

Nisur nga sa më lart Bashkia Tepelenë i është drejtuar Zyrës Arsimore Tepelenë me shkresë Nr 1001/2 prot datë 03.07.2025 për të marrë dakortësinë për këtë qëllim, pa cënuar aktivitetin mësimor apo shërbimin shkollor të kësaj shkolle.

Me shkresë Nr 331 prot datë 07.07.2025 është kthyer përgjigje nga ZVA Tepelenë dhe është marrë dakortësia e kërkesës së sipërcituar

Shkolla “Sinan Kërpi” është pjesë e inventarit të Bashkisë Tepelenë me nr. pasurie____në Njesinë Administrative Kurvelesh, Tepelenë. Aktualisht kjo shkollë ka në dispozicion tre ambjente, një prej të cilave është në funksion dhe dy të tjerat janë bosh.

Vënia në dispozicion e ambjentit (salla e mësuesve) për takime të Kryesisë së fshatit por gjithashtu dhe si bibliotekë e komunitetit por dhe e fëmijëve që ndjekin shkollën do të jetë sipas kushteve të mëposhtme:

- 1- Ambjenti “Salla e mësuesve” do të vihet në dispozicion të takimeve të Kryesisë së fshatit Lekdush vetëm të shtunën dhe të dielën gjatë gjithë ditës dhe ditët e javës pas orarit mësimor.
- 2- Ambjenti “Salla e mësuesve” do të vihet në dispozicion si bibliotekë e shkollës gjatë gjithë orarit mësimor por dhe pas tij në funksion të nxënësve dhe komunitetit të zonës.

- 3- Përfundimisht në rastet e emergjencave ky ambient do të jetë në funksion të Kryesisë së fshatit vetëm me konfirmim të Administratorit të Njesisë Administrative Kurvelesh pa cënuar procesin mësimor.

Duke shqyrtuar gjithë dokumentacionin dhe në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", nisur nga fakti që ky ambient do të jetë dhe në dispozicion si bibliotekë për fëmijët por dhe si ambient për takimet me banorët dhe Kryesinë e fshatit Lekdush, kërkojmë nga ana juaj Miratimin e kërkesës së Kryesisë së fshatit Lekdush për vënien në dispozicion të ambientit (salla e mësuesve) në shkollën "Sinan Kërpi" Lekdush, Njësia Administrative Kurvelesh.

DREJTORI

Arta Shaha

KRYETARE NË DETYRË E BASHKISË



Julinda Karteri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI

Nr 1513 Prot

Tepelene me 27/09 /2025

PROJEKT/ VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2025

**PËR ZËVENDËSIMIN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE TË HITO LEKDUSHIT ME
VENDOSJEN E BUSTIT TË TIJ
NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KURVELESH, BASHKIA TEPELENË**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datë _____.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë , mbështetur në nenin 9 pika 1,nënpika 1.1 shkronjat “a”dhe “b”, të nenit 23 , të nenit 54 shkronja”ll”, dhe nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, relacionit te Drejtorisë së Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social

V E N D O S I

- 1- Miratimin e zëvendësimit të pllakës përkujtimore të Hito Lekdushit me vendosjen e bustit të tij në Njësine Administrative Kurvelesh, Bashkia Tepelenë.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social si dhe Njësia Administrative Kurvelesh Tepelenë.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore.”

KRYETARË NË DETYRË E BASHKISË

Julinda Karteri

KRYETARI KËSHILLIT

Arben GUMENI



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA TEPELENË
DREJTORIA E ARSIM KULTURËS DHE KUJDESIT SOCIAL**

RELACION

**PËR ZËVENDËSIMIN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE TË HITO LEKDUSHIT ME
VENDOSJEN E BUSTIT TË TIJ**

NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KURVELESH, BASHKIA TEPELENË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, pranë Bashkisë Tepelenë është paraqitur kërkesa datë 20.06.2025 e Kryesisë së fshatit Lekdush në Njësine Administrative Kurvelesh për vendosjen e bustit të Hito Lekdushit në vend të pllakës përkujtimore që përkujton këtë dëshmor e cila ndodhet ndodhet në fshatin Lekdush.

Jeta dhe veprimtaria

(HITO XHELIL HABILI është i njohur edhe si Hito Labi ose Hito Lekdushi

Hito Xhelil Habili ka lindur në fshatin Lekdush të Tepelenës më 15 maj të vitit 1881.

Aktiviteti patriotik:

Qysh në fillim të 1908 ai iu bashkua cetës së Cerciz Topullit duke marrë pjesë në të gjitha aksionet luftarake që ndërmori kjo cetë ku u dallua për trimëri e guxim e seriozitet në detyrat e ngarkuara nga ceta. Akti më i rëndësishëm që e përjetëson edhe sot kujtimin e tij është vrasja e Bimbashit turk të cilën e kreu me patriotin tjetër nga Gjirokastra Barjam Prongjia.

Anëtar i çetës së Çerçiz Topullit dhe shok armësh me Mihal Gramenon.

Më 1908, konkretisht në mars, mori pjesë në atentatin e famshëm kundër komandantit turk të xhandarmërisë në Gjirokastër (Bimbash Musa Beu) të dy atentatorët ishin Hito Labi nga Lekdushi dhe Bajram Ligu nga Prongjia.

Detaje të atentatit dhe veprimtarisë ushtarake

Përgatiteshin me kujdes: prerë flokët e mustaqet, u veshën si tregtarë dhe testuan revolverët jashtë qytetit për të mos lënë dyshime. Në datën 9 mars 1908, rreth orës 11:15, qëlluan mbi Bimbashin në rrugët e Gjirokastrës dhe arritën të largoheshin para se të reagonin forcat turke.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA TEPELENË
DREJTORIA E ARSIM KULTURËS DHE KUJDESIT SOCIAL**

RELACION

**PËR ZËVENDËSIMIN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE TË HITO LEKDUSHIT ME
VENDOSJEN E BUSTIT TË TIJ**

NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KURVELESH, BASHKIA TEPELENË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, pranë Bashkisë Tepelenë është paraqitur kërkesa datë 20.06.2025 e Kryesisë së fshatit Lekdush në Njësine Administrative Kurvelesh për vendosjen e bustit të Hito Lekdushit në vend të pllakës përkujtimore që përkujton këtë dëshmor e cila ndodhet ndodhet në fshatin Lekdush.

Jeta dhe veprimtaria

(HITO XHELIL HABILI është i njohur edhe si Hito Labi ose Hito Lekdushi

Hito Xhelil Habili ka lindur në fshatin Lekdush të Tepelenës më 15 maj të vitit 1881.

Aktiviteti patriotik:

Qysh në fillim të 1908 ai iu bashkua cetës së Cerciz Topullit duke marrë pjesë në të gjitha aksionet luftarake që ndërmori kjo cetë ku u dallua për trimëri e guxim e seriozitet në detyrat e ngarkuara nga ceta. Akti më i rëndësishëm që e përjetëson edhe sot kujtimin e tij është vrasja e Bimbashit turk të cilën e kreu me patriotin tjetër nga Gjirokastra Barjam Prongjia.

Anëtar i çetës së Çerçiz Topullit dhe shok armësh me Mihal Gramenon.

Më 1908, konkretisht në mars, mori pjesë në atentatin e famshëm kundër komandantit turk të xhandarmërisë në Gjirokastër (Bimbash Musa Beu) të dy atentatorët ishin Hito Labi nga Lekdushi dhe Bajram Ligu nga Prongjia.

Detaje të atentatit dhe veprimtarisë ushtarake

Përgatiteshin me kujdes: prerë flokët e mustaqet, u veshën si tregtarë dhe testuan revolverët jashtë qytetit për të mos lënë dyshime. Në datën 9 mars 1908, rreth orës 11:15, qëlluan mbi Bimbashin në rrugët e Gjirokastrës dhe arritën të largoheshin para se të reagonin forcat turke.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA TEPELENË
DREJTORIA E ARSIM KULTURËS DHE KUJDESIT SOCIAL**

RELACION

**PËR ZËVENDËSIMIN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE TË HITO LEKDUSHIT ME
VENDOSJEN E BUSTIT TË TIJ**

NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KURVELESH, BASHKIA TEPELENË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, pranë Bashkisë Tepelenë është paraqitur kërkesa datë 20.06.2025 e Kryesisë së fshatit Lekdush në Njësine Administrative Kurvelesh për vendosjen e bustit të Hito Lekdushit në vend të pllakës përkujtimore që përkujton këtë dëshmor e cila ndodhet ndodhet në fshatin Lekdush.

Jeta dhe veprimtaria

(HITO XHELIL HABILI është i njohur edhe si Hito Labi ose Hito Lekdushi

Hito Xhelil Habili ka lindur në fshatin Lekdush të Tepelenës më 15 maj të vitit 1881.

Aktiviteti patriotik:

Qysh në fillim të 1908 ai iu bashkua cetës së Cerciz Topullit duke marrë pjesë në të gjitha aksionet luftarake që ndërmori kjo cetë ku u dallua për trimëri e guxim e seriozitet në detyrat e ngarkuara nga ceta. Akti më i rëndësishëm që e përjetëson edhe sot kujtimin e tij është vrasja e Bimbashit turk të cilën e kreu me patriotin tjetër nga Gjirokastra Barjam Prongjia.


Anëtar i çetës së Çerçiz Topullit dhe shok armësh me Mihal Gramenon.

Më 1908, konkretisht në mars, mori pjesë në atentatin e famshëm kundër komandantit turk të xhandarmërisë në Gjirokastër (Bimbash Musa Beu) të dy atentatorët ishin Hito Labi nga Lekdushi dhe Bajram Ligu nga Prongjia.

Detaje të atentatit dhe veprimtarisë ushtarake

Përgatiteshin me kujdes: prerë flokët e mustaqet, u veshën si tregtarë dhe testuan revolverët jashtë qytetit për të mos lënë dyshime. Në datën 9 mars 1908, rreth orës 11:15, qëlluan mbi Bimbashin në rrugët e Gjirokastrës dhe arritën të largoheshin para se të reagonin forcat turke.

LEKENDUSH



SHK. 1 : 1000

